

Violeta Shamku

LIBËR PËR MËSUESIN
Muzika 6

BOTIME



Përmbajtja

1. Hyrje	5
1.1. Pse shërben ky libër?	5
1.2. Çfarë synon ky libër?	5
1.3. Çfarë përmban ky libër?	5
2. Kompetencat dhe kuptimi i tyre	7
2.1. Lidhja e muzikës me <i>kompetencat kyçe</i>	7
2.2. Lidhja e muzikës me fushat e tjera kurrikulare	9
2.3. Kuptimi i kompetencave lëndore muzikore e i tematikave dhe lidhja ndërmjet tyre.	13
3. Planifikimi i kurrikulës – kuptimi dhe zbatimi	14
3.1. Plani vjetor i lëndës “Muzikë”	15
3.2. Plani 3 mujor (i ndërthurur)	
4. Metodologjia e të nxënit dhe mësimdhënies bazuar në kompetenca në lëndën e muzikës	21
4.1. <i>Planifikimi</i> i situatave të të nxënit	21
4.2. Planifikimi ditor	21
5. Vlerësimi	
5.1. Llojet e vlerësimit: Vlerësimi i vazhdueshëm, periodik dhe përfundimtar.	135

Hyrje

I dashur koleg!

Muzika është një disiplinë artistike dhe gjuhë universale që ndihmon nxënësit/et të kuptojnë e të lidhin fenomenet dhe dukuritë muzikore, proceset dhe çështjet që i përkasin muzikës, duke vërtetuar ligjshmërinë e tyre. Shpjegimi i mënyrave të interpretimit dhe të ndërtimit të tyre çon drejt realizimit të një procesi të suksesshëm të mësimin të muzikës. Muzika qëndron mes të gjitha formave të tjera inteligjente të njeriut (artit në përgjithësi, shkencave shoqërore e historike dhe shkencave artistike), si një përbërës i barabartë me to i progresit intelektual dhe i humanitetit.

Zhvillimi i muzikës në shkollë është një vlerë e madhe për të mundësuar edukimin dhe formimin kulturor, zhvillimin e personalitetit të nxënësve, zhvillimin e aftësive të tyre për të punuar dhe krijuar në mënyrë të pavarur, sistematike si dhe për të menduar në mënyrë krijuese dhe kritike.

› Pse shërben ky libër?

Ky libër do t'u shërbejë mësuesve/eve të muzikës, të njohin dhe zhvillojnë aftësitë e tyre profesionale në lëndën e muzikës, për zbatimin më së miri të risive në kurrikulën e muzikës.

› Çfarë synon ky libër?

Meqenëse arsimit po zbaton mësimdhënien bazuar në **kompetenca**, ky libër do të shërbejë si një udhërrëfyes për të gjithë mësuesit/et e muzikës, të cilët/at do ta ndërtojnë punën e tyre të përditshme bazuar në njohjen e dokumentacionit të ri: *korniza kurrikulare, kurrikula bërthamë e arteve, programi mësimor*, dhe vlerësimi bazuar në *nivelet e arritjes së kompetencave në arte*, të cilat përkrijnë me tri faza mjaft të rëndësishme:

a) planifikimi i të nxënësve;

b) metodologjia e mësimdhënies;

c) vlerësimi i të nxënësve bazuar në qasjen e re me kompetenca.

Qëllimi i këtij libri është të orientojë dhe ndihmojë mësuesit/et që japin mësim në klasën e gjashtë, për të përmbushur synimet e kësaj kurrikule së muzikës, për ndërtimin e kompetencave lëndore dhe ato kyçe të nxënësve/et e klasës së gjashtë, për të planifikuar dhe realizuar detyrat e tyre të mësimdhënies së kësaj lënde, konform dokumenteve zyrtare dhe fazave nëpër të cilat kalon mësimdhënia.

› **Çfarë përmban ky libër?**

Ky libër është konceptuar në përputhje me programin e klasës së gjashtë, të shkallës së tretë të lëndës Muzikë, miratuar nga MAS-i, në dhjetor 2014.

Meqenëse jemi në hapat e parë të kësaj reforme me qasjen e re bazuar në kompetenca, ky libër merr përsipër:

- **të sqarojë** çdo mësues/e të muzikës për të gjitha çështjet e planifikimit, metodologjisë dhe vlerësimit, që duhet të zbatojë çdo mësues/e në lëndën e tij/saj.
- **të prezantojë** dokumentet e hartuara dhe mënyrën se si ato duhet të përdoren nga vetë mësuesi/ja në lëndën e muzikës.
- **të udhëzojë** të gjitha formatet e reja: *planifikimi vjetor, tremujor, ditor, situatat e të nxënit, formatet e vlerësimit* etj., me të cilat duhet të punojë mësuesi/ja gjatë një viti shkollor.

Ndryshe nga çka mësuesi/ja është mësuar të gjejë në një libër mësuese/i, ky libër, në parim, jep dhe ofron modele ose sugjeron modele por nuk i dikton ato. Çdo model që ka të bëjë me planifikimin, me situatat e të nxënit, me metodologjinë apo me vlerësimin, krijohet mbi një bazë të caktuar të nivelit të klasës ku mësuesi/ja jep mësim.

Realiteti në çdo klasë, mund të sugjerojë modele të ndryshme, për tema të caktuara.

Autorja



I PROGRAMI MËSIMOR, KOMPETENCAT DHE KUPTIMI I TYRE

Ky libër ka si qëllim të japë disa orientime për krijimin e kushteve në ndërtimin e *kompetencave të lëndës së muzikës* si dhe të *kompetencave kyçe*, të cilat ndërthuren me njëra-tjetrën, si dhe realizimin e *temave ndërkurrikulare* nëpërmjet lëndës së muzikës, i cili është gjithashtu një komponent i rëndësishëm i programit të muzikës, për kontributin e muzikës në shoqëri dhe në jetën e përditshme. Në këtë libër, gjithashtu, përshkruhet *lidhja e muzikës me fushat e tjera kurrikulare*, në mënyrë që kurrikula e arsimit parauniversitar të funksionojë si një e tërë për realizimin e qëllimit kryesor, atë formimit të nxënësve.

Muzika zhvillohet në të gjithë arsimin e detyruar përmes 4 shkallëve, që përfshijnë *arsimin fillor (AF)* klasat 1-5 dhe *arsimin e mesëm të ulët (AMU)* klasat 6-9, pra dy cikle arsimimi, të cilat përfshijnë brenda tyre 9 vite shkollimi.

Të katërta shkallët grupohen në mënyrë të tillë:

- *shkalla e parë*: klasa përgatitore (mosha parashkollore, 5-6 vjeç) – klasa dytë
- *shkalla dytë*: klasa e tretë – klasa e pestë
- *shkalla e tretë*: klasa e gjashtë – klasa e shtatë
- *shkalla e katërt*: klasa e tetë – klasa e nëntë.

2.1 Kompetencat kyçe dhe muzika

Fjala *kompetencë* ka filluar të lakohet rëndom në mjediset mësimore. Kompetencat shprehen nëpërmjet përdorimit të njohurive, shkathtësive, vlerave dhe qëndrimeve në trajtimin e plotë dhe të kuptueshëm të situatave të kontekstit.

Këto ndryshime shtrojnë domosdoshmërinë e zotërimit të kompetencave që i aftësojnë individët/nxënësit/et të menaxhojnë ndryshimet dhe situatat e reja.

Në përputhje me qëllimet e arsimit parauniversitar, këto kompetenca janë:

1. **Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit.**
2. **Kompetenca e të menduarit.**
3. **Kompetenca e të mësuarit për të nxënë.**
4. **Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin.**
5. **Kompetenca personale.**
6. **Kompetenca qytetare.**
7. **Kompetenca digjitale.**

Kompetencat kyçe, në muzikë zhvillohen sipas një kontekstit të caktuar muzikor.

Në shkallën e tretë në programin mësimor të muzikës, ato vijnë të ndërtuara nga dy shkallët paraardhëse, I dhe II. Programi i muzikës ka në thelbin e tij krijimin e kushteve për ndërtimin e *kompetencave të lëndës* si dhe të kompetencave kyçe që lidhen me to.

■ **Tabela¹: Rezultatet kryesore të të nxënësve sipas kompetencave kyçe që realizohen nëpërmjet lëndës së muzikës për shkallën e tretë.**

SHKALLA E TRETË KLASA E GJASHTË DHE E SHTATË KOMPETENCAT KYÇE PËR T’U REALIZUAR NË MUZIKË	
Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit	
Nxënësi/ja:	<ul style="list-style-type: none"> • krijon personalitetin e vet në veprimtaritë artistike; • kupton drejt mesazhin artistik; • demonstroi një komunikim të qartë me anë të gjuhës muzikore, simboleve, shenjave dhe formave muzikore; • shfrytëzon mjetet artistike mundësitë e komunikimit dhe të të shprehurit në muzikë në mënyrë të pavarur.
Kompetenca e të menduarit	
Nxënësi/ja:	<ul style="list-style-type: none"> • kërkon dhe gjen njohuritë muzikore në mënyrë të pavarur; • zgjidh probleme të ndryshme muzikore/artistike; • zhvillon aftësitë për të menduar në mënyrë krijuese dhe ndërvepruese; • ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim muzikor.
Kompetenca e të mësuarit për të nxënë	
Nxënësi/ja:	<ul style="list-style-type: none"> • klasifikon mjetet për të realizuar një krijim muzikor; • përdor burime të ndryshme informacioni për të realizuar një krijim muzikor; • krijon në mënyrë të pavarur detyrën e dhënë.
Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin	
Nxënësi/ja:	<ul style="list-style-type: none"> • ndërmerr nisma për të zhvilluar aktivitete muzikore brenda dhe jashtë klasës duke kontribuar në mënyrë krijuese.
Kompetenca personale	
Nxënësi/ja:	<ul style="list-style-type: none"> • zhvillon besimin te vetja gjatë veprimtarive muzikore; • përfshihet në mënyrë aktive në jetën artistike shkollore dhe në komunitet; • rrit ndërgjegjësimin për veten, në zhvillimin e vetëbesimit dhe në krijimin e besimit te të tjerët.

¹ Kjo tabelë është shkëputur nga programi mësimor i muzikës, klasa gjashtë.

Kompetenca qytetare
<p>Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • bashkëpunon me të tjerët për çështje të ndryshme kulturore; • respekton punën e të tjerëve; • bashkëpunon me të tjerët pavarësisht kulturës, brenda dhe jashtë shkollës.
Kompetenca digjitale
<p>Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • krijon informacion si dhe bashkëpunon në rrjetet informuese në internet; • njeh mjete të ndryshme në funksion të informacionit muzikor si: magnetofon, audio, video CD, DVD etj.

Çdo mësues/e duhet të dijë pse shërbejnë **7 kompetencat kyçe**, dhe si t'i zhvillojë dhe ti ndërtojë ato në kontekstin e lëndës së vet me nxënësit/et sipas formateve të përcaktuara. Këto kompetenca ndërtohen dhe arrihen përgjatë një shkalle të caktuar, në këtë rast, **kompetencat kyçe** të shkallës së tretë lidhen me klasën e gjashtë dhe të shtatë, të AMU-s. Mësues/ja duhet të kujdeset që përveç kompetencave lëndore të muzikës, të zhvillojë domosdoshmërisht me nxënësit/et e tij/saj edhe kompetencat kyçe.

2.2 Kuptimi dhe zbatimi i kompetencave dhe tematikave që zhvillohen në lëndën e muzikës:

Qasja e bazuar në kompetenca është i gjithë procesi i të nxënit që zhvillohet në fushën e arteve në përgjithësi, në të gjitha shkallët, dhe që ndërtohet përmes kompetencave të kësaj fushe të **krijimit, të performimit/interpretimit dhe të vlerësimit**. Në të gjitha shkallët e kurrikulës, ato zhvillohen dhe plotësohen më tej me **kompetencat specifike lëndore të muzikës**. Kompetencat lëndore të muzikës, jo vetëm lidhen dukshëm dhe në mënyrë logjike e metodike me **kompetencat kyçe**, por këto kompetenca janë të lidhura ngushtë me tematikat e lëndës së muzikës dhe zhvillohen nëpërmjet tyre. Përvetësimi i muzikës nënkupton **zotërimin e kompetencave muzikore**. Në këto kushte, **zotërimi i kompetencave muzikore** do të thotë aftësia për të kuptuar, për të gjykuar, për të përdorur muzikën në një shumëllojshmëri situatash dhe kontekstesh jo vetëm brenda kontekstit të programit mësimor dhe kërkesave të tij, por edhe në situata në të cilën muzika luan ose mund të luajë një rol të rëndësishëm.

Me kurrikulën e re, muzika është strukturuar me tri (3) **kompetenca**, të cilat listohen si më poshtë:

Kompetenca 1: Krijimi muzikor: kjo kompetencë ka të bëjë me përdorimin e ideve të ndryshme për të organizuar krijimin muzikor, përdorimin e elementeve muzikore gjatë krijimit, zhvillimin e ideve të reja gjatë krijimit, dhe organizimin e krijimit sipas strukturës muzikore, duke ndarë përvojat e veta krijuese me të tjerët.

Kompetenca 2: Performimi/interpretimi muzikor: kjo kompetencë ka të bëjë me kuptimin dhe zbatimin e teknikave të këndimit, të luajtjes në instrument, të interpretimit, të improvizimit deri në perfeksionim. Ajo ka të bëjë gjithashtu me respektimin e rregullave të luajtjes në instrument dhe ndarjen e përvojave të veta performuese me të tjerë.

Kompetenca 3: Vlerësimi muzikor: kjo kompetencë ka të bëjë me kuptimin dhe analizimin e veprave muzikore që nga format e vogla e deri tek ato të mëdhatë, duke bërë një gjykim kritik dhe estetik që i përgjigjet kësaj grupmoshe.

■ Tabela² e kompetencave lëndore të muzikës dhe përshkrimi i tyre.

Në krah të kompetencës lëndore është bërë përshkrimi i asaj çka duhet të realizojë nxënësi/ja për ndërtimin e secilës kompetencë muzikore.

Kompetencat muzikore	Përshkrimi i kompetencave lëndore
1. Krijimi muzikor	<p>Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • përdor ide të ndryshme për të organizuar krijimin muzikor; • përdor elementet muzikore gjatë krijimit; • zhvillon ide të reja gjatë krijimit muzikor; • organizon krijimin e vet muzikor, sipas rregullave të strukturës së periudhës muzikore; • ndan përvojat e veta krijuese me të tjerët.
2. Performimi/interpretimi muzikor	<p>Nxënësi/ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • zhvillon teknikat e këndimit, të luajtjes, të dëgjimit, të analizimit dhe të improvizimit në nivele të ndryshme; • perfeksionon këndimin duke zbatuar teknikat e performimit/interpretimit muzikor; • respekton rregullat e luajtjes në instrumente; • ndan përvojat e veta performuese me të tjerë.

² Kjo tabelë është marrë nga programi mësimor i muzikës, klasa e gjashtë, shkalla e tretë.

3. Vlerësimi i veprave muzikore	Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • analizon veprat muzikore që nga format e vogla e deri tek ato të mëdha; • vlerëson veprat muzikore, duke bërë një gjykim kritik dhe estetik.
--	--

Tematikat që përshkojnë lëndën e muzikës


Bazuar në këtë kurrikul, lënda e muzikës synon të përmbushë 3 kompetencat e lëndës, të cilat lidhen me kompetencat kyçe që një nxënësi/e duhet të zotërojë gjatë jetës së tij dhe që arrihen nëpërmjet 3 tematikave kryesore.

Tematikat zhvillohen përgjatë programit, dhe krijojnë kushte që nxënësi/ja të ndërtojë dhe të zbatojë njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat, në funksion të kompetencave të lëndës dhe të ndërtimit të kompetencave kyçe. Për secilën tematikë janë paraqitur njohuritë për secilën klasë të çdo shkalle përkatëse. Përshkrimi i secilës tematikë dhe përshkrimi i kompetencave lëndore që duhet të demonstrojë nxënësi/ja lidhur me tematikat përkatëse paraqiten vetëm në nivel shkalle.

TEMATIKAT E MUZIKËS	KOMPETENCAT E MUZIKËS
<i>Tematika 1:</i> Gjuha dhe komunikimi muzikor.	Kompetenca 1: Krijimi muzikor.
<i>Tematika 2:</i> Teknika dhe procese muzikore.	Kompetenca 2: Performimi/interpretimi muzikor.
<i>Tematika 3:</i> Historia, muzika dhe shoqëria.	Kompetenca 3: Vlerësimi i veprave muzikore.



■ **Diagrami³: Kompetencat kyçe, lëndore dhe tematikat e muzikës.**



³ Ky diagram është marrë nga programi mësimor i muzikës, klasa e gjashtë, shkalla e tretë.

Nëse do të bënim një shpjegim të diagramit, vërejmë se *kompetencat kyçe* dhe *kompetencat lëndore* zhvillohen përmes *tematikave* të lëndës së muzikës, ku në qendër të mësimdhënies është nxënësi/ja.

2.4 Lidhja e muzikës me fushat e tjera kurrikulare - diagrami⁴

Muzika është e lidhur me lëndët brenda fushës së saj, por edhe me fusha të tjera të nxëni në kurrikul. Melodia, ritmi, harmonia, dinamika, temp, forma, struktura etj., lidhen shumë mirë me disiplinat e tjera artistike brenda fushës së arteve si: kërcimin, artin pamor, teatrin, por edhe me fusha të tjera të nxëni brenda kurrikulës si: matematikën, gjuhën dhe komunikimin, shkencat shoqërore etj. Kështu mësuesit/et duhet t'u japin mundësinë nxënësve/eve të konsolidojnë dhe formojnë përvojat që ata/ato kanë krijuar, duke i pasuruar dhe duke u dhënë drejtim të mëtejshëm këtyre përvojave. Më poshtë paraqiten disa lidhje ndërlëndore të muzikës me lëndë të tjera, të para përmes njohurive.



⁴ Ky diagram është marrë nga programi mësimor i muzikës, klasa e gjashtë, shkalla e tretë.

III PLANIFIKIMI I KURRIKULËS

Planifikimi i kurrikulës është një proces mjaft i rëndësishëm në punën e mësuesit/es që zgjat gjithë vitin shkollor. Përgatitja e dokumenteve që shoqërojnë punën e tij/e saj përgjatë vitit janë të shumta dhe kanë të bëjnë me *planifikimin e kurrikulës dhe dokumentet* përkatëse. Planifikimi këtyre dokumenteve të kurrikulës së re nga Mësues/ja kërkon: liri, fleksibilitet dhe përgjegjshmëri në planifikim. Këto dokumente janë:

- 1) **Planifikimi vjetor i lëndës së muzikës**
- 2) **Planifikimi 3 mujor (i ndërthurur sipas tematikave)**

Planifikimi i planit vjetor dhe tremujor, bëhet sipas ndarjes së kohës mësimore që sugjeron programi mësimor i muzikës dhënë në tabelën e mëposhtme:

Tabela 1: Koha mësimore për çdo tematikë

	Gjuha dhe komunikimi muzikor	Teknikat dhe proceset	Historia, muzika dhe shoqëria	Gjithsej orë
Shkalla e tretë				
Klasa e gjashtë	14	15	6	35 orë

Planifikimi vjetor i programit është i ndërtuar **me tremujorë**, ku secili tremujor ka një grup të caktuar orësh, në bazë të kohës mësimore të përcaktuara në programin mësimor. Pra kemi tashmë një term të ri: **tremujor** dhe jo **semestër**.

Për shkak të specifikës që ka lënda e muzikës, tematikat ndërthuren me njëra-tjetrën, për të mos e bërë monotone orën mësimore dhe lëndën, dhe për të ndërthurur njohuritë me njëra-tjetrën përgjatë:

- a) planifikimit vjetor të tremujorëve
- b) planifikimit tremujor temë për temë.

Tremujorët në modelin e mëposhtëm i kemi ndarë, duke bërë një përlllogaritje të përafërt të zgjatjes së shkollës përgjatë këtyre periudhave me + ose –, që çdo mësues/e i llogarit vetë.

■ Planifikimi vjetor i lëndës muzikë, sipas tremujorëve

Tematikat	Shpërndarja e përmbajtjes lëndore		
	Shtator – Dhjetor 14 orë	Janar – Mars 12 orë	Prill – Qershor 9 orë
Gjuha dhe komunikimi muzikor (14 orë)	Komunikojmë përmes tingujve	Koha 2/4,	Nota dhe pushimi 1/8
	Pentagrami çelësi i solit	Koha 3/4 dhe pika e vlerës.	Lidhja vlerëse dhe shprehëse.
	Vendosja e notave në pentagram (notat në vija e fusha).	Koha 4/4.	
	Notat poshtë e sipër pentagramit.		
	Gjatësia e tingujve.		
	Masa muzikore dhe shenjat e përsëritjes.		
Përforcim	Përforcim	Projekt	
Teknika dhe procese muzikore (15 orë)	Himni Kombëtar.	Kënga “Prit sinjalin pastaj ik”	Këngë djepi, Brahms.
	Kënga “Ëndërr”.	Kënga “Fyelli i bariut”	Kënga “The farmer in the dell”.
	Kënga “Delja rudë”.	Kënga “Urim mësueses”	Luajmë me fyell në kohët e thjeshta.
	Kënga “Alfabeti shqip”.	Kënga “Neve jemi lulebore”	
	Fyelli dhe rregullat e lojës së fyellit.	Luajmë me fyell në kohët e thjeshta	
	Ushtrime teknike hap pas hapi.	Luajmë me fyell në kohët e thjeshta.	
Historia, muzika dhe shoqëria (6 orë)	Struktura muzikore: motivi-fraza-fjalë-periudha.	Format muzikore 1-2-3 pjesëshe.	Minueti
		Ndërtimi muzikor monodik, polifonik, kanoni.	Forma e thjeshtë muzikore.
			Projekt
35 orë	14 orë	12 orë	9 orë

■ Planifikimi 3 mujor⁵, lënda muzikë, Periudha: shtator - dhjetor



Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe

Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit

1. Krijon personalitetin e vet në veprimtaritë artistike.
2. Kupton drejt mesazhin artistik.
3. Demonstron një komunikim të qartë me anë të gjuhës muzikore, simboleve, shenjave dhe formave muzikore.
4. Shfrytëzon mjetet artistike mundësitë e komunikimit dhe të të shprehurit në muzikë në mënyrë të pavarur.

Kompetenca e të menduarit

1. Kërkon dhe gjen njohuritë muzikore në mënyrë të pavarur.
2. Zgjidh probleme të ndryshme muzikore/artistike.
3. Zhvillon aftësitë për të menduar në mënyrë krijuese dhe ndërvepruese.
4. Ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim muzikor.

Kompetenca e të mësuarit për të nxënë

1. Klasifikon mjetet për të realizuar një krijim muzikor.
2. Përdor burime të ndryshme informacioni për të realizuar një krijim muzikor.
3. Krijon në mënyrë të pavarur detyrën e dhënë.

Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin

1. Ndërmerr nisma për të zhvilluar aktivitete muzikore brenda dhe jashtë klasës duke kontribuar në mënyrë krijuese.

Kompetenca personale

1. Zhvillon besimin tek vetja gjatë veprimtarive muzikore.
2. Përfshihet në mënyrë aktive në jetën artistike shkollë dhe komunitet.
3. Rrit ndërgjegjësimin për veten, në zhvillimin e vetëbesimit dhe në krijimin e besimit te të tjerët.

Kompetenca qytetare

1. Bashkëpunon me të tjerët për çështje të ndryshme kulturore.
2. Respekton punën e të tjerëve.
3. Bashkëpunon me të tjerët pavarësisht kulturës, brenda dhe jashtë shkollës.

Kompetenca digjitale

1. Krijon informacion si dhe bashkëpunon në rrjetet informuese në internet.
2. Njeh/përdor mjete të ndryshme në funksion të informacionit muzikor si: magnetofon, audio, video CD, DVD etj.

⁵ Bazuar në specifikën që ka kjo lëndë d.m.th. të ndërthurjes së tematikave, përshkrimi i tyre dhe i kompetencave lëndore mund të bëhet më vete, por gjithmonë bazuar vetëm në gamën e njohurive që do t'u jepen nxënësve/eve për çdo tremujor.

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të lëndës		
<i>Krijimi muzikor:</i>	<i>Performimi/interpretimi muzikor:</i>	<i>Vlerësimi muzikor:</i>
<ul style="list-style-type: none"> ♪ kombinime të ndryshme vlerash notash dhe pushimesh; ♪ përdor simbole të ndryshme muzikore të mësuara, duke krijuar diversitet në krijimin e vet; ♪ demonstroi kuptimin e tyre gjatë shpjegimit të krijimit të vet; ♪ komunikon qartë njohuritë muzikore, duke i lidhur ato me emocionet e këngëve që këndon; ♪ provon të këndojë fragmente të vogla muzikore për të kuptuar <i>ndryshueshmërinë e muzikës</i>; ♪ krijon një motiv muzikor të personalizuar; ♪ imiton me zë ose fishkëllimë motive nga vepra të ndryshme muzikore. 	<ul style="list-style-type: none"> ◆ demonstroi gjatë interpretimit të këngëve simbolet muzikore; ◆ luan apo këndon duke respektuar simbolikat e mësuara; ◆ këndon duke respektuar teknikën e këndimit përmes rregullave të përcaktuara; ◆ interpreton këngët me ndjenjë dhe emocion; performon/interpreton këngët në eventet e klasës apo të shkollës; ◆ performon / interpreton këngë të ndryshme me emocion; ◆ vlerëson interpretimin dhe performimin e të tjerëve; ◆ përdor media (DVD, CD, magnetofon) për të reklamuar /prezantuar punën e vet; ◆ ndan përvojën e vet artistike me të tjerët. 	<ul style="list-style-type: none"> ☉ shpjegon ndryshueshmërinë e muzikës gjatë respektimit të simboleve; ☉ bën lidhje ndërmjet asaj që di mbi format muzikore, instrumentet apo vokalin dhe asaj që dëgjon në një vepër muzikore; ☉ bën gjykime kritike ndaj një muzike të caktuar, duke u mbështetur në gjuhën muzikore <i>ndryshueshmërinë e ritmeve muzikore, shpejtësinë muzikore, formën muzikore, karakterin</i> e pjesëve muzikore; ☉ komunikon mendimin e vet rreth veprave muzikore të dëgjuara; ☉ reflekton emocionet që i krijojnë një vepër muzikore gjatë kohës që interpretohet/luhet; ☉ shpreh mendimin e vet rreth pjesës muzikore që dëgjon; ☉ përdor një fjalor të thjeshtë muzikor; ☉ respekton mendimin e shokëve/ shoqeve; ☉ merr pjesë në aktivitete të ndryshme brenda dhe jashtë shkollës.

■ **Tremujori i parë Shtator - Dhjetor, planifikimi i temave mësimore**

NR.	TEMATIKA	TEMAT MËSIMORE	SITUATA E PARASHIKUAR E TË NXËNIT	BURIMET
1.	<i>Teknika dhe procese</i>	Himni Kombëtar	Kombi dhe identiteti im shqiptar Improvizohet një kuiz me pyetje rreth historisë së Flamurit dhe Historisë së Shqipërisë.	Teksti i nxënësit/es, materiale nga enciklopedia, materiale nga interneti, postera me tekstin e këngës, me flamurin kombëtar, foto, CD.
2.	<i>Gjuha dhe komunikimi muzikor</i>	Komunikojmë përmes tingujve.	Një ditë në mjedisin e shkollës time (apo në një luginë) Vetë nxënësit/et kërkojnë dhe zbulojnë shumëllojshmëri burimesh tingullore, nga mjedisi përreth tyre, apo në natyrë, duke përcaktuar karakteristikat e tyre sipas asaj që dëgjojnë.	Materiale nga mjedisi që lëshojnë tinguj teksti i nxënësit/es, CD.
3.	<i>Gjuha dhe komunikimi muzikor</i>	Pentagrami dhe çelësi i solit.	Simbolet muzikore dhe kuptimi i tyre Nxënësit/et shkruajnë simbole të ndryshme dhe japin kuptimet e tyre. Pastaj gjejnë në tekst gjithçka me të cilën ata nënkuptojnë një simbol muzikor.	Teksti i nxënësit/es detyrë e kryer nga nxënësit, materiale të përgatitur a nga mësuesi/ja, materiale nga interneti.
4.	<i>Teknika dhe procese</i>	Kënga “Ëndërr”.	Unë dhe muzika Një ditë në X-factor... nxënësit shprehen për këngët që pëlqejnë, duke kënduar fragmente dhe duke shprehur dëshirat e tyre rreth asaj që duan të bëhen në jetë.	Teksti i nxënësit/es, materiale të ndryshme enciklopedike.

5.	<i>Gjuha dhe komunikimi muzikor</i>	Notat muzikore	Loja e emrave Vizatohet pentagrami në mesin e klasës në dysheme dhe çdo nxënës mban në duar një emër të notave në vija ose në fusha. Sapo përmendet emri i notës, nxënësi zë vend mbi vijën apo në fushën e pentagramit.	Teksti i nxënësit/es, libra të ndryshëm muzikorë, materiale të përgatitura nga mësuesi/ja.
6.	<i>Teknika dhe procese</i>	Kënga “Delja rudë”.	Qengji kafshë e dashur Nxënësit/et gjejnë materiale nga mjedisi rreth blegtorisë, diskutojnë për të mirat që marrin nga qengjat dhe delet.	Teksti i nxënësit/es, materiale nga enciklopedia, materiale nga interneti për këngën popullore kosovare.
7.	<i>Gjuha dhe komunikimi muzikor</i>	Notat poshtë dhe sipër pentagramit.	Loja e emërtimit të notave Vazhdohet zgjerimi i situatës: tema 5.	Teksti i nxënësit/es, libra të ndryshëm muzikorë, materiale të përgatitura nga mësuesi/ja.
8.	<i>Teknika dhe procese</i>	Fyelli – rregullat e luajtjes me të.	Të ngjashëm dhe të ndryshëm Vendosen disa foto të instrumenteve frymore popullore ose sillen konkretisht disa modele fyejsh që duken të ngjashëm, por që në të vërtetë ndryshojnë nga vrimat, gjatësia e trupit të fyellit apo bokina.	Teksti i nxënësit/es, instrumenti i fyellit.
9.	<i>Teknika dhe procese</i>	Kënga “Alfabeti shqip”.	Vazhdohet zgjerimi i situatës: tema 1.	Teksti i nxënësit/es, materiale nga enciklopedia, materiale nga interneti, postera me shkollën e parë shqipe, foto të autorëve të këngëve, CD me këngë.
10.	<i>Gjuha dhe komunikimi muzikor</i>	Gjatësia e tingujve.	Gjeni ndryshimet... Vendosen nota të ndryshme muzikore, duke pyetur ku janë ndryshimet dhe pse shërbejnë këto ndryshime? A duhen respektuar ato?	Teksti i nxënësit/es, libra të ndryshëm muzikorë, materiale të përgatitura nga mësuesi/ja.

11.	<i>Gjuha dhe komunikimi muzikor</i>	Ushtrime me fyell.	Folklori muzikor i popullit tim Vazhdohet zgjerimi i situatës: tema 8.	Teksti i nxënësit/es, instrumenti i fyellit.
12.	<i>Gjuha dhe komunikimi muzikor</i>	Masa muzikore dhe shenjat e përsëritjes.	Gjuha dhe muzika Shenjat e pikësimit në gjuhë - presja. Nxënësit flasin për funksionin që luan presja në gjuhë. Po në muzikë si vendoset presja? Por kur duam të përsëritim idenë çfarë bëjmë?	Teksti i nxënësit/es, libra të ndryshëm muzikorë, materiale të përgatitura nga mësuesi/ja.
13.	<i>Historia, shoqëria, muzika</i>	Format muzikore (motivi - fraza - fjalia - periudha).	Forma në pikturë dhe forma në muzikë Nxënësit/et flasin për format që shikojnë në mjedis, në pikturë, dhe më pas diskutojnë për format në muzikë.	Teksti i nxënësit/es, materiale të përgatitura nga mësuesi/ja, magnetofoni, CD me fragmente muzikore.
14.		Përforcim		
<p>Metodologjia Metoda interaktive, bashkëvepruese, gjithëpërfshirëse. Puna në grup dhe puna individuale. Hetimi dhe zbulimi. Zbatime praktike brenda dhe jashtë klase. Metoda integruese. Bashkëbisedim. Teknika që zhvillojnë mendimin kritik dhe krijues. Prezantime në forma të ndryshme, përfshirë TIK. Projekte kurrikulare.</p>				



METODOLOGJIA E MËSIMDHËNIES

4 Metodologjia e të nxënit dhe e mësimdhënies bazuar në kompetenca në lëndën e muzikës

Planifikimi i situatave të të nxënit - Planifikimi ditor

Përdorimi i metodologjive efikase në procesin e të nxënit të muzikës është kusht për rritjen e cilësisë së arritjeve nga ana e nxënësve/eve, duke i dhënë secilit /ës mundësinë të shfaqë dhe të zhvillojë potencialin muzikor/artistik që zotëron brenda vetes. Organizimi i mirë i procesit të mësimin të muzikës, do të thotë që nxënësit/et vendosen në situata konkrete krijuese, ku ata/ato përjetojnë dhe provojnë vetë gjatë proceseve muzikore. Kjo arrihet vetëm nëpërmjet motivimit dhe përkundrejt zhvillimit të kompetencave të caktuara si dhe tematikave përkatëse mësimore.

Mësimdhënia e muzikës, për nga vetë natyra, nënkupton një veprimtari krijuese, shprehëse, emocionale. Çdo përmbajtje dhe veprimtari mësimore muzikore është e pëlqyeshme dhe krijon emocione, kur nxënësit/et qasen drejt saj në mënyrë të vetëdijshme, çka u mundëson atyre shprehjen e potencialit intelektual/krijues dhe artistik në shumë aspekte.

Mësimdhënia e muzikës, synon gjithëpërfshirjen dhe bazohet *në mësimdhënien dhe në nxënien bazuar në kompetenca; në mësimdhënien me në qendër nxënësin dhe në mësimdhënien e nxënien e integruar.*

Nxënësit/et e një klase janë të ndryshëm, për sa i përket mënyrës se si ata/ato nxënë: individualisht, në grup, nën udhëheqjen e mësuesit/es, të pavarur/a, me anë të mjeteve konkrete etj.

Planifikimi dhe përzgjedhja e metodave të mësimdhënies në mësimin e muzikës mban parasysh:

- kompetencat kryesore të të nxënit në muzikë;
- lidhjen konceptuale, ruajtjen e koherencës vertikale të njohurive e të aftësive në kuptimin që ndërtimi i çdo njohurie dhe edukimi i çdo aftësie mbështetet në ato të mëparshmet;
- vazhdimin e formimit dhe forcimin e aftësive dhe të shprehive muzikore;
- rëndësinë e zbatimeve krijuese/interpretuese/vlerësuese muzikore (brenda dhe

- jashtë klasës), të cilat lidhin konceptet muzikore me situata të jetës reale;
- rëndësinë e përdorimit të mjeteve muzikore konkrete didaktike dhe ato të teknologjisë CD, DVD, kompjuter, magnetofon;
- nevojën e individit për të nxënë gjatë gjithë jetës;
- rëndësinë e qëndrimit pozitiv ndaj lëndës së muzikës dhe vlerësimit të përdorimit të gjithanshëm të saj;
- nxitjen e bashkëveprimit mësues/e-nxënës/e që në procesin mësimor mësues/ ja dhe nxënësi/ ja të jenë plotësues/e të njëri-tjetrit.

Një mësimdhënie e planifikuar mirë, krijon kushtet e nevojshme për një nxënie të suksesshme dhe lehtëson, si punën e mësuesit/es, ashtu edhe atë të nxënësit/es. Kompetencat muzikore janë të përcaktuara në këtë program, janë të ndërlidhura dhe zhvillohen nëpërmjet situatave të të nxënësve që kanë në qendër pjesëmarrjen aktive të nxënësve/eve. Ata/ato janë aktivë/e kur përfshihen në veprimtari, krijojnë ose stimulojnë të njohuritë, të interpretimeve/performimeve, të gjykimeve dhe të qëndrimeve. Për të siguruar këtë pjesëmarrje aktive të nxënësve/eve, mësues/ ja duhet të krijojë një atmosferë që i bën ata të ndihen të lirshëm/me dhe të zhduken për të zhvilluar njohuritë e tyre në muzikë.

Gjithashtu, është e rëndësishme që nxënësi/ ja të punojë me situata dhe veprimtari konkrete ku i kërkohen arsyetime apo përgjigje të pyetjeve të tilla si: Pse më pëlqen? A është melodioze? Cilat instrumente dëgjoj? Pse shquhet ky kompozitor? etj. Në këtë mënyrë ai/ ajo inkurajohet të reflektojë mbi veprimet e veta dhe të zhvillojë situata të reja në kontekste të caktuara.

Projektet kurrikulare afatgjata janë një tjetër mënyrë për t'i krijuar nxënësit/ets mundësinë të zbatojë njohuritë dhe aftësitë që zotëron, dhe nga ana tjetër të krijojë lidhje integrale me lëndë të tjera në fushën e arteve dhe jashtë saj. Edhe prezantimet e projekteve, diskutimet, debatet gjatë realizimit të tyre janë mundësi shumë e mirë për realizimin e kompetencave muzikore/artistike, por mbi të gjitha të kompetencave kyçe.





■ PLANIFIKIMI DITOR PËR TREMUJORIN E PARË SHTATOR – DHJETOR BAZUAR NË SITUATË TË NXËNI

Situata e të nxënimit për secilin model të planifikimit ditor, është sugjeruese, sepse kërkon të nxisë dhe të orientojë mësuesit/et rreth zhvillimit të orës mësimore. Niveli i nxënësve/eve, burimet materiale, përvoja e vetë mësuesit/es, mjetet në dispozicion për realizimin e orës mësimore, dhe për këtë arsye edhe vendosja e rezultateve të të nxënimit për zhvillimin e kompetencave kyçe dhe lëndore, nuk mund të jenë për të gjithë njësoj. Kështu që çdo mësues/e zgjedh të zhvillojë temën mësimore sipas këtij modeli të sugjeruar, një situatë tipike për klasën e tij.

Planifikimi ditor

Data.....

Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: III	Klasa: 6-të
Tematika: Teknika dhe procese Tema mësimore: “Himni Kombëtar”		Situata e të nxënimit: Kombi dhe identiteti im shqiptar Improvizohet një kuiz me pyetje rreth historisë së flamurit dhe vendit që ka zënë ky moment në historinë e Shqipërisë.	
 Rezultatet e të nxënimit sipas kompetencave kyçe <i>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit: (4) Shfrytëzon mjetet artistike, mundësitë e komunikimit dhe të të shprehurit në muzikë në mënyrë të pavarur.</i> <i>Kompetenca e të mësuarit për të nxënë: (3) Krijon në mënyrë të pavarur detyrën e dhënë.</i> <i>Kompetenca qytetare: (1) Bashkëpunon me të tjerët për çështje të ndryshme kulturore.</i> <i>Kompetenca digjitale: (1) Krijon informacion dhe bashkëpunon në rrjetet informuese në internet.</i>			
 Rezultatet e të nxënimit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore: <ul style="list-style-type: none"> - komunikon qartë njohuritë muzikore, duke i lidhur ato me emocionet e këngëve që këndon; - këndon duke respektuar teknikën e këndimit përmes rregullave të përcaktuara; - interpreton këngët me ndjenjë dhe emocion; - respekton interpretimin dhe performimin e shokëve/shoqeve; - ndan përvojën e vet artistike me të tjerët; - respekton këngë të kulturave të tjera. 		<input checked="" type="checkbox"/> Fjalë kyçe: <ul style="list-style-type: none"> - melodi e këngës, - tekst i këngës, - rregulla të këndimit, - himn, - flamur, - këngë himn. 	

Modele udhëzuese për zhvillimin e mësimin

- **Paraqiten** flamurët dhe shtrohet pyetja: Kujt shteteve u përkasin këta flamurë?



- **Vendosen** për dëgjim disa minuta, fragmente muzikore nga himni:

- shqiptar,
- kosovar
- europian.

- **Pyeten nxënësit/et:** Cilët nga fragmentet që dëgjuat njihni? Po fragmentet e tjera muzikore a i keni dëgjuar ndonjëherë? Si quhen ato? Kur i dëgjoni këto fragmente çfarë ju vjen ndërmend? Çfarë karakteri kanë këto melodi? Të fuqishëm, madhështor, melodioz, të ëmbël, të trishtueshëm etj?

- **Nxiten nxënësit/et** të flasin rreth historikut të himneve nëse dinë diçka rreth tyre.

- ☹ **Vendoset** për dëgjim kënga dhe **vazhdohet** puna me mësimin e këngës “Himni i flamurit”, sipas metodës:

- ☞ këndimi varg pas vargu;
- ☞ përsëritja e vargjeve herë pas here;
- ☞ këndimi i strofës;
- ☞ këndimi i strofës dhe i refrenit;
- ☞ përsëritja e këngës nga fillimi në fund;
- ☞ interpretimi i këngës me ndjenjë dhe emocion;
- ☞ këndimi i këngës vetëm dhe në grup.

Gjatë mësimin të këngës, kujdes tregohet për respektimin e *ritmit, të intonacionit e të interpretimit të këngës.*





Detyrë plotësuese për dosjen¹ e nxënësit/es:

- Ese për historikun e ngritjes së flamurit shqiptar.
- Ese për shprehjen e emocioneve kur këndohet himni shqiptar.
- Historik i shkurtër rreth personaliteteve që luftuan për ngritjen e flamurit shqiptar *ppt.*
- Historik i shkurtër rreth personaliteteve të krijimit të muzikës së Himnit shqiptar *ppt.*

¹ Detyrat plotësuese mund të jepen, dhe vetë nxënësi/ja e plotëson dosjen përgjatë tremujorit. Dosja është detyrim i çdo nxënësi/je sipas kërkesave që ju do t'i jepni. Nxënësi/ja zgjedh një prej tyre. Në dosjen e tij në fund të tremujorit ai duhet të ketë detyra të ndryshme të realizuara përgjatë tremujorit: një detyrë përmbledhëse (prezantim mbi një temë) dhe një projekt: një CD, një DVD me punë të vetat.

Planifikimi ditor

Data.....

Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: III	Klasa: 6-të
Tematika: Gjuha dhe komunikimi muzikor Tema mësimore: “Komunikojmë përmes tingujve”		Situata e të nxënimit: Një ditë në mjedisin e shkollës (apo në një luginë) Vetë fëmijët kërkojnë dhe zbulojnë shumëllojshmëri burimesh tingullore, në mjedisin përreth tyre apo në natyrë, duke përcaktuar karakteristikat e tyre sipas asaj që dëgjojnë.	
 Rezultatet e të nxënimit sipas kompetencave kyçe <i>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit:</i> (2) Kupton drejt mesazhin artistik. <i>Kompetenca e të menduarit:</i> (1) Kërkon dhe gjen njohuritë muzikore në mënyrë të pavarur. <i>Kompetenca për të nxënë:</i> (2) Krijon në mënyrë të pavarur detyrën e dhënë. <i>Kompetenca qytetare:</i> (1) Bashkëpunon me të tjerët për çështje të ndryshme. <i>Kompetenca digjitale:</i> (2) Njeh/përdor mjete të ndryshme në funksion të informacionit muzikor si: magnetofon, audio, video, CD, DVD etj.			
 Rezultatet e të nxënimit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore: <ul style="list-style-type: none"> - demonstroi kuptimin e tingujve dhe i klasifikoi ato; - provoi të këndoje fragmente të vogla muzikore për të kuptuar ndryshueshmërinë e muzikës dhe karakterin që ato kanë; - përdori media (DVD, CD, magnetofon) për të reklamuar /prezantuar punën e vet; - ndan përvojën e vet artistike me të tjerët. 		<input checked="" type="checkbox"/> Fjalë kyçe: <ul style="list-style-type: none"> - tingull, - zhurma, - karakteristikë/cilësi. 	
 Burimet: <ul style="list-style-type: none"> - materiale nga mjedisi që lëshojnë tinguj, - fragmente muzikore, - teksti i nxënësit/es, - CD me shembuj konkretë. 		Lidhja me fushat e tjera: <ul style="list-style-type: none"> - Shkencat e natyrës: Fizika. Lidhja me temat ndërkurrikulare: <ul style="list-style-type: none"> - Muzika dhe mjedisi. 	
 Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve Mësimi fillon me një veprimtari konkrete ku mësuesi/ja bashkë me nxënësit/et në oborrin e shkollës ose (nëse shkolla është në një mjedis afër si lugina apo pylli) identifikojnë shumëllojshmëri tingujsh duke i emërtuar ato sipas karakteristikave që ato kanë.			

Ndërtimi i njohurive të reja

- Veprimtaria mësimore vazhdon më tej, ku Mësues/ja krijon një situatë si konkurs duke sjellë përmes dëgjimit në magnetofon shumëllojshmëri tingujsh që e kanë burimin e tyre nga mjedisi, nga muzika (instrumentet ose zërat), duke iu kërkuar nxënësve/eve që ata ti klasifikojnë ato sipas grupit ku ato bëjnë pjesë: natyror, njerëzor, muzikor.
- Nxënësit/et dëgjojnë, përcaktojnë dhe emërtojnë karakteristikat e tingujve që dëgjojnë, duke edhe shpjeguar dukuritë e tyre. Ata mund të sjellin konkretisht nëpërmjet *youtube* apo *internetit*, *magnetofonit* fragmente të ndryshme muzikore duke diskutuar edhe mbi karakterin e muzikës që dëgjojnë.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Nxënësit:

- dëgjojnë burime të ndryshme të tingujve duke bërë klasifikimet e tyre.
- shpjegojnë ndjesinë që ju japin tinguj të ndryshëm kur ata i dëgjojnë.
- evidentojnë pjesë të ndryshme muzikore vokale apo instrumentale, ku shpjegojnë pse ju pëlqejnë.
- krijojnë burime të ndryshme tingullore duke i sjellë ato në klasë me CD / DVD.

Punimet, nëse nxënësit/et kanë bërë, ruhen në dosjen e tyre.

Vlerësimi

Vlerësimi i nxënësit/es do të kryhet për:

- diskutimet që ai/ajo bën, duke lidhur njohuritë e tij/saj me temën e re.
- përcaktimin e tingujve, klasifikimin e tyre në mjedise të ndryshme muzikore ose jo.
- për pjesëmarrjen në gjetjen dhe në realizimin e informacionit.

Shënime specifike:



Modele udhëzuese për zhvillimin e mësimit

► **U kërkohet** nxënësve/eve që për 3 minuta të dëgjojnë dhe të dallojnë tingujt. Ata përcaktojnë tingujt e dëgjuar: dera e klasës, ecja e makinave, boria e makinave, zilja e shkollës, zërat e shokëve etj., duke përshkruar edhe karakteristikat e tyre.

► **Shkruhet** në dërrasë të zezë tabela e mëposhtme, ose paraqitet në ppt, dhe u kërkohet nxënësve/eve ta plotësojnë atë.

BURIMET E TINGUJVE			
Natyrorë		Njerëzore	
TINGUJT	ZHURMAT	TINGUJT	ZHURMAT

► **Vazhdohet** më tej me dëgjime të fragmenteve muzikore, qëllimi i të cilave është rikujtimi njohurive të marra në klasë të pestë. Kujdes, fragmentet muzikore duhet të jenë didaktike dhe të zhvillojnë përmes melodive apo këngëve:

- ☞ karakterin,
- ☞ shpejtësinë,
- ☞ ritmin në të cilën zhvillohet melodia apo kënga.

► Ushtrime dhe lojëra argëtuese

Plotëson temën duke iu shpërndarë fëmijëve një fjalëkryq për argëtim.

1. Përbëhet nga melodia dhe teksti.
2. Elementet që e përbëjnë atë janë ritmi, melodia.
3. Merret me studimin e tingujve.
4. Nuk janë të pëlqyeshëm për veshin tonë.
5. Formohen nga dridhje të rregullta të një trupi elastik në ajër.
6. Lejon të dëgjojmë tinguj të gjatë/të shkurtër.
7. Lejon të dëgjojmë tinguj të lartë/të ulët.
8. Lejon të dallojmë një zë nga një tjetër.






			1	K				
	2	M						
3	A							
	4	Zh						
5	T							
6	Gj							
7	L							
	8	T						

Detyrë plotësuese për dosjen e nxënësit:

- Cd ku janë incizuar *tinguj* dhe *zhurma* nga burime të ndryshme tingullore.
- Cd me fragmente të ndryshme muzikore ku dallohet qartë: *ritmi, karakteri dhe shpejtësia e pjesës muzikore.*
- Historik “Si u krijua metronomi Mahlzel” për t’u prezantuar në *Power Point.*

Planifikimi ditor

Data.....


Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: III	Klasa: 6-të
Tematika: Gjuha dhe komunikimi muzikor Tema mësimore: “Pentagrami dhe çelësi i solit”		Situata e të nxënimit: Simbolet muzikore dhe kuptimi i tyre Nxënësit/et shkruajnë simbole të ndryshme dhe japin kuptimet e tyre. Pastaj gjejnë në tekst gjithçka me të cilën ata nënkuptojnë një simbol muzikor.	
 Rezultatet e të nxënimit sipas kompetencave kyçe <i>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit:</i> (2 dhe 3) Kupton drejt mesazhin artistik. Demonstron një komunikim të qartë me anë të gjuhës muzikore, simboleve, shenjave dhe formave muzikore. <i>Kompetenca e të menduarit:</i> (1) Kërkon dhe gjen njohuritë muzikore në mënyrë të pavarur. <i>Kompetenca për të nxënë:</i> (2) Krijon në mënyrë të pavarur detyrën e dhënë. <i>Kompetenca personale:</i> (1) Zhvillon besimin te vetja gjatë veprimtarive muzikore.			
 Rezultatet e të nxënimit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> - përdor simbole të ndryshme muzikore të mësuara, duke krijuar diversitet në krijimin e vet; - demonstroi kuptimin e tyre gjatë shpjegimit të krijimit të vet; - shpjegon ndryshueshmërinë e muzikës gjatë respektimit të simboleve. 		 Fjalë kyçe: <ul style="list-style-type: none"> - pentagram, - çelës muzikor, - çelësi i solit. 	
 Burimet: <ul style="list-style-type: none"> - teksti i nxënësit/es, - detyrë e kryer nga nxënësit/et, - materiale përgatitur nga mësuesi/ja; - material nga interneti. 		Lidhja me fushat e tjera: <ul style="list-style-type: none"> - Shkencat shoqërore dhe mjedisi: Historia. - Gjuhët dhe komunikimi: Letërsia. 	
 Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve Mësimi fillon me një veprimtari konkrete ku mësuesi/ja vendos dy simbole të ndryshme dhe kërkon që kuptimin e tyre ta nxjerrë nga vetë nxënësit/et. Ato mund të jenë nga jeta e përditshme në rrugë, spital, institucione etj.			
Ndërtimi i njohurive të reja Ora mësimore vazhdon më tej, ku mësues/ja krijon një tjetër situatë duke sjellë përmes figurave apo fotove të ndryshme njëra pas tjetrës, mënyrën se si ka evoluar pentagrami nga dy vija në pesë vija, çelësi i solit, apo vendosja e çelësve të tjerë muzikorë. Nxënësit/et vëzhgojnë pentagramin, çelësat muzikorë dhe punojnë në fletoren e tyre, duke ushtruar dorën.			

Modele udhëzuese për zhvillimin e mësimit

► **Paraqiten** disa simbole të ndryshme dhe shtrohet pyetja: Çfarë simbolizojnë këto figura?



► **Vazhdohet** paraqitja e disa simboleve të tjera, ku fëmijët pyeten nëse i njohin ato.



► **Shpjegohen** *simbolet muzikore* të paraqitura së fundmi. Nxënësit/et duhet:

- të kuptojnë çfarë është pentagrami dhe pse shërben ai;
- të kuptojnë çfarë është çelësi i solit dhe pse shërben ai;
- të dinë kush janë disa çelësa të tjerë që përdoren në muzikë;
- të ushtrojnë dorën për të shkruar çelësin e solit.

► Ushtrime dhe lojëra argëtuese

Rretho përgjigjen e saktë.






- | | |
|---|-----|
| 1. Çelësi i solit vendoset gjithmonë në fillim të pentagramit. | V G |
| 2. Çelësi i solit fillon të shkruhet në vijën e tretë të pentagramit. | V G |
| 3. Në muzikë përdoren tre çelësa muzikorë. | V G |
| 4. Pentagrami përbëhet nga katër vija dhe pesë fusha. | V G |

Detyrë plotësuese për dosjen e nxënësit:

Historik i gjetur në internet për krijimin e çelësit të *solit*, për t'u prezantuar në *Power Point*.

Planifikimi ditor

Data.....

Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: III	Klasa: 6-të
Tematika: Teknika dhe procese. Tema mësimore: Kënga “Ëndërr”.		Situatat e të nxënimit: Unë dhe muzika Një ditë në X-factor... nxënësit shprehen për këngët që pëlqejnë, duke kënduar fragmente dhe duke shprehur dëshirat e tyre rreth asaj që duan të bëhen në jetë.	
 Rezultatet e të nxënimit sipas kompetencave kyçe <i>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit: (2) Shfrytëzon mjetet artistike mundësitë e komunikimit dhe të të shprehurit në muzikë në mënyrë të pavarur.</i> <i>Kompetenca e të menduarit: (2) Zgjidh probleme të ndryshme muzikore/artistike</i> <i>Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin: (1) Ndërmerr nisma për të zhvilluar aktivitete muzikore brenda dhe jashtë klasës duke kontribuar në mënyrë krijuese.</i> <i>Kompetenca personale: (1) Zhvillon besimin tek vetja gjatë veprimtarive muzikore.</i> <i>Kompetenca qytetare: (1) Bashkëpunon me të tjerët për çështje të ndryshme kulturore.</i>			
 Rezultatet e të nxënimit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> - komunikon qartë njohuritë muzikore, duke i lidhur ato me emocionet e këngëve që këndon; - këndon duke respektuar teknikën e këndimit përmes rregullave të përcaktuara; - interpreton këngët me ndjenjë dhe emocion; - respekton interpretimin dhe performimin e shokëve; - ndan përvojën e vet artistike me të tjerët, respekton këngë të kulturave të tjera. 		 Fjalë kyçe: <ul style="list-style-type: none"> - melodi e këngës, - teksti i këngës, - rregullat e këndimit, - kujdesi për profesionin. 	
 Burimet: <ul style="list-style-type: none"> - teksti i nxënësit/es, - materiale të ndryshme enciklopedike, - CD me vijën melodike të këngës. 		Lidhja me fushat e tjera: <ul style="list-style-type: none"> - Shkencat shoqërore dhe mjedisi: Gjuhët dhe komunikimi: Letërsia - TIK Vazhdohet zgjerimi i situatës: tema 5.	
 Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve Mësimi fillon me një veprimtari konkrete ku mësuesi/ja u kërkon nxënësve/eve të këndojnë këngët që pëlqejnë më shumë. Mësues/ja shkruan titujt e këngëve në dërrasë dhe i diskuton ato me nxënësit/et. Zgjedh nxënësit/et më të talentuar/a për t'i kënduar ato.			

Modele udhëzuese për zhvillimin e mësimin

► **Paraqiten** disa foto që nënkuptojnë profesione të ndryshme dhe hidhet pyetja se çfarë tregojnë këto foto:



mjek



mësues/e



inxhinier



këngëtar



balerinë

► **Nxiten** nxënësit/et të flasin për profesionin e tyre të parapëlqyer.




► **Rikujtohet** me nxënësit/et kënga “Ëndrra” e kompozitorit Agim Rrëza.

► **Vendoset** për dëgjim kënga dhe **vazhdohet** puna me mësimin e këngës “Ëndërr”, sipas metodës:

- ☞ këndimi varg pas vargu;
- ☞ përsëritja e vargjeve herë pas here;
- ☞ këndimi i strofës;
- ☞ këndimi i strofës dhe refrenit;
- ☞ përsëritja e këngës nga fillimi në fund;
- ☞ interpretimi i këngës me ndjenjë dhe emocion;
- ☞ këndimi i këngës vetëm dhe në grup;
- ☞ shoqërimi i këngës me instrumente me goditje.

► **Gjatë mësimin të këngës**, kujdes tregohet për respektimin e *ritmit*, *të intonacionit*, *të interpretimit të këngës*.

Ndahen nxënësit/et në grupe dhe shoqërojnë këngën me instrumente Orf.





	2	X	2	2	X	2	2	X	2	2	X	2	etj.
	2	X	2	X	2	X	2	X	2	X	2	etj.	
	2	2	X	X	X	X	2	X	X	X	etj.		

Detyrë plotësuese për dosjen e nxënësit/es:

- Ese për profesionin që do dëshironin të ushtronin kur të rriteshin (1 faqe).
- Ese për një ëndërr që ata kanë dëshirë t’u bëhet realitet (1 faqe).
- CD me këngë të tjera që flasin për dëshirat dhe ëndrrat.


Planifikimi ditor

Data.....

Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: III	Klasa: 6-të
Tematika: Gjuha dhe komunikimi muzikor. Tema mësimore: “Notat muzikore”.		Situata e të nxënët: Loja e emrave Vizatohet pentagrami në mesin e klasës në dysHEME dhe çdo nxënës mban në duar një emër të notave në vija ose në fusha. Sapo përmendet emri i notës, nxënësi zë vend mbi vijën apo në fushën e pentagramit.	
 Rezultatet e të nxënët sipas kompetencave kyçe <i>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit: (2) Kupton drejt mesazhin artistik.</i> <i>Kompetenca e të menduarit: (1) Kërkon dhe gjen njohuritë muzikore në mënyrë të pavarur.</i> <i>Kompetenca për të nxënë: (2) Krijon në mënyrë të pavarur detyrën e dhënë.</i> <i>Kompetenca personale: (1) Zhvillon besimin tek vetja gjatë veprimtarive muzikore.</i>			
 Rezultatet e të nxënët të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> - përdor simbole të ndryshme muzikore të mësuara, duke krijuar diversitet në krijimin e vet; - demonstroi kuptimin e tyre gjatë shpjegimit të krijimit të vet; - shpjegon ndryshueshmërinë e muzikës gjatë këndimit të simboleve (notave). 		<input checked="" type="checkbox"/> Fjalë kyçe: <ul style="list-style-type: none"> - nota në vija, - nota në fusha, - krijim muzikor. 	
 Burimet: <ul style="list-style-type: none"> - teksti i nxënësit/es, - libra të ndryshëm muzikorë, - materiale të përgatitura nga mësuesi/ja, - CD. 		Lidhja me fushat e tjera: <ul style="list-style-type: none"> - Shkencat shoqërore dhe mjedisi: Historia. - Gjuhët dhe komunikimi: Letërsia. Lidhja me temat ndërkurrikulare Muzika dhe mjedisi.	
 Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve Mësimi fillon me një veprimtari konkrete ku mësuesi/ja vizaton pentagramin në mesin e klasës në dysHEME dhe çdo nxënës mban në duar një emër të notave në vija ose në fusha. Sapo përmendet emri i notës, nxënësi zë vend mbi vijën apo në fushën e pentagramit.			
Ndërtimi i njohurive të reja Mësuesi/ja vazhdon më tej veprimtarinë e situatës, duke sjellë përmes figurave apo fotove të ndryshme njëra pas tjetrës, mënyrën se si kanë evoluar notat muzikore nga shenja të thjeshta që nënkuptonin një lartësi të caktuar në simbole që sot ne i quajmë nota muzikore. Nxënësit/et vëzhgojnë pentagramin, dhe notat muzikore dhe punojnë në fletoren e tyre, duke i vendosur ato në lartësi të ndryshme dhe duke i rinjohur përsëri ato nëpërmjet emërimit të tyre. Më pas nxënësit/et krijojnë kombinime të ndryshme me notat muzikore. Ata/ato lexojnë dhe këndojnë notat muzikore e mësuara vetëm ose në grup. Prezantojnë krijimet e tyre, duke i shpjeguar ato.			

► **Paraqiten** disa foto të ndryshme dhe shtrohet pyetja: Çfarë përfaqësojnë ato?

Alfabeti shqip - shkronjat



Melodi - notat muzikore



Një qer - sho - ri di - ta jo - në zem - rat ë - mbël seç kën - dojn'



larg pé - llu - mbat flu - tu - roj - në me ne pa - cja për - gjith - mon.

► **Vazhdohet** paraqitja e notave muzikore:

☹ 7 notat muzikore




☹ në vija 5 nota muzikore,

☹ në fusha 4 nota muzikore.


► **Shpjegohen** notat muzikore në vija dhe në fusha të paraqitura së fundmi. Nxënësit/et duhet të kuptojnë:

- çfarë janë notat muzikore dhe pse shërbejnë ato;
- nga e marrin emërtimin dhe ku shkruhen ato;
- si të ushtrojnë dorën dhe kujtesën për t'i shkruar dhe për t'i njohur ato.

Notat në vija:



Notat në fusha:



► **Ushtrime dhe lojëra argëtuese**

Emërto notat në vija dhe në fusha.



Mi La

► **Rretho përgjigjen e saktë.**






- | | | |
|--|---|---|
| 1. Nota La shkruhet në vijën e tretë. | V | G |
| 2. Nota Si shkruhet në fushën dytë. | V | G |
| 3. Nota Mi shkruhet në vijën e parë. | V | G |
| 4. Nota Mi shkruhet në fushën e katërt. | V | G |
| 5. Nota Sol shkruhet në vijën e dytë. | V | G |
| 6. Nota Re e shkruhet në vijën e parë. | V | G |
| 7. Nota Do shkruhet në fushën dytë. | V | G |
| 8. Nota Fa shkruhet në vijën e pestë | V | G |

Detyrë plotësuese për dosjen e nxënësit:

Historik (i marrë nga interneti) për notat muzikore dhe Guido D'Arecon, për t'u prezantuar në *Power Point*.

Planifikimi ditor

Data.....

Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: III	Klasa: 6-të
Tematika: Teknika dhe procese Tema mësimore: “ Delja rude”		Situata e të nxënit: Nxënësit/et diskutojnë rreth tingujve që lëshon delja kur blegërin, duke përcaktuar karakteristikat e tyre. Ata gjejnë materiale nga mjedisi rreth blegtorisë, diskutojnë me njëri-tjetrin, për të mirat që merren nga qengjat dhe delet.	
 Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe <p><i>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit: (2) Shfrytëzon mjetet artistike mundësitë e komunikimit dhe të të shprehurit në muzikë në mënyrë të pavarur.</i></p> <p><i>Kompetenca e të menduarit: (2) Zgjidh probleme të ndryshme muzikore/artistike</i></p> <p><i>Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin: (1) Ndërmerr nisma për të zhvilluar aktivitete muzikore brenda dhe jashtë klasës duke kontribuar në mënyrë krijuese.</i></p> <p><i>Kompetenca personale: (1) Zhvillon besimin tek vetja gjatë veprimtarive muzikore.</i></p> <p><i>Kompetenca qytetare: (1) Bashkëpunon me të tjerët për çështje të ndryshme kulturore.</i></p>			
 Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> - komunikon qartë njohuritë muzikore, duke i lidhur ato me emocionet e këngëve që këndon; - këndon duke respektuar teknikën e këndimit përmes rregullave të përcaktuara; - interpreton këngët me ndjenjë dhe emocion; - respekton interpretimin dhe performimin e shokëve; - ndan përvojën e vet artistike me të tjerët; - respekton këngë të kulturave të tjera. 		 Fjalë kyçe: <ul style="list-style-type: none"> - melodia e këngës, - teksti i këngës, - rregullat e këndimit, - kujdesi për kafshët. 	
 Burimet: <ul style="list-style-type: none"> - teksti i nxënësit/es, - materiale nga enciklopedi, - materiale nga interneti për këngën popullore kosovare, - CD me melodinë e këngës. 		Lidhja me fushat e tjera: <ul style="list-style-type: none"> - Shkencat e natyrës: Biologjia. - Gjuhët dhe komunikimi: Letërsia. Lidhja me temat ndërkurrikulare <ul style="list-style-type: none"> - Mjedisi. 	
 Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve Mësuesi/ja vendos në magnetofon 1-2 fragmente të këngëve popullore, të kënduara nga fëmijët. Mësuesi/ja nxit diskutimet rreth këngës popullore, duke tërhequr vëmendjen se kujt i kushtohen këto këngë popullore.			

Modele udhëzuese për zhvillimin e mësimit

► **Vendosen** për dëgjim këngë të thjeshta popullore që në përmbajtjet e tyre flasin për kafshët: dele, qingji, macja, qeni, patoku etj.



► **Nxiten** nxënësit/et të flasin për:

kafshën apo shpendin e tyre të parapëlqyer, këngët popullore që ata dinë,

për këngën popullore kosovare, duke kënduar vetë ata ndonjë fragment të këngës.

► **Rikujtohen** me nxënësit/et kënga “Qingji i vogël”, “Simfonia e kafshëve”.




► **Vendoset** për dëgjim kënga “Delja rude” dhe **vazhdohet** puna me mësimin e saj, sipas metodës:

- ☞ këndimi varg pas vargu;
- ☞ përsëritja e vargjeve herë pas here;
- ☞ këndimi i strofës;
- ☞ këndimi i strofës dhe refrenit;
- ☞ përsëritja e këngës nga fillimi në fund;
- ☞ interpretimi i këngës me ndjenjë dhe emocion;
- ☞ këndimi i këngës vetëm dhe në grup;
- ☞ shoqërimi i këngës me instrumente me goditje.



► **Gjatë mësimit të këngës**, kujdes tregohet për respektimin e *ritmit*, të *intonacionit*, të *interpretimit* të këngës.

Ndahen nxënësit/et në grupe dhe shoqërojnë këngën me instrumente Orf.





	2	X	~	X	~	X	~	X	~	X	~	X	~	X	~	X	~	X	~	X	~	etj.
		1	2	1	2	1	2	1	2	1	2	1	2	1	2	1	2	1	2	1	2	
	2	X	~	X	~	X	~	X	~	X	~	X	~	X	~	X	~	X	~	X	~	etj.
		1	2	1	2	1	2	1	2	1	2	1	2	1	2	1	2	1	2	1	2	
	2	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	etj.
		1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	

Detyrë plotësuese për dosjen e nxënësit/es:

- Një “kërkesë” drejtuar një institucioni për kujdesin ndaj kafshëve (1 faqe).
- Ese për të mirat materiale dhe ushqimore, që marrim nga: lopa, delja, qingji, dhia.
- CD me këngë të tjera popullore nga Kosova dhe informacion për to.

Planifikimi ditor

Data.....

Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: III	Klasa: 6-të
Tematika: Gjuha dhe komunikimi muzikor Tema mësimore: “Notat muzikore, poshtë dhe sipër pentagramit”.		Situata e të nxëniet: Gjuha dhe muzika (zgjerohet më tej kjo situatë)	
 Rezultatet e të nxëniet sipas kompetencave kyçe <i>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit: (2) Kupton drejt mesazhin artistik.</i> <i>Kompetenca e të menduarit: (1) Kërkon dhe gjen njohuritë muzikore në mënyrë të pavarur.</i> <i>Kompetenca për të nxënë: (2) Krijon në mënyrë të pavarur detyrën e dhënë.</i> <i>Kompetenca personale: (1) Zhvillon besimin tek vetja gjatë veprimtarive muzikore.</i>			
 Rezultatet e të nxëniet të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore: <ul style="list-style-type: none"> - përdor simbole të ndryshme muzikore të mësuara, duke krijuar larmi në krijimin e vet; - demonstroi kuptimin e notave sipër dhe poshtë pentagramit, gjatë shpjegimit të krijimit të vet; - shpjegon ndryshueshmërinë e muzikës gjatë këndimit të simboleve (notave). 		<input checked="" type="checkbox"/> Fjalë kyçe: <ul style="list-style-type: none"> - nota muzikore poshtë pentagramit, - nota muzikore sipër pentagramit. 	
 Burimet: <ul style="list-style-type: none"> - teksti i nxëniesit/es, - libra të ndryshëm muzikorë, - materiale të përgatitura nga mësuesi/ja. 		Lidhja me fushat e tjera: <ul style="list-style-type: none"> - Shkencat shoqërore dhe mjedisi: Historia. - Gjuhët dhe komunikimi: Letërsia. 	
 Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve Mësimi fillon me një veprimtari konkrete ku mësuesi/ja u rikujton nxënësve/eve mësimin e kaluar ku ata përcaktuan lartësinë e notave, duke vendosur në magnetofon tinguj <i>shumë të lartë</i> dhe <i>tinguj shumë të ulët</i> të krijuar nga objektet të ndryshme, të dëgjuar nga zëra njerëzorë të ndryshëm apo nga tingëllimi i instrumenteve të ndryshme. Mësues/ja mund të luajë në tastierë notat e larta dhe të ulëta, duke u shpjeguar nxënësve/eve notat poshtë dhe sipër pentagramit, të cilat emërtohen dhe marrin pozicione të ndryshme me anë të vijave ndihmëse.			
Ndërtimi i njohurive të reja Mësues/ja vazhdon më tej veprimtarinë, duke sjellë përmes figurave apo fotove të ndryshme njëra pas tjetrës, nota që shoqërohen me vija ndihmëse ose partitura muzikore ku vërehen qartë këto nota, dhe fillon të shpjegojë funksionin dhe rëndësinë që kanë vijat ndihmëse tek këto nota dhe si emërtohen ato. Nxëniesit/et fillojnë të shkruajnë këto nota nën dhe mbi pentagram, duke i emërtuar dhe mësuar ato. Më pas krijojnë kombinime të ndryshme të notave muzikore brenda pentagramit, poshtë dhe sipër pentagramit. Prezantojnë krijimet e tyre, duke i shpjeguar ato.			

Modele udhëzuese për zhvillimin e mësimit

► **Vendosen** në magnetofon dy fragmente muzikore, ku këndohen ose ekzekutohen tinguj *shumë të lartë* dhe *shumë të ulët* p.sh: kënga “Për ty Atdhe” – kënduar nga Mentor Xhemali, dhe “Zëra pranverorë” – Shtraus kënduar nga Inva Mula.

ose

► mund të luhen në tastierë notat e larta dhe të ulëta duke i përsëritur disa herë që nxënësit/et të kuptojnë ndryshimin.

► **Vazhdohet** paraqitja e notave muzikore në dërrasë apo *Power Point*:

- ☉ notat muzikore *poshtë* pentagramit
- ☉ notat muzikore *sipër* pentagramit

Kujdes!
Viját e vogla ndihmëse të vendosura në notat muzikore shërbejnë për të kuptuar lartësinë e notave *poshtë* dhe *sipër* pentagramit.

► **Shpjegohen** notat muzikore *poshtë* dhe *sipër* pentagramit, duke thënë se ashtu si dhe notat në vija, edhe ato në fusha kanë emërtimin dhe vendndodhjen e tyre në pentagram. Këto nota i vendosim në pentagram në një mënyrë të caktuar.

► **Nxënësit/et duhet:**

- të kuptojnë çfarë janë notat muzikore *poshtë* dhe *sipër* pentagramit dhe pse shërbejnë ato.
- të mësojnë nga e marrin emërtimin ato;
- të dinë ku shkruhen ato;
- të ushtrojnë dorën dhe kujtesën për t’i shkruar dhe për t’i njohur ato.

► Ushtrime dhe lojëra argëtuese 1, 2

1. Emërto notat poshtë pentagramit.

Do

2. Emërto notat sipër pentagramit.





Sol

Detyrë plotësuese për dosjen e nxënësit/es:

- Ushtrime të ndryshme me notat muzikore.


Planifikimi ditor

Data.....

Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: III	Klasa: 6-të
Tematika: Teknika dhe procese. Tema mësimore: “Fyelli – rregullat e luajtjes me të”.		Situata e të nxënësve: Të ngjashëm dhe të ndryshëm Vendosen disa foto të instrumenteve frymore popullore ose sillen konkretisht disa modele fyejsh që duken të ngjashëm, por që në të vërtetë ndryshojnë nga vrimat, gjatësia e trupit të fyellit apo bokina.	
 Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe <i>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit:</i> (1) Krijon personalitetin e vet në veprimtaritë artistike. <i>Kompetenca e të menduarit:</i> (3,4) Zhvillon aftësitë për të menduar në mënyrë krijuese dhe ndërvepruese. Ndjek udhëzimet për të luajtur një pjesë muzikore. <i>Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin:</i> (1) Luan në mënyrë të pavarur detyrën e dhënë. <i>Kompetenca për të nxënë:</i> (2) Interpreton vetëm dhe në grup. <i>Kompetenca qytetare:</i> (1) Bashkëpunon me të tjerët për çështje të ndryshme kulturore.			
 Rezultatet e të nxënësve të lëndës sipas temës mësimore: <ul style="list-style-type: none"> - luan apo këndon duke respektuar simbolikat e mësuara; - luan në instrument duke respektuar rregullat e këtij instrumenti; - respekton interpretimin dhe performimin e shokëve; - ndan përvojën e vet artistike me të tjerët. 		<input checked="" type="checkbox"/> Fjalë kyçe: <ul style="list-style-type: none"> - fyell, - rregull i luajtjes në instrument. 	
 Burimet: <ul style="list-style-type: none"> - teksti i nxënësit/es, - instrumenti i fyellit (bllokflaut), - CD me shembuj muzikorë. 		Lidhja me fushat e tjera: <ul style="list-style-type: none"> - Shkencat shoqërore dhe mjedisi: Historia - Gjuhët dhe komunikimi: Letërsia. Lidhja me temat ndërkurrikulare <ul style="list-style-type: none"> - Trashëgimia jonë kulturore. 	
 Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve Mësues/ja krijon një ritëm muzikor popullor nëpërmjet a) mjeteve trupore (shuplakave) b) veglave me goditje: shkopinjve ose qypit dhe u kërkon nxënësve/eve ta riprodhojnë ritmin. Mësuesi/ja më pas nxit diskutimet rreth instrumenteve popullore, duke rikujtuar instrumente të ndryshme dhe rëndësinë e përfaqësimit të tyre kudo si pjesë e trashëgimisë kulturore muzikore, dhe pjesë e përfaqësimit të identitetit tonë kombëtar. Diskutimi ndalet/përqendrohet te fyelli.			

Modele udhëzuese për zhvillimin e mësimit

► **Vendosen disa foto me instrumente të ndryshme muzikore popullore dhe nxënësit/ et të flasin nxiten rreth** instrumenteve muzikore popullore që kanë parë, kanë në familje, kanë luajtur ata vetë apo prindërit. Flitet rreth rëndësisë e përfaqësimit të tyre kudo, si pjesë e trashëgimisë kulturore muzikore dhe si pjesë e përfaqësimit të identitetit tonë kombëtar. Diskutimi ndalet te instrumenti i fyellit.



► **Improvizohet** duke krijuar një ritëm të thjeshtë nëpërmjet:

a) mjeteve trupore (*shuplakave*);

b) veglave me goditje (*shkopinjve* ose *qypit*).

U kërkohet nxënësve/eve ta riprodhojnë ritmin.

► **Vazhdohet me:**

- ⊗ njohjen me instrumentin e fyellit;
- ⊗ ndërtimin e fyellit dhe përbërjen e materialit të tij;
- ⊗ rregullat e mbajtjes dhe të luajtjes me të;
- ⊗ ekzekutimin e notave të gjata me fyell, duke dëgjuar tingullin e notës e si ajo përftohet;





⊗ ekzekutimin vetëm ose të gjithë bashkë të notave muzikore të gjata.

Detjrë plotësuese në shtëpi:

- Përsëritje e ekzekutimit të notave të gjata në instrument.
- Vizatimi i një instrumenti popullor sipas dëshirës.

Planifikimi ditor

Data.....

Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: III	Klasa: 6-të
Tematika: Teknika dhe procese. Tema mësimore: Kënga “Alfabeti shqip”.		Situata e të nxënësve: Kombi dhe gjuha jonë Improvizohet një kuiz me pyetje rreth historisë së krijimit të alfabetit shqiptar, duke sjellë momente historike të punës së palodhur të patriotëve tanë.	
 Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe			
<p><i>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit:</i> (4) Shfrytëzon mjetet artistike mundësitë e komunikimit dhe të të shprehurit në muzikë në mënyrë të pavarur.</p> <p><i>Kompetenca e të mësuarit për të nxënësve:</i> (3) Krijon në mënyrë të pavarur detyrën e dhënë.</p> <p><i>Kompetenca qytetare:</i> (1) Bashkëpunon me të tjerët për çështje të ndryshme kulturore.</p> <p><i>Kompetenca digjitale:</i> (1) Krijon informacion dhe bashkëpunon në rrjetet informuese në internet.</p>			
 Rezultatet e të nxënësve të lëndës sipas temës mësimore: <ul style="list-style-type: none"> - komunikon qartë njohuritë muzikore, duke i lidhur ato me emocionet e këngëve që këndon; - këndon duke respektuar teknikën e këndimit përmes rregullave të përcaktuara; - interpreton këngët me ndjenjë dhe emocion; - respekton interpretimin dhe performimin e shokëve; - ndan përvojën e vet artistike me të tjerët; - respekton këngë të kulturave të tjera. 		<input checked="" type="checkbox"/> Fjalë kyçe: <ul style="list-style-type: none"> - melodi e këngës, - tekst i këngës, - rregull i këndimit, - alfabeti shqip. 	
 Burimet: <ul style="list-style-type: none"> - teksti i nxënësve/es, - materiale historike, - materiale nga interneti, - CD me melodinë e këngës. 		Lidhja me fushat e tjera: <ul style="list-style-type: none"> - Shkencat shoqërore dhe mjedis: Historia. - Gjuhët dhe komunikimi: Letërsia. - TIK. Lidhja me temat ndërkurrikulare: <ul style="list-style-type: none"> - Identiteti Kombëtar. 	
 Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve Mësimi fillon duke rikujtuar këngët patriotike që nxënësve/et dinë, se kujt i kushtoheshin ato dhe pse u krijuan. A është simbol gjuha për një komb?			
Ndërtimi i njohurive të reja Mësues/ja vazhdon më tej veprimtarinë, duke vendosur në magnetofon dy këngë patriotike të ndryshme dhe nxit nxënësve/et të flasin për tematikën dhe idenë që përcjellin këto këngë. Ata/ato mësojnë këngën në grup, duke respektuar karakteristikat e këngës, e cila ka karakter marshi. Kënga këndohet disa herë në intonacion dhe në ritëm, duke respektuar rregullat e këndimit, dhe duke kënduar në grup.			

Modele udhëzuese për zhvillimin e mësimin

► **Paraqitet** fotoja dhe u kërkohet nxënësve/eve të thonë çfarë u kujton ajo.

► **Vendosen** për dëgjim disa fragmente të shkurtra nga këngë patriotike.


► **Nxiten** nxënësit/et të flasin rreth tematikës dhe idesë që përcjellin këto këngë.

► **Vendoset** për dëgjim kënga “Alfabeti shqip” dhe **vazhdohet** puna me mësimin e saj, sipas metodës:

- ☞ këndimi varg pas vargu;
- ☞ përsëritja e vargjeve herë pas here;
- ☞ këndimi i strofës;
- ☞ këndimi i strofës dhe refrenit;
- ☞ përsëritja e këngës nga fillimi në fund;
- ☞ interpretimi i këngës me ndjenjë dhe emocion;
- ☞ këndimi i këngës vetëm dhe në grup.

► **Gjatë mësimin të këngës**, kujdes tregohet për respektimin e *ritmit, të intonacionit, të interpretimit* të këngës.

Ndahen nxënësit/et në grupe dhe e shoqërojnë këngën me instrumente Orf.







Three rhythmic patterns for Orff instruments, each in 4/4 time. The first pattern uses maracas and has a sequence of notes: 1, 2, 3, 4, 1, 2, 3, 4, 1, 2. The second pattern uses a glockenspiel and has a sequence of notes: 1, 2, 3, 4, 1, 2, 3, 4, 1, 2. The third pattern uses a triangle and has a sequence of notes: 1, 2, 3, 4, 1, 2, 3, 4, 1, 2.

Detyrë plotësuese për dosjen e nxënësit/et:

- Historik i shkurtër rreth krijimit të shkollës së parë shqipe dhe rreth personaliteteve që luftuan për hapjen e saj.
- Historik i shkurtër rreth funksionit që kishin këngët patriotike dhe kush i shkroi ato.
- CD me këngë patriotike.

Planifikimi ditor

Data.....

Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: III	Klasa: 6-të
Tematika: Gjuha dhe komunikimi muzikor. Tema mësimore: “Gjatësia e tingujve”.		Situata e të nxëniet: Gjeni ndryshimet... Vendosen nota të ndryshme muzikore, duke pyetur ku janë ndryshimet dhe pse shërbejnë këto ndryshime? A duhen respektuar ato?	
 Rezultatet e të nxëniet sipas kompetencave kyçe <i>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit: (2) Kupton drejt mesazhin artistik.</i> <i>Kompetenca e të menduarit: (1) Kërkon dhe gjen njohuritë muzikore në mënyrë të pavarur.</i> <i>Kompetenca për të nxënë: (3) Krijon në mënyrë të pavarur detyrën e dhënë.</i> <i>Kompetenca personale: (1) Zhvillon besimin tek vetja gjatë veprimtarive muzikore.</i>			
 Rezultatet e të nxëniet të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> - përdor simbole të ndryshme muzikore të mësuara, duke krijuar larmi në krijimin e vet; - demonstron kuptimin e gjatësisë së tingujve/notave, gjatë shpjegimit të krijimit të vet; - shpjegon ndryshueshmërinë e muzikës gjatë këndimit të simboleve (notave) të gjata, të shkurtra apo pushimeve. 		<input checked="" type="checkbox"/> Fjalë kyçe: <ul style="list-style-type: none"> - gjatësi e tingullit, - pushim, - krijim. 	
 Burimet: <ul style="list-style-type: none"> - teksti i nxënësit/es, - shembuj të thjeshtë muzikorë, - materiale të përgatitura nga mësuesi/ja, - CD me shembuj. 		Lidhja me fushat e tjera: <ul style="list-style-type: none"> - Matematika. 	
 Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve Mësimi fillon me një veprimtari konkrete ku mësues/ja u rikujton nxënësve/eve karakteristikat e tingujve (tema 2) ku vetë nxënësit/et në një mjedis të caktuar i gjetën dhe i përcaktuan ato.			
Ndërtimi i njohurive të reja Mësues/ja vazhdon më tej veprimtarinë ku krijon një situatë të thjeshtë, siç mund të jetë <i>ndarja e mollëve në pjesë të ndryshme 2,4,8 pjesë</i> , ose përdor segmente vijash me gjatësi të ndryshme. Këtu nxënësve/eve u vjen në ndihmë edhe matematika. Më pas Mësues/ja fillon të shpjegojë funksionin dhe rëndësinë që ka gjatësia e notës në muzikë. Për ta kuptuar më mirë sillen shembuj të ndryshëm të gjatësive të tingujve duke filluar nga jeta e përditshme e deri tek zgjatja e notave muzikore. Nxënësit/et fillojnë të krijojnë modele ritmike me gjatësi të ndryshme të tingujve/ose gjejnë gjatësinë e tingujve në këngët e mësuara. Këto gjetje ata i shkruajnë në fletore duke krijuar kështu modele ritmike të thjeshta. Prezantojnë krijimet e tyre, duke i shpjeguar ato.			

Modele udhëzuese për zhvillimin e mësimit

► **Vendosen** për dëgjim disa fragmente me burime tingujsh të ndryshëm. Kjo u rikujton nxënësve/eve karakteristikat e tingujve (tema 2), të cilat ata/ato i gjetën dhe i përcaktuannë mjediset e ndryshme.


► **Vazhdohet** më tej dhe krijohet një situatë të thjeshtë, siç mund të jetë *ndarja e mollëve në pjesë të ndryshme 2,4,8 pjesë* ose përdoren segmente vijash në gjatësi të ndryshme. Këtu nxënësve/eve u vjen në ndihmë edhe matematika.




► **Vazhdohet me:**

- ☞ me shpjegimin e funksionit dhe të rëndësisë që ka gjatësia e notës në muzikë;
- ☞ me dhënien e shembujve të ndryshëm të gjatësive të tingujve, duke filluar nga jeta e përditshme dhe duke bërë krahasimin me gjatësinë e notave muzikore;
- ☞ krijimin e modeleve ritmike me gjatësi të ndryshme të tingujve;
- ☞ gjetjen e gjatësive të tingujve në këngët e mësuara;
- ☞ shkrimin e gjatësive përmes simboleve në fletore, duke krijuar kështu modele ritmike të thjeshta.
- ☞ paraqitjen e krijimeve, duke i shpjeguar ato.


► Ushtrime dhe lojëra argëtuese



Plotëso: • masat e mëposhtme në kohën 2/4, 3/4, 4/4.



• me nota ose pushime 1/4 ushtrimin e mëposhtëm.







Detyrë plotësuese për dosjen e nxënësit/es:

- Ushtrime të ndryshme me notat muzikore.

Planifikimi ditor

Data.....

Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: III	Klasa: 6-të
Tematika: Teknika dhe procese. Tema mësimore: “Luajmë në fyell”.		Situata e të nxënësve: Folklori muzikor i popullit tim. Vazhdohet zgjerimi i situatës: tema 8.	
 Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe			
<p><i>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurisë:</i> (1) Krijon personalitetin e vet në veprimtaritë artistike.</p> <p><i>Kompetenca e të menduarit:</i> (3,4) Zhvillon aftësitë për të menduar në mënyrë krijuese dhe ndërvepruese. Ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim muzikor.</p> <p><i>Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin:</i> (1) Luan në mënyrë të pavarur detyrën e dhënë.</p> <p><i>Kompetenca për të nxënë:</i> (3) Krijon në mënyrë të pavarur detyrën e dhënë.</p> <p><i>Kompetenca qytetare:</i> (1) Bashkëpunon me të tjerët për çështje të ndryshme kulturore.</p>			
 Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore: <ul style="list-style-type: none"> - luan apo këndon duke respektuar simbolikat e mësuara; - luan në instrument, duke respektuar rregullat e këtij instrumenti; - respekton interpretimin dhe performimin e shokëve/shoqeve; - ndan përvojën e vet artistike me të tjerët. 		<input checked="" type="checkbox"/> Fjalë kyçe: <ul style="list-style-type: none"> - fyell, - rregull i luajtjes në instrument. 	
 Burimet: <ul style="list-style-type: none"> - teksti i nxënësve/es, - instrumenti i fyellit (blokflaut), - CD. 		Lidhja me fushat e tjera: <ul style="list-style-type: none"> - Shkencat shoqërore dhe mjedisi: Historia. - Gjuhët dhe komunikimi: Letërsia. Lidhja me temat ndërkurrikulare <ul style="list-style-type: none"> - Trashëgimia jonë kulturore. 	
 Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve Mësuesi/ja rikujton rregullat e luajtjes në instrumentin e fyellit.			
Ndërtimi i njohurive të reja Nxënësit/et luajnë nota të gjata me fyellin, duke provuar shpesh ato se si përftohen ato. Ata/ato ekzekutojnë vetëm ose të gjithë së bashku notat muzikore të gjata apo të shkurtra.			

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Nxënësit/et:

- diskutojnë me njëri-tjetrin rreth instrumenteve popullore;
- ekzekutojnë në fyell nota të gjata muzikore;
- respektojnë rregullat e luajtjes në fyell.

Vlerësimi

Vlerësimi i nxënësit/es do të kryhet për:

- diskutimet që ai/ajo bën, duke lidhur njohuritë e tij/saj me temën e re;
- ekzekutimin korrekt të notave muzikore të gjata dhe të shkurtra në fyell, duke respektuar rregullat e luajtjes.

Shënime specifike:




Modele udhëzuese për zhvillimin e mësimit

► **Ushtrim me instrumentin e fyellit me dorën e majtë notat: Si - La - Sol dhe me dorën e djathtë notat: Fa - Mi - Re - Do.**


► Rikujtohen:

- ⊗ rregullat e mbajtjes dhe luajtjes me të;
- ⊗ ekzekutimin me dorën e majtë e notave Si - Sol - Sol;
- ⊗ ekzekutimin me dorën e djathtë në notat: Fa - Mi - RE - DO.
- ⊗ ekzekutimin vetëm ose të gjithë së bashku të notave muzikore të gjata.

Dora e majtë



Dora e djathtë







Detyrë plotësuese në shtëpi:

- Përsëritje e ekzekutimit të notave të gjata në instrument.

Planifikimi ditor

Data.....

Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: III	Klasa: 6-të
Tematika: Gjuha dhe komunikimi muzikor Tema mësimore: “Masa muzikore dhe shenjat e përsëritjes”		Situata e të nxënësve: Gjuha dhe muzika Shenjat e pikësimit në gjuhë - presja. Nxënësit flasin për funksionin që luan presja në gjuhë. Po në muzikë si vendoset presja? Por kur duam të përsërisim idenë çfarë bëjmë?	
 Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe <i>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit:</i> (2) Kupton drejt mesazhin artistik. <i>Kompetenca e të menduarit:</i> (1) Kërkon dhe gjen njohuritë muzikore në mënyrë të pavarur. <i>Kompetenca për të nxënë:</i> (3) Krijon në mënyrë të pavarur detyrën e dhënë. <i>Kompetenca personale:</i> (1) Zhvillon besimin te vetja gjatë veprimtarive muzikore.			
 Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore: <ul style="list-style-type: none"> - përdor simbole të ndryshme muzikore të mësuara, duke krijuar diversitet në krijimin e vet; - demonstroi kuptimin e masës dhe të shenjave të përsëritjes, gjatë shpjegimit të krijimit të vet; - shpjegon ndryshueshmërinë e muzikës gjatë këndimit të simboleve (shenjave të përsëritjes); - përdor një fjalor të thjeshtë muzikor. 		<input checked="" type="checkbox"/> Fjalë kyçe: <ul style="list-style-type: none"> - masë muzikore, - shenjat e përsëritjes. 	
 Burimet: <ul style="list-style-type: none"> - teksti i nxënësit/es, - libra të ndryshëm muzikorë, - materiale të përgatitura nga mësuesi/ja, - CD, shembuj. 		Lidhja me fushat e tjera: Matematika.	
 Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve Mësimi fillon me një veprimtari konkrete ku mësuesi/ja shkruan në dërrasë të zezë një fjali të shkurtër, pastaj një tjetër pa u vënë pikën në fund. Ai/ajo pyet nxënësit/et se çfarë mungon te fjalitë. Pika në fjalinë e shkruar, është si masa muzikore në muzikë.			
Ndërtimi i njohurive të reja <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria vazhdon, duke kënduar një këngë, ku mësuesi/ja i nxit nxënësit/et të përsëritin dy herë refrenin e këngës. Më pas u tregon shenjën e përsëritjes në muzikë se si ajo shkruhet dhe ku gjendet tek këngët që ata/ato mësojnë. • Nxënësit/et fillojnë të krijojnë nëpërmjet gjatësive të notave të ndryshme brenda një mase dhe i ekzekutojnë ato, vetëm ose në grup. • Prezantojnë krijimet e tyre, duke i shpjeguar ato. 			

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Nxënësit/et:

- krijojnë me gjatësi të ndryshme notash 8 masa muzikore, duke përdorur dhe shenjën e përsëritjes;
- i ekzekutojnë krijimet vetëm ose në grup;
- zhvillojnë detyrën me një tematikë të caktuar dhe prezantojnë atë;

Detyrat e krijuara prej nxënësve/eve ruhen në dosjen e tyre.

Vlerësimi

Vlerësimi i nxënësit/es do të kryhet për:

- diskutimet që ai/ajo bën, duke lidhur njohuritë e tij/saj me temën e re;
- krijimet personale muzikore të krijuara;
- për pjesëmarrjen aktive gjatë krijimit muzikor dhe në çështje të tjera që lidhen me temën e re.

Shënime specifike:



Modele udhëzuese për zhvillimin e mësimit

► Shkruhet në dërrasë fjalja:

Në lëndën e bukur të muzikës ne këndojmë dhe ushtrohemi në instrument

► Pyeten nxënësit/et se çfarë mungon te fjalja. Pika në fjalinë e shkruar, është si *masa muzikore* në muzikë.


Masa 2/4 = me vlerën e dy notave 1/4 dhe rrihet në dy lëvizje dore.



Masa 3/4 = me vlerën e tre notave 1/4 dhe rrihet në tre lëvizje dore.



Masa 4/4 = me vlerën e katër notave 1/4 dhe rrihet në katër lëvizje dore.



► Vazhdohet:

duke paraqitur masat muzikore me dy, tri dhe katër goditje brenda masave të dhëna në dërrasë apo *Power Point* duke krijuar nëpërmjet gjetësive të notave të ndryshme brenda një mase dhe pastaj nxënësit/et i lexojnë dhe i shpjegojnë ato.

Nxënësve/eve u kërkohet të këndojnë këngën “Alfabeti shqip” ta përsëritin *dy herë* refrenin e këngës. Më pas u tregohet *shenja e përsëritjes* në muzikë, si ajo shkruhet dhe ku gjendet tek këngët që ata/ato mësojnë.

Nxënësit/et duhet:

- të kuptojnë çfarë funksioni ka *masa muzikore* dhe pse shërben ajo;
- të kuptojnë dhe përdorin *shenjat e përsëritjes* gjatë leximit ose këndimit;
- të mësojnë si dhe ku shkruhen ato.

► Ushtrime dhe lojëra argëtuese

Disa nga masat e mëposhtme janë të sakta, disa jo. Gjej gabimet dhe plotëso masat.

a.

b.



c.



Detyrë plotësuese për dosjen e nxënësit:

- Ushtrime të ndryshme duke krijuar masa muzikore që përmbajnë brenda rrahje me dy, tri dhe katër goditje.

Planifikimi ditor

Data.....

Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: III	Klasa: 6-të
<p>Tematika: Historia, muzika dhe shoqëria</p> <p>Tema mësimore: “Format muzikore (motivi, fraza, fjalia, periudha)”.</p>		<p>Situata e të nxënit 1: Forma në pikturë dhe forma në muzikë.</p> <p>Nxënësit/et flasin për format që shikojnë në mjedis, në pikturë, dhe më pas diskutojnë për format në muzikë.</p> <p>Situata e të nxënit 2: Muzika dhe gjuha, të përbashkëtat</p> <p>Fjala, fjalia dhe përmbajtja në gjuhë. Motivi, fraza, fjalia, periudha në muzikë. Të përbashkëtat midis tyre.</p>	
<p> Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</p> <p><i>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit:</i> (3,4) Demonstron një komunikim të qartë me anë të gjuhës muzikore, simboleve, shenjave dhe formave muzikore. Shfrytëzon mjetet artistike mundësitë e komunikimit dhe të të shprehurit në muzikë në mënyrë të pavarur.</p> <p><i>Kompetenca e të menduarit:</i> (1) Kërkon dhe gjen njohuritë muzikore në mënyrë të pavarur.</p> <p><i>Kompetenca për të nxënë:</i> (2) Përdor burime të ndryshme informacioni për të realizuar një krijim muzikor.</p> <p><i>Kompetenca qytetare:</i> (1) Bashkëpunon me të tjerët për çështje të ndryshme kulturore.</p> <p><i>Kompetenca digjitale:</i> (1, 2) Krijon informacion dhe bashkëpunon në rrjetet informuese në internet. Njihet/përdor mjetet të ndryshme në funksion të informacionit muzikor si: magnetofon, audio, video CD, DVD etj.</p>			
<p> Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> - krijon një motiv muzikor të personalizuar; - imiton me zë ose fishkëllimë motive nga vepra të ndryshme muzikore; - bën lidhje ndërmjet asaj që di mbi format muzikore, instrumentet, vokalin dhe asaj që dëgjon në një vepër muzikore; - bën gjykime kritike ndaj një muzike të caktuar, duke u mbështetur në gjuhën muzikore <i>ndryshueshmërinë e ritmeve muzikore, shpejtësinë muzikore, formën muzikore, karakterin e pjesëve muzikore;</i> - komunikon mendimin e vet rreth veprave muzikore të dëgjuara; - përdor një fjalor të thjeshtë muzikor; - përdor media (DVD, CD, magnetofon) për të reklamuar/prezantuar punën e vet. 		<p><input checked="" type="checkbox"/> Fjalë kyçe:</p> <ul style="list-style-type: none"> - formë muzikore, - motiv, - frazë, - fjali, - periudhë. 	

 <p>Burimet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - teksti i nxënësit/es, - libra të ndryshëm muzikorë, - materiale të përgatitura nga mësuesi/ja, - CD, fragmente të ndryshme muzikore. 	<p>Lidhja me fushat e tjera:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Shkencat shoqërore dhe mjedisi: Historia. - Artet: arti pamor. <p>Lidhja me temat ndërkurrikulare</p> <p>Të njohim kulturën e njëri-tjetrit.</p>
 <p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve</p>	
<p>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve</p> <p>Mësimi fillon me një veprimtari konkrete ku mësuesi/ja shkruan në dërrasë të zezë një fjali të shkurtër, pastaj një tjetër pa vënë pikën në fund. Ai/ajo pyet nxënësit/et se çfarë mungon tek fjalitë. Pika në fjalinë e shkruar, është si masa muzikore në muzikë.</p>	
<p>Ndërtimi i njohurive të reja</p> <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria vazhdon duke vendosur simfoninë IX të Bethovenit, ku që në fillim dëgjohet motivi kryesor që shoqëron gjithë simfoninë. Mësues/ja u kërkon nxënësve/eve që të gjejnë çfarë atyre u bën përshtypje, duke ua drejtuar vëmendjen te motivi muzikor. Më pas u kërkon që të gjejnë duke e dëgjuar përsëri pjesën se ku ky motiv përsëritet. • Ai/ajo u shpjegon formën muzikore, si ndërtohet ajo, duke bërë paralelizma edhe me fjalinë në gjuhë, ndërtimin e së cilës nxënësit/et e njohin shumë mirë. Ashtu sikurse fjalia ka pjesët përbërëse të saj edhe muzika ka pjesët përbërëse të saj. • Mësues/ja vendos përsëri për t’u dëgjuar fragmente të tjera muzikore, në të cilat motivi dëgjohet shumë qartë dhe identifikohen pjesët e tjera që përbëjnë periudhën muzikore (frazja, fjalia). • Pjesa shoqërohet me shpjegime biografike dhe historike të kohës dhe të autorit. • Nxënësit/et gjejnë të dhëna në internet rreth jetës së L.V.Bethovenit. 	
<p>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura</p> <p>Nxënësit/et:</p> <ul style="list-style-type: none"> - identifikojnë motivin, frazën, fjalinë dhe periudhën në muzikë; - ekzekutojnë këngë në formë periudhe vetëm ose në grup; - zhvillojnë detyrën me një tematikë të caktuar dhe e prezantojnë atë. <p>Detyrat e krijuara të nxënësve/eve ruhen në dosjen e tyre.</p>	
<p>Vlerësimi</p> <p>Vlerësimi i nxënësit/es do të kryhet për:</p> <ul style="list-style-type: none"> - diskutimet që ai/ajo bën, duke lidhur njohuritë e tij/saj me temën e re; - krijimet personale muzikore të krijuara; - për pjesëmarrjen aktive gjatë krijimit muzikor dhe në çështje të tjera që lidhen me temën e re. 	
<p>Shënime specifike:</p> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/>	




Elementet

kryefjalë
kallëzues
parafjalë
përcaktor

Modele udhëzuese për zhvillimin e mësimit

► **Paraqiten** disa piktura që paraqesin forma të ndryshme dhe shtrohet pyetja: Çfarë formash janë ato?



► **Paraqiten:** Dy elemente si, muzika dhe gjuha, të përbashkëta e tyre.

Fjala, fjalia dhe përmbajtja në gjuhë dhe motivi, fraza, fjalia, periudha në muzikë.

Veprimtaria vazhdon duke vendosur simfoninë IX të Bethovenit, ku që në fillim dëgjohet motivi kryesor që shoqëron gjithë simfoninë. U kërkohet nxënësve/eve të gjejnë çfarë u bën përshtypje, duke ua drejtuar vëmendjen te motivi muzikor.

Më pas ju kërkohet atyre që duke e dëgjuar përsëri pjesën të gjejnë se ku ky motiv dëgjohet përsëri.

► **Shpjegohet:**

- ☞ forma muzikore dhe si ndërtohet ajo, duke bërë paralelizma edhe me fjalinë në gjuhë;
- ☞ që nxënësit/et duhet ta njohin shumë mirë ndërtimin e saj;
- ☞ motivi, fraza, fjalia dhe periudha muzikore, duke i ndjekur dhe i përcaktuar ato konkretisht përmes dëgjimit.
- ☞ vepra, e cila shoqërohet edhe me shpjegime biografike dhe historike të kohës dhe të kompozitorit.
- ☞ se si nxënësit/et mund të gjejnë të dhëna në internet rreth jetës së L.V. Bethovenit.

► Ushtrime dhe lojëra argëtuese 1, 2

1. Më poshtë gjendet refreni i këngës “Për mëmëdhenë”. Me ndihmën e mësuesit/es përcakto: *motivin, frazën, fjalinë dhe periudhën muzikore (shih librin e nxënësit/es).*

2. Rretho përgjigjen saktë.

- | | | |
|--|---|---|
| 1. Struktura muzikore është kombinimi i elementeve të saj. | V | G |
| 2. Një frazë muzikore është e plotë kur përbëhet nga 8 masa. | V | G |
| 3. Periudha muzikore përbëhet nga 1 fjali. | V | G |
| 4. Fjalia pyetëse është përfundimtare. | V | G |
| 5. Fjalia muzikore përbëhet nga dy fraza. | V | G |

Detyrë plotësuese për dosjen e nxënësit/es:

- Historik i gjetur në internet për *simfoninë V dhe jetën e Bethovenit për t’u prezantuar në Power Point.*
- CD me pjesë të zgjedhura nga Bethoveni.



VERIFIKO NJOHURITË

1 Plotëso përkufizimet e mëposhtme.

- Pjesa më e vogël e melodisë është _____.
- Dy motive formojnë _____.
- Katër masa formojnë _____.
- Dy fjali formojnë _____.

2 Rretho përgjigjen e saktë.





- | | | |
|---|---|---|
| 1. Burimet e tingujve janë njerëzore dhe natyrore. | V | G |
| 2. Tingulli formohet nga dridhje të parregullta të një trupi elastik në ajër. | V | G |
| 3. Zhurma formohet nga dridhje të rregullta të një trupi elastik në ajër | V | G |
| 4. Lartësia e tingujve na lejon të dëgjojmë tinguj të gjatë dhe të shkurtër. | V | G |
| 5. Intensiteti i tingujve na lejon të dëgjojmë tinguj të fortë dhe të butë. | V | G |
| 6. Gjatësia e tingujve na lejon të dallojmë tinguj të lartë dhe të ulët. | V | G |
| 7. Timbri i një tingulli na lejon të dallojmë një zë nga një tjetër. | V | G |

3 Këndo ose luaj me fyell meloditë e mëposhtme dhe shkruaj emrin e kompozitorit dhe titullin e melodive.

a.

b.

- 4 Vendosi në pentagram notat e shkruara brenda rrethit dhe formo masa në kohën 2/4.



■ **Tremujori i dytë: Janar - Mars, planifikimi i temave mësimore**



Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe

Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit

1. Krijon personalitetin e vet në veprimtaritë artistike.
2. Kupton drejt mesazhin artistik.
3. Demonstron një komunikim të qartë me anë të gjuhës muzikore, simboleve, shenjave dhe formave muzikore.
4. Shfrytëzon mjetet artistike, mundësitë e komunikimit dhe të të shprehurit në muzikë në mënyrë të pavarur.

Kompetenca e të menduarit

1. Kërkon dhe gjen njohuritë muzikore në mënyrë të pavarur.
2. Zgjidh probleme të ndryshme muzikore/artistike.
3. Zhvillon aftësitë për të menduar në mënyrë krijuese dhe ndërvepruese.
4. Ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim muzikor.

Kompetenca e të mësuarit për të nxënë

1. Klasifikon mjetet për të realizuar një krijim muzikor.
2. Përdor burime të ndryshme informacioni për të realizuar një krijim muzikor.
3. Krijon në mënyrë të pavarur detyrën e dhënë.

Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin

1. Ndërmerr nisma për të zhvilluar aktivitete muzikore brenda dhe jashtë klasës, duke kontribuar në mënyrë krijuese.

Kompetenca personale

1. Zhvillon besimin te vetja gjatë veprimtarive muzikore.
2. Përfshihet në mënyrë aktive në jetën artistike shkollë dhe komunitet.
3. Rrit ndërgjegjësimin për veten, në zhvillimin e vetëbesimit dhe në krijimin e besimit te të tjerët.

Kompetenca qytetare

1. Bashkëpunon me të tjerët për çështje të ndryshme kulturore.
2. Respekton punën e të tjerëve.
3. Bashkëpunon me të tjerët, pavarësisht kulturës, brenda dhe jashtë shkollës.

Kompetenca digjitale

1. Krijon informacion si dhe bashkëpunon në rrjetet informuese në internet.
2. Njeh mjetet e ndryshme në funksion të informacionit muzikor si: magnetofon, audio, video, CD, DVD etj.

Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave të lëndës		
<i>Krijimi muzikor:</i>	<i>Performimi/interpretimi muzikor:</i>	<i>Vlerësimi muzikor:</i>
<p>♪ krijon në kohët 2/4, 3/4;</p> <p>♪ krijon duke përdorur kombinime të ndryshme vlerash notash dhe pushimesh;</p> <p>♪ demonstroi kuptimin e tyre gjatë shpjegimit të krijimit të vet;</p> <p>♪ komunikoi qartë njohuritë muzikore, duke i lidhur ato me emocionet e këngëve që këndon;</p> <p>♪ provoi të këndojë fragmente të vogla muzikore për të kuptuar <i>ndryshueshmërinë e muzikës</i>.</p>	<p>◆ demonstroi gjatë interpretimit të këngëve simbolet muzikore;</p> <p>◆ luan në instrument apo këndon duke respektuar simbolikat e mësuara;</p> <p>◆ këndon duke respektuar teknikën e këndimit përmes rregullave të përcaktuara;</p> <p>◆ interpretoi këngët me ndjenjë dhe emocion; performoi/interpretoi këngët në eventet e klasës apo të shkollës;</p> <p>◆ përdori media (DVD, CD, magnetofon) për të reklamuar/prezantuar punën e vet.</p>	<p>☺ shpjegoi ndryshueshmërinë e muzikës gjatë respektimit të simboleve;</p> <p>☺ shpreh emocionet e veta për këngët që këndon;</p> <p>☺ përdori një gjuhë të qartë dhe të thjeshtë, gjatë përjetimit emocional të pjesëve muzikore që dëgjon;</p> <p>☺ ndan përvojën e vet artistike me të tjerët;</p> <p>☺ respekton këngë të kulturave të tjera;</p> <p>☺ bëri lidhje ndërmjet asaj që di mbi format muzikore, instrumentet apo vokalin dhe asaj që dëgjon në një vepër muzikore;</p> <p>☺ bëri gjykim kritik ndaj një muzike të caktuar, duke u mbështetur në gjuhën muzikore, në <i>ndryshueshmërinë e ritmeve muzikore, në shpejtësinë muzikore në formën muzikore, në karakterin e pjesëve muzikore</i>;</p> <p>☺ komunikoi mendimin e vet rreth veprave muzikore të dëgjuara;</p> <p>☺ reflektoi emocionet që i krijon një vepër muzikore gjatë kohës që interpretohet/luhet;</p> <p>☺ shpreh mendimin e vet rreth pjesës muzikore që dëgjon;</p> <p>☺ përdori një fjalor të thjeshtë muzikor;</p> <p>☺ respekton mendimin e shokëve/shoqeve;</p> <p>☺ mori pjesë në aktivitete të ndryshme brenda dhe jashtë shkollës.</p>

■ **Tremujori i dytë: Janar - Mars, planifikimi i temave mësimore**

NR.	TEMATIKA	TEMAT MËSIMORE	SITUATA E PARASHIKUAR E TË NXËNIT	BURIMET
1.	<i>Teknika dhe procese</i>	Kënga: “Prit sinjalin pastaj ik”.	<p>Situata e të nxënit: Respektimi i rregullave.</p> <p>Nxënësit/et kuptojnë se të respektosh rregullat në çdo mjedis apo situatë është detyrim. Edhe muzika ka rregullat e saj që nëse nuk respektohen nga kompozitori apo interpretuesi atëherë nuk mund të kemi një muzikë të bukur.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - teksti i nxënësit/es, - CD me vijën melodike të këngës.
2.	<i>Gjuha dhe komunikimi muzikor</i>	Koha 2/4.	<p>Situata e të nxënit: Marshi</p> <p>Nxënësit dëgjojnë melodi në kohën 2/4 të llojit marsh. Ata kuptojnë se melodia që dëgjojnë është me dy goditje ku goditja e parë ndjehet më e fortë.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - teksti i nxënësit, - shembuj ritmikë në kohën 2/4, - këngë marsh, - këngë për fëmijë.
3.	<i>Historia, shoqëria, muzika</i>	Format muzikore një-, dy-, trepjesëshe	<p>Situata e të nxënit: Format dhe dallimi mes tyre</p> <p>Nxënësit/et kuptojnë dallimet mes formave edhe përmes një objekti të caktuar ose dëgjojnë 3 këngë të ndryshme që kanë forma 1-, 2-, 3-pjesëshe.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - teksti i nxënësit/es, - detyrë e kryer nga nxënësit/et - materiale përgatitur nga mësuesi/ja, - CD me shembuj konkretë.





4.	<i>Teknika dhe procese</i>	Ushtrime teknike me fyell.	Situata e të nxënësit: Nxënësit/et ushtrohen hap pas hapi.	<ul style="list-style-type: none"> - teksti i nxënësit/es, - instrumenti i fyellit.
5.	<i>Teknika dhe procese</i>	Kënga: “Fyelli i bariut”.	Situata e të nxënësit: Trashëgimia jonë kulturore. <i>Quiz</i> me instrumentet popullore: emra instrumentesh dhe karakteristikat e tyre.	<ul style="list-style-type: none"> - teksti i nxënësit/es, - materiale nga interneti, - CD me vijën melodike të këngës.
6.	<i>Historia, shoqëria, muzika.</i>	Muzika monodike, polifonike, kanoni.	Situata e të nxënësit: Muzika jonë polifonike. Kënga “Beg’ e bardhë” ka disa karakteristika që renditen. Çfarë e bën të dallueshme këtë këngë?	<ul style="list-style-type: none"> - teksti i nxënësit/es, - materiale të përgatitura nga mësuesi/ja, - CD me shembuj konkretë.
7.	<i>Teknika dhe procese.</i>	Kënga: “Urim mësueses”	Situata e të nxënësit: Festimi i festave.	<ul style="list-style-type: none"> - teksti i nxënësit/es, - CD me vijën melodike të këngës.
8.	<i>Gjuha dhe komunikimi muzikor.</i>	Koha 3/4 dhe pika vlerëse.	Situata e të nxënësit: Valsi. Nxënësit/et dëgjojnë muzikë në kohën 3/4 dhe kuptojnë se ai ngjason me valsën. Gjatë këndimit evidentojnë theksin e fortë.	<ul style="list-style-type: none"> - teksti i nxënësit/es, - materiale të përgatitura nga mësuesi/ja, - CD me shembuj muzikorë.
9.	<i>Gjuha dhe komunikimi muzikor.</i>	Koha 4/4.	Situata e të nxënësit: Gjuha dhe muzika. Vazhdimi i situatës së temës 9, zgjerohet situata më tej, duke bërë lidhjen me temën e re.	<ul style="list-style-type: none"> - teksti i nxënësit/es, - materiale të përgatitura nga mësuesi/ja.

10.	<i>Teknika dhe procese.</i>	Kënga: “Neve jemi lulebore”.	Situata e të nxënësve: Kujdesi për lulet. Nxënësit flasin për lulet dhe kujdesin ndaj tyre. Pse duhet të kujdesemi për to dhe sa të dobishme janë ato në jetën tonë.	<ul style="list-style-type: none"> - teksti i nxënësit/es, - CD me vijën melodike të këngës.
11.	<i>Teknika dhe procese.</i>	Luajmë me fyell në kohët e thjeshta.	Folklori muzikor i popullit tim Vazhdohet zgjerimi i situatës: tema 8	<ul style="list-style-type: none"> - teksti i nxënësit/es, - libra të ndryshëm muzikorë, - materiale të përgatitura nga mësuesi/ja
12.	<i>Historia muzika dhe shoqëria.</i>	Përforsim.	Situata e të nxënësve: Ne dhe muzika.	<ul style="list-style-type: none"> - teksti i nxënësit/es, - libra të ndryshëm muzikorë, - materiale të përgatitura nga mësuesi/ja.
<p>Metodologjia <i>Metoda interaktive, bashkëvepruese, gjithëpërfshirëse.</i> <i>Puna në grup dhe puna individuale.</i> <i>Hetimi dhe zbulimi.</i> <i>Zbatime praktike brenda dhe jashtë klase.</i> <i>Metoda integruese.</i> <i>Bashkëbisedim.</i> <i>Teknika që zhvillojnë mendimin kritik dhe krijues.</i> <i>Prezantime në forma të ndryshme, përfshirë TIK.</i> <i>Projekte kurrikulare.</i></p>				
<p>Vlerësimi: <i>Vlerësimi përshkrues.</i> <i>Vlerësimi i tematikave përmbyllëse.</i> <i>Vlerësimi i dosjes.</i></p>				

■ PLANIFIKIMI DITOR PËR TREMUJORIN E DYTË JANAR - MARS BAZUAR NË SITUATË TË NXËNI

Planifikimi ditor

Data.....

Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: III	Klasa: 6-të
<p>Tematika: Teknika dhe procese Tema mësimore: Kënga “Prit sinjalin pastaj ik”</p>		<p>Situata e të nxënit: Respektimi i rregullave Nxënësit/et kuptojnë se të respektohen rregullat në çdo mjedis apo situatë është detyrim. Edhe muzika ka rregullat e saj që nëse nuk respektohen nga kompozitori apo interpretuesi atëherë nuk mund të kemi një muzikë të bukur.</p>	
<p> Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe</p> <p><i>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit:</i> (2) Shfrytëzon mjetet artistike, mundësitë e komunikimit dhe të të shprehurit në muzikë në mënyrë të pavarur. <i>Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin:</i> (1) Ndërmerr nisma për të zhvilluar aktivitete muzikore brenda dhe jashtë klasës, duke kontribuar në mënyrë krijuese. <i>Kompetenca personale:</i> (1) Zhvillon besimin tek vetja gjatë veprimtarive muzikore. <i>Kompetenca qytetare:</i> (1) Bashkëpunon me të tjerët për çështje të ndryshme kulturore.</p>			
<p> Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> - komunikon qartë njohuritë muzikore, duke i lidhur ato me emocionet e këngëve që këndon; - këndon duke respektuar teknikën e këndimit përmes rregullave të përcaktuara; - interpreton këngët me ndjenjë dhe emocion; - respekton interpretimin dhe performimin e shokëve; - ndan përvojën e vet artistike me të tjerët; - respekton këngë të kulturave të tjera. 		<p><input checked="" type="checkbox"/> Fjalë kyçe:</p> <ul style="list-style-type: none"> - melodi e këngës, - tekst i këngës, - rregull i këndimit, - rregull i qarkullimit. 	
<p> Burimet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - teksti i nxënësit/es, - materiale të ndryshme enciklopedike, - CD me vijën melodike të këngës. 		<p>Lidhja me fushat e tjera:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Shkencat shoqërore dhe mjedisi: Qytetaria. <p>Lidhja me temat ndërkurrikulare</p> <ul style="list-style-type: none"> - Bashkëjetesa paqësore. 	
<p> Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve</p> <p>Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve Mësues/ja shkruan fjalën rregulla në dërrasë dhe nxit nxënësit/et të thonë çfarë kuptojnë me të. Respektimi i rregullave dhe normave është detyrim për të gjithë, sepse në situata të caktuara ato mund të kthehen edhe rrezik për njeriun, si p.sh: mosrespektimi i sinjalit të semaforit në qarkullim. Nxënësit/et zhvillojnë konceptin e respektimit të rregullave edhe gjatë shkrimit të një eseje, punës në grup etj. Edhe kompozitorët apo shkrimtarët ndjekin rregulla të caktuara kur krijojnë. Edhe vetë nxënësit/et deri tani kanë ndjekur disa rregulla të përpikta për të zhvilluar krijimet e tyre muzikore.</p>			

Modele udhëzuese për zhvillimin e mësimit

► **Paraqitet** fotoja dhe shkruhet fjala *rregulla* në dërrasë duke nxitur nxënësit/et të thonë se çfarë ata kuptojnë me këtë fjalë.

► **Pyetet sërish** se ku i ndjekim rregullat përveçse kur kalojmë rrugën.

Respektimi i rregullave dhe i normave është detyrim për të gjithë, sepse në situata të caktuara moszbatimi i tyre mund të kthehet në rrezik për njeriun, si p.sh: mosrespektimi i sinjalit të semaforit në qarkullim. Nxënësit/et zhvillojnë konceptin e respektimit të rregullave edhe gjatë shkrimit të një eseje, punës në grup etj. Edhe kompozitorët apo shkrimtarët ndjekin rregulla të caktuara kur krijojnë. Por edhe vetë nxënësit/et deri tani kanë ndjekur disa rregulla të përpikta për të zhvilluar krijimet e tyre muzikore.





► **Vendoset** për dëgjim kënga “Prit sinjalin pastaj ik” dhe **vazhdohet** puna me mësimin e saj, sipas metodës:


- ☞ këndimi varg pas vargu;
- ☞ përsëritja e vargjeve herë pas here;
- ☞ këndimi i strofës;
- ☞ këndimi i strofës dhe i refrenit;
- ☞ përsëritja e këngës nga fillimi në fund;
- ☞ interpretimi i këngës me ndjenjë dhe emocion;
- ☞ këndimi i këngës vetëm dhe në grup.

► **Gjatë mësimit të këngës**, tregohet kujdes për respektimin e *ritmit*, të *intonacionit*, të *interpretimit* të këngës.

Ndahen nxënësit në grupe dhe shoqërojnë këngën me instrumente Orf.


2
1 2 | 1 2 | 1 2 | 1 2 | 1 2 | etj.


2
x | x | x | x | x | x | x | x | etj.






2
x | x | x | x | x | x | x | x | etj.

Detyrë plotësuese për dosjen e nxënësit:

- Çfarë duhet të kemi parasysh në respektimin e rregullave të qarkullimit dhe të sigurisë në rrugë. *Prezantim në Power Point, diskutime.*

Planifikimi ditor

Data.....

Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: III	Klasa: 6-të
Tematika: Gjuha dhe komunikimi muzikor Tema mësimore: “ Koha dhe pushimi 2/4”.		Situata e të nxënit: Marshi Nxënësit dëgjojnë melodi në kohën 2/4 të llojit marsh. Ata kuptojnë se melodia që dëgjojnë është me dy goditje, ku goditja e parë ndjehet më e fortë.	
 Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe <i>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit: (2) Kupton drejt mesazhin artistik.</i> <i>Kompetenca e të menduarit: (1) Kërkon dhe gjen njohuritë muzikore në mënyrë të pavarur.</i> <i>Kompetenca për të nxënë: (2) Krijon në mënyrë të pavarur detyrën e dhënë.</i> <i>Kompetenca personale: (1) Zhvillon besimin te vetja gjatë veprimtarive muzikore.</i>			
 Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore: <ul style="list-style-type: none"> - krijojnë në kohët 2/4; - krijojnë duke përdorur kombinime të ndryshme vlerash notash dhe pushimesh; - shpjegojnë ndryshueshmërinë e muzikës gjatë përdorimit të vlerave të ndryshme të notave dhe pushimeve. 		<input checked="" type="checkbox"/> Fjalë kyçe: <ul style="list-style-type: none"> - koha 2/4, - pushimi i kohës 3/4, - theksi i fortë, i butë, - krijim në kohën 2/4. 	
 Burimet: <ul style="list-style-type: none"> - teksti i nxënësit/es, - libra të ndryshëm muzikorë, - materiale të përgatitura nga mësuesi/ja, - CD me shembuj muzikorë. 		Lidhja me fushat e tjera: <ul style="list-style-type: none"> - Matematika. 	
 Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve Mësimi fillon me një veprimtari konkrete ku nxënësit/et këndojnë këngë në kohën 2/4 dhe kuptojnë se koha ngjason me marshet ushtarake. Gjatë këndimit evidentojnë theksin e fortë.			
Ndërtimi i njohurive të reja Mësues/ja vazhdon më tej veprimtarinë, duke u rikujtuar nxënësve/eve mësimin ku ata përcaktuan gjatësinë e tingujve të gjatë dhe të shkurtër, duke e konkretizuar me shembuj muzikorë të vendosur në magnetofon. Shpjegohet koha 2/4 dhe theksi i fortë e i butë, ku bie, nëpërmjet rrokjeve të fjalëve në fillim dhe më pas vijohet edhe me shembuj të tjerë ritmikë. Nxënësit/et fillojnë të krijojnë vetë ritme 2/4 për ta kuptuar më mirë këtë ritëm. Pastaj ata fillojnë të krijojnë në fletoret e tyre ushtrime në kohën 2/4, me kombinime të ndryshme notash dhe pushimesh. Prezantojnë krijimet e tyre, duke i shpjeguar ato.			
Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura Nxënësit: <ul style="list-style-type: none"> - demonstrojnë se kanë kuptuar kohën 2/4. - lexojnë saktë notat në vija dhe në fusha që janë të vendosura në pentagram në kohën 2/4. - krijojnë në kohën 2/4 me kombinime të ndryshme notash dhe pushimesh. Detyrat e krijuara të nxënësve/eve ruhen në dosjen e tyre.			

Modele udhëzuese për zhvillimin e mësimit

- **Vendosen** për dëgjim disa fragmente muzikore në kohën 2/4 ose këndohen këngë në kohën 2/4 ku evidentohet karakteri i këngës dhe theksi i fortë që bie në lëvizjen e parë.

► **Të plotësojnë vendet boshe në fjalitë e mëposhtme.**

- Koha ose rrahja 2/4 ka _____ dhe zgjat _____ kohë. Koha e parë ose lëvizja e parë rrihet _____ koha e dytë ose lëvizja e dytë rrihet _____.
- Thekset në kohën 2/4 janë: e _____ në lëvizjen e parë, dhe e _____ në lëvizjen e dytë.

► **Shpjegohet:**


- ☞ gjatësia e tingujve *të gjatë dhe të shkurtër* që rikujtohen e konkretizohen me shembuj muzikorë të vendosur në magnetofon;
- ☞ koha 2/4;
- ☞ theksi i fortë dhe i butë dhe ku bien nëpërmjet rrokjeve të fjalëve në fillim;
- ☞ theksi i fortë dhe i butë në ritëm dhe muzikë;
- ☞ pushimi në kohën 2/4.

► **Ushtrime dhe lojëra argëtuese 1, 2, 3, 4, 5**

- Nxënësi/ja të vendosë vijën e masës atje ku duhet. Nga ndarja që do të bëjë do të krijohen 16 masa.



- Lexohen ushtrimet në libër në kohën 2/4 për të kuptuar më mirë këtë ritëm.
- Nxënësit krijojnë në fletoret e tyre ushtrime në kohën 2/4, me kombinime të ndryshme vlerash notash dhe pushimesh.
- Paraqesin krijimet e tyre, duke i shpjeguar ato.
- Nxënësit/ja vendos notën aty ku ka emërtim dhe pushimin aty ku ka numra.






Detyrë plotësuese për dosjen e nxënësit/es:

- Krijime në kohën 2/4.

Planifikimi ditor

Data.....

Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: III	Klasa: 6-të
<p>Tematika: Historia, muzika dhe shoqëria.</p> <p>Tema mësimore: “Format muzikore 1-, 2-, 3-pjesëshe”.</p>		<p>Situata e të nxënësve 1: Format dhe dallimi mes tyre</p> <p>Nxënësit/et flasin për format që shikojnë në mjedis, në pikturë, dhe më pas diskutojnë për format në muzikë.</p> <p>Nxënësit/et kuptojnë dallimet mes formave edhe përmes një objekti të caktuar ose dëgjojnë 3 këngë të ndryshme që kanë forma 1-, 2-, 3-pjesëshe.</p>	
<p> Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe</p> <p><i>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit:</i> (3,4) Demonstron një komunikim të qartë me anë të gjuhës muzikore, të simboleve, të shenjave dhe të formave muzikore.</p> <p>Shfrytëzon mjetet artistike mundësitë e komunikimit dhe të të shprehurit në muzikë në mënyrë të pavarur.</p> <p><i>Kompetenca e të menduarit:</i> (1) Kërkon dhe gjen njohuritë muzikore në mënyrë të pavarur.</p> <p><i>Kompetenca për të nxënë:</i> (2) Përdor burime të ndryshme informacioni për të realizuar një krijim muzikor.</p> <p><i>Kompetenca qytetare:</i> (1) Bashkëpunon me të tjerët për çështje të ndryshme kulturore.</p> <p><i>Kompetenca digjitale:</i> (1, 2) Krijon informacion si dhe bashkëpunon në rrjetet informuese në internet.</p> <p>Njeh/përdor mjetet të ndryshme në funksion të informacionit muzikor si: magnetofon, audio, video CD, DVD etj.</p>			
<p> Rezultatet e të nxënësve të lëndës sipas temës mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> - bën lidhje ndërmjet asaj që di mbi format muzikore, instrumentet apo vokalin dhe asaj që dëgjon në një vepër muzikore; - bën gjykime kritike ndaj një muzike të caktuar, duke u mbështetur në gjuhën muzikore, në <i>ndryshueshmërinë e ritmeve muzikore, në shpejtësinë muzikore, në formën muzikore, në karakterin e pjesëve muzikore;</i> - komunikon mendimin e vet rreth veprave muzikore të dëgjuara; - përdor një fjalor të thjeshtë muzikor; - përdor media (DVD, CD, magnetofon) për të reklamuar/prezantuar punën e vet. 		<p><input checked="" type="checkbox"/> Fjalë kyçe:</p> <ul style="list-style-type: none"> - format muzikore 1-, 2-, 3-pjesëshe 	
<p> Burimet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - teksti i nxënësit/es, - materiale të përgatitura nga mësuesi/ja, - CD, fragmente të ndryshme muzikore. 		<p>Lidhja me fushat e tjera:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Shkencat shoqërore dhe mjedisi: Historia. 	



Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve

Nxënësit/et flasin për format që shikojnë në mjedis, në pikturë, dhe më pas diskutojnë për format në muzikë.

Nxënësit/et kuptojnë dallimet mes formave nëpërmjet një objekti të caktuar, ose dëgjojnë tri këngë të ndryshme që kanë forma 1-, 2-, 3-pjesëshe.

Ndërtimi i njohurive të reja

- Veprimtaria vazhdon duke vendosur tre shembuj muzikorë përmes të cilëve ata/ato kuptojnë ndryshueshmërinë e asaj që quhet formë 1-, 2-, 3-pjesëshe.
- Mësuesi/ja u kërkon nxënësve/eve që të gjejnë çfarë u bën përshtypje atyre, duke ua drejtuar vëmendjen te ndërtimi muzikor që ka një pjesë muzikore.
- Më pas ai/ajo u shpjegon format 1-, 2-, 3-pjesëshe muzikore dhe si ndërtohen ato. Mësuesi/ja vendos përsëri të dëgjohen edhe të tre shembujt muzikorë, që nxënësit/et të kuptojnë sa më mirë atë çka u shpjegua.
- Pjesët muzikore shoqërohen edhe me shpjegime biografike dhe historike të kohës dhe të autorëve.
- Nxënësit/et gjejnë të dhëna në internet rreth jetës së L.V. Bethovenit.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Nxënësit/et:

- identifikojnë format muzikore 1-, 2-, 3-pjesëshe gjatë dëgjimit muzikor.
- ekzekutojnë këngën “Për mëmëdhenë” (formë 1-pjesëshe).

Vlerësimi

Vlerësimi i nxënësit/es do të kryhet për:

- diskutimet që ai/ajo bën duke lidhur njohuritë e tij/saj me temën e re;
- për pjesëmarrjen aktive gjatë krijimit muzikor dhe në çështje të tjera që lidhen me temën e re.

Shënime specifike:



Modele udhëzuese për zhvillimin e mësimin

► Rikujtohet muzika dhe gjuha, të përbashkëtat e tyre:

Fjala, fjalia dhe përmbajtja në gjuhë dhe motivi, fraza, fjalia, periudha në muzikë. Por ata duhet të kuptojnë dallimet mes formave.

☹ Vendosen për dëgjim tri këngë të ndryshme dhe diskutohet çfarë dallohet përmes dëgjimit. (Ato kanë forma 1-, 2-, 3-pjesëshe).

► Shpjegohet:

- ☞ ndryshueshmërinë e asaj që quhet formë 1-, 2-, 3-pjesëshe,
- ☞ ndërtimi muzikor që ka një pjesë muzikore,
- ☞ format 1,2,3 pjesëshe muzikore dhe se si ndërtohen ato.

☹ Vendosen edhe njëherë për dëgjim 3 këngë të ndryshme dhe diskutojnë, kuptojnë dhe identifikojnë format muzikore 1-, 2-, 3-pjesëshe gjatë dëgjimit muzikor.

► Ushtrime dhe lojëra argëtuese 1, 2, 3

1. Rretho përgjgjen e saktë.

► *Forma njëpjesëshe është një periudhë muzikore që:*

- *përsëritet një herë,*
- *nuk përsëritet,*
- *përsëritet shumë herë,*
- *përsëritet sa herë të duash.*

2. Rretho përgjgjen e saktë.

A	←————→	forma _____
A - B	←————→	forma _____
A - B - A	←————→	forma _____

3. Gjej tri këngë me format muzikore:

A - A - A _____

A - B _____





A - B - A _____

Detyrë plotësuese për dosjen e nxënësit:

- Bëhet një historik rreth jetës dhe veprimtarisë përmes shpjegimeve biografike dhe historike të kohës kur jetoi dhe punoi Bethoveni.
- CD me pjesë të ndryshme muzikore që kanë formë 1-, 2-, 3-pjesëshe.

Planifikimi ditor


Data.....

Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: III	Klasa: 6-të
Tematika: Teknika dhe procese. Tema mësimore: “Ushtrime teknike me fyell”.		Vazhdohet zgjerimi i situatës duke punuar ushtrime në kohën 2/4.	
 Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe			
<p><i>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit:</i> (1) Krijon personalitetin e vet në veprimtaritë artistike.</p> <p><i>Kompetenca e të menduarit:</i> (3,4) Zhvillon aftësitë për të menduar në mënyrë krijuese dhe ndërvepruese.</p> <p>Ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim muzikor.</p> <p><i>Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin:</i> (1) Krijon në mënyrë të pavarur detyrën e dhënë.</p> <p><i>Kompetenca për të nxënë:</i> (3) Interpreton vetëm dhe në grup.</p> <p><i>Kompetenca qytetare:</i> (1) Bashkëpunon me të tjerët për çështje të ndryshme kulturore.</p>			
 Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore: <ul style="list-style-type: none"> - luan apo këndon duke respektuar simbolikat e mësuara; - luan në instrument duke respektuar rregullat e këtij instrumenti; - respekton interpretimin dhe performimin e shokëve/shoqeve; - ndan përvojën e vet artistike me të tjerët. 		<input checked="" type="checkbox"/> Fjalë kyçe: <ul style="list-style-type: none"> - fyell, - rregullat e luajtjes në instrument. 	
 Burimet: <ul style="list-style-type: none"> - teksti i nxënësit/es, - instrumenti i fyellit (bllokflaut), - CD. 		Lidhja me temat ndërkurrikulare <ul style="list-style-type: none"> - Trashëgimia jonë kulturore. 	
 Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve Mësues/ja rikujton rregullat e luajtjes në instrumentin e fyellit.			
Ndërtimi i njohurive të reja Nxënësit/et luajnë në kohën 2/4 me fyell. Ata ekzekutojnë vetëm ose të gjithë së bashku ushtrime të thjeshta.			
Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura Nxënësit: <ul style="list-style-type: none"> - diskutojnë me njëri-tjetrin rreth instrumenteve popullore. - ekzekutojnë në fyell, ushtrime në kohën 2/4. - respektojnë rregullat e luajtjes në fyell. 			

Modele udhëzuese për zhvillimin e mësimin

► Rikujtohen:

- ⊗ rregullat e mbajtjes dhe të luajtjes me të;
- ⊗ ekzekutimi në kohën 2/4;
- ⊗ respektimi i vlerave të notës dhe i pushimeve 1/4, 1/8, 2/4;
- ⊗ ekzekutimi saktë i repertorit.



Këndo dhe luaj në fyell

1 *Moderato*





2

Detyrë plotësuese në shtëpi:

- Përsëritje e ekzekutimit të notave të gjata në instrument.

Planifikimi ditor

Data.....

Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: III	Klasa: 6-të
Tematika: Teknika dhe procese. Tema mësimore: Kënga “Fyelli i bariut”.		Situata e të nxënësve: Trashëgimia jonë kulturore <i>Quiz</i> me instrumentet popullore: emra instrumentesh dhe karakteristikat e tyre.	
 Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe			
<p><i>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit:</i> (2) Shfrytëzon mjetet artistike mundësitë e komunikimit dhe të të shprehurit në muzikë në mënyrë të pavarur.</p> <p><i>Kompetenca e të menduarit:</i> (2) Zgjidh probleme të ndryshme muzikore/artistike</p> <p><i>Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin:</i> (1) Ndërmerr nisma për të zhvilluar aktivitete muzikore brenda dhe jashtë klasës duke kontribuar në mënyrë krijuese.</p> <p><i>Kompetenca personale:</i> (1) Zhvillon besimin tek vetja gjatë veprimtarive muzikore.</p> <p><i>Kompetenca qytetare:</i> (1) Bashkëpunon me të tjerët për çështje të ndryshme kulturore.</p>			
 Rezultatet e të nxënësve të lëndës sipas temës mësimore: <ul style="list-style-type: none"> - komunikon qartë njohuritë muzikore, duke i lidhur ato me emocionet e këngëve që këndon; - këndon duke respektuar teknikën e këndimit përmes rregullave të përcaktuara; - interpreton këngën me ndjenjë dhe emocion; - respekton interpretimin dhe performimin e shokëve/shoqeve; - ndan përvojën e vet artistike me të tjerët; - respekton këngë të kulturave të tjera. 		<input checked="" type="checkbox"/> Fjalë kyçe: <ul style="list-style-type: none"> - melodi e këngës, - tekst i këngës, - rregull i këndimit. 	
 Burimet: <ul style="list-style-type: none"> - teksti i nxënësit/es, - materiale nga interneti, - CD me vijën melodike të këngës. 		Lidhja me fushat e tjera: <ul style="list-style-type: none"> - Shkencat shoqërore dhe mjedisi: Historia. - Gjuhët dhe komunikimi: Letërsia. Lidhja me temat ndërkurrikulare <ul style="list-style-type: none"> - Trashëgimia jonë kulturore. 	
 Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve Njëpërmjet pamjeve në kompjuter apo njëpërmjet dëgjimit në magnetofon mësuesi/ja rikujton instrumente të ndryshme popullore, ndërsa nxënësit/et sjellin foto të instrumenteve që ata kanë parë, kanë në familje, kanë luajtur ata vetë apo prindërit.			

Ndërtimi i njohurive të reja

Nxënësit/et kuptojnë rëndësinë e instrumenteve popullore, por edhe të vetë instrumentit që ata po mësojnë në shkollë, të fyellit. Ky instrument popullor shoqëron këngët dhe vallet tona popullore dhe përfaqëson trashëgiminë kulturore muzikore dhe është pjesë e përfaqësimit të identitetit tonë kombëtar. Më pas nxënësit/et mësojnë këngën në grup, duke respektuar karakteristikat e këngës, e cila ka motive popullore. Nxënësit/et lidhin njohuritë që kanë për tingullin e gjatë dhe të shkurtër, duke i gjetur te rrokjet e fjalëve dhe te gjatësia e tingujve që mësojnë gjatë këngës.

Kënga këndohet disa herë në intonacion dhe në ritëm, duke respektuar rregullat e këndimit, dhe duke kënduar në grup.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Nxënësit/et:

- diskutojnë me njëri-tjetrin rreth instrumenteve popullore dhe veçanërisht rreth fyellit.
- demonstrojnë se kanë mësuar këngën dhe tekstin e saj.
- këndojnë duke interpretuar këngën me ndjenjë dhe emocion, sipas rregullave të këndimit në ritëm dhe intonacion.
- zhvillojnë detyrën me një tematikë të caktuar dhe e prezantojnë atë.

Punimet (ese, filmime, histori rreth temës) të nxënësve/eve, ruhen në dosjen e tyre.

Vlerësimi

Vlerësimi i nxënësit/es do të kryhet për:

- diskutimet që ai/ajo bën, duke lidhur njohuritë e tij/saj me temën e re;
- këndimin korrekt të këngës në ritëm dhe në intonacion, duke respektuar rregullat e këndimit;
- performimin/interpretimin e këngës me emocion;
- bashkëpunimin dhe për këndimin në grup;
- për realizimin e detyrës (këngës).

Shënime specifike:



Modele udhëzuese për zhvillimin e mësimimit

► **Diskutohet** me nxënësit/et për rëndësinë e instrumenteve popullore, por edhe të vetë instrumentit që ata po mësojnë në shkollë, fyellin. Edhe ky instrument popullor shoqëron këngët dhe vallet tona popullore dhe përfaqëson trashëgiminë kulturore muzikore, dhe është pjesë e përfaqësimit të identitetit tone kombëtar.




► **Vendoset** për dëgjim kënga “Fyelli i bariut” dhe **vazhdohet** puna me mësimin e saj, sipas metodës:

- ☞ këndimi varg pas vargu;
- ☞ përsëritja e vargjeve herë pas here;
- ☞ këndimi i strofës;
- ☞ këndimi i strofës dhe i refrenit;
- ☞ përsëritja e këngës nga fillimi në fund;
- ☞ interpretimi i këngës me ndjenjë dhe emocion;
- ☞ këndimi i këngës vetëm dhe në grup;
- ☞ shoqërohet kënga me instrumente me goditje.



► **Gjatë mësimimit të këngës**, tregohet kujdes për respektimin e *ritmit*, të *intonacionit*, të *interpretimit* të këngës.

Ndahen nxënësit/et në grupe dhe shoqërojnë këngën me instrumente Orf.




	2	X	1	2	X	1	2	X	1	2	X	1	2	X	1	2	etj.
	2	X	1	2	X	1	2	X	1	2	X	1	2	X	1	2	etj.
	2	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	etj.

Detyrë plotësuese për dosjen e nxënësit/es:

- Zhvillojnë detyrën me tematikë: “Instrumentet tona popullore”.
- Duke parë figurën mund të krijohet një ese: “Melodia popullore e krahinës sime”.

Planifikimi ditor

Data.....

Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: III	Klasa: 6-të
<p>Tematika: Historia, muzika dhe shoqëria.</p> <p>Tema mësimore: “Muzika monodike, polifonike, kanoni”.</p>		<p>Situata e të nxënësve: Muzika jonë polifonike</p> <p>Iso – polifonia, një pasuri e paçmuar që përfaqëson vendin tonë dhe ruhet nga Unesko. Ajo është shpallur “Kryevepër e trashëgimisë gojore të njerëzimit”.</p>	
<p> Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe</p> <p><i>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit:</i> (3,4) Demonstron një komunikim të qartë me anë të gjuhës muzikore, simboleve, shenjave dhe formave muzikore. Shfrytëzon mjetet artistike mundësitë e komunikimit dhe të të shprehurit në muzikë në mënyrë të pavarur.</p> <p><i>Kompetenca e të menduarit:</i> (1) Kërkon dhe gjen njohuritë muzikore në mënyrë të pavarur.</p> <p><i>Kompetenca për të nxënë:</i> (2) Përdor burime të ndryshme informacioni për të realizuar një krijim muzikor.</p> <p><i>Kompetenca qytetare:</i> (1) Bashkëpunon me të tjerët për çështje të ndryshme kulturore.</p> <p><i>Kompetenca digjitale:</i> (1, 2) Krijon informacion dhe bashkëpunon në rrjetet informuese në internet. Njeh/përdor mjetet të ndryshme në funksion të informacionit muzikor si: magnetofon, audio, video CD, DVD etj.</p>			
<p> Rezultatet e të nxënësve të lëndës sipas temës mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> - bën lidhje ndërmjet asaj që di mbi format muzikore, instrumentet apo vokalin dhe asaj që dëgjon në një vepër muzikore; - bën gjykime kritike ndaj një muzike të caktuar, duke u mbështetur në <i>gjuhën muzikore, në ndryshueshmërinë e ritmeve muzikore, në shpejtësinë muzikore, në formën muzikore, në karakterin e pjesëve muzikore;</i> - komunikon mendimin e vet rreth veprave muzikore të dëgjuara; - përdor një fjalor të thjeshtë muzikor; - përdor media (DVD, CD, magnetofon) për të reklamuar/prezantuar punën e vet. 		<p><input checked="" type="checkbox"/> Fjalë kyçe:</p> <ul style="list-style-type: none"> - muzika monodike, - muzika polifonike, - kanoni. 	
<p> Burimet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - teksti i nxënësve, - materiale të përgatitura nga mësuesi/ja, - CD me shembuj konkretë (kanoni me tre zëra i Luixhi Kerubinit dhe kanone të tjera). 		<p>Lidhja me fushat e tjera:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Shkencat shoqërore dhe mjedisit: Historia. 	



Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve

Vendosen në magnetofon dy këngë të kënduara me një zë dhe shumë zëra. Nxënësit/et i dallojnë këto dy mënyra të kënduari dhe flasin për to. Kënga “Beg’ e bardhë” ka disa karakteristika që renditen. Çfarë e bën të dallueshme këtë këngë?

Iso – polifonia, një pasuri e paçmuar që përfaqëson vendin tonë, që ruhet nga Unesco dhe që është shpallur “Kryevepër e trashëgimisë gojore të njerëzimit”.

Ndërtimi i njohurive të reja

Veprimtaria vazhdon duke vendosur në magnetofon një kanon muzikor përmes të cilit nxënësit/et do të mësojnë të këndojnë kanonin e dhënë sipas rregullave që ai ka. Mësues/ja u kërkon nxënësve/eve që të gjejnë çfarë atyre u bën përshtypje, duke ua drejtuar vëmendjen te përsëritja që zhvillojnë grupet kur këndojnë kanonin.

Më pas u shpjegon kanonin dhe se si ndërtohet ai. Mësues/ja vendos përsëri të dëgjojnë kanonin e Kerubinit dhe kanone të tjera që nxënësit/et të kuptojnë sa më mirë atë çka u shpjegua.

Pjesët muzikore shoqërohen edhe me shpjegime biografike dhe historike të kohës dhe të autorëve. Nxënësit/et gjejnë të dhëna të tjera në internet rreth jetës së Luixhi Kerubinit.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Nxënësit/et:

- demonstrojnë se ka kuptuar çfarë është kanoni;
- ekzekutojnë kanonin;
- prezantojnë të dhëna rreth kompozitorit Luixhi Kerubini apo rreth kompozitorëve të tjerë që kanë krijuar kanone.
- zhvillojnë detyrën me një tematikë të caktuar dhe e prezantojnë atë.

Detyrat e krijuara të nxënësve/eve ruhen në dosjen e tyre.

Vlerësimi

Vlerësimi i nxënësit/es do të kryhet për:

- diskutimet që ai/ajo bën, duke lidhur njohuritë e tij/saj me temën e re;
- pjesëmarrjen aktive gjatë krijimit muzikor dhe në çështje të tjera që lidhen me temën e re.

Shënime specifike:



Modele udhëzuese për zhvillimin e mësimit

- ▶ **Vendosen për dëgjim** dy këngë popullore, të cilat këndohen *me një zë dhe shumë zëra*. Nxënësit/et do të dallojnë dy mënyra të kënduari.
- ▶ **Diskutohet** mbi temën “Muzika jonë polifonike dhe Iso-polifonia”, një pasuri e paçmuar që përfaqëson vendin tonë, që ruhet nga Unesco dhe që është shpallur “Kryevepër e trashëgimisë gojore të njerëzimit”.
- ▶ **Vendoset** për dëgjim kanoni “Vëlla arbër” (mund të merret çfarëdo kanoni) dhe diskutohet rreth asaj që nxënësit/et dëgjojnë. Atyre gjatë bisedës u drejtohet vëmendja te elementi përsëritës që zhvillojnë grupet kur këndojnë kanonin.
- ▶ **Shpjegohet:**
 - ☞ ndryshueshmëria e asaj që quhet formë *monodike* dhe *polifonike*;
 - ☞ struktura apo ndërtimi i tyre muzikor;
 - ☞ forma e kanonit, përsëritja dhe mënyra si këndohet.

▶ Ushtrime dhe lojëra argëtuese 1, 2

1. Plotëso përkufizimet.

- Këndimi ose luajtja me instrument e një melodie të vetme quhet _____
- Këndimi ose luajtja me instrumente e dy ose më shumë melodive quhet _____
- Ekzekutimi i një melodie kur zëri i dytë përsërit zërin e parë pas një, dy ose më shumë masave muzikore quhet _____

2. Shkruaj karakteristikat e pjesëve që dëgjon.





- a. “Samsoni e Delila” Sent Sans (“Sanson et Delila” Saint Saens)
- b. “Frer Zhak” (“Frer Jacques”) kanon nga L. V. Bethoven.

Detyrë plotësuese për dosjen e nxënësit/es:

- Gjen dhe prezanton historik rreth jetës dhe veprimtarisë përmes shpjegimeve biografike dhe historike të kohës kur jetuan këta kompozitorë. Prezantim në *Power Point* për Luixhi Kerubinin.
- CD me pjesë të ndryshme muzikore që kanë formë 1-, 2-, 3-pjesëshe.

Planifikimi ditor

Data.....

Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: III	Klasa: 6-të
Tematika: Teknika dhe procese.		Situata e të nxënit: Festimi i festave.	
Tema mësimore: Kënga “Urim mësueses”.		Festat dhe rëndësia e tyre në jetën tonë.	
 Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe			
<p><i>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit: (2) Shfrytëzon mjetet artistike, mundësitë e komunikimit dhe të të shprehurit në muzikë në mënyrë të pavarur.</i></p> <p><i>Kompetenca e të menduarit: (2) Zgjidh probleme të ndryshme muzikore/artistike.</i></p> <p><i>Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin: (1) Ndërmerr nisma për të zhvilluar aktivitete muzikore brenda dhe jashtë klasës duke kontribuar në mënyrë krijuese.</i></p> <p><i>Kompetenca personale: (1) Zhvillon besimin te vetja gjatë veprimtarive muzikore.</i></p> <p><i>Kompetenca qytetare: (1) Bashkëpunon me të tjerët për çështje të ndryshme kulturore.</i></p>			
 Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore: <ul style="list-style-type: none"> - këndon duke respektuar teknikën e këndimit përmes rregullave të përcaktuara; - interpreton këngën me ndjenjë dhe emocion; - respekton interpretimin dhe performimin e shokëve/shoqeve; - ndan përvojën e vet artistike me të tjerët; - respekton këngë të kulturave të tjera. 		<input checked="" type="checkbox"/> Fjalë kyçe: <ul style="list-style-type: none"> - melodi e këngës, - tekst i këngës, - rregulla të këndimit. 	
 Burimet: <ul style="list-style-type: none"> - teksti i nxënësit/es, - CD me vijën melodike të këngës. 		Lidhja me fushat e tjera: <ul style="list-style-type: none"> - Shkencat shoqërore dhe mjedisi: Njohuri për shoqërinë. - Gjuhët dhe komunikimi: Letërsia. Lidhja me temat ndërkurrikulare <ul style="list-style-type: none"> - Bashkëjetesa në paqe. 	
 Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve Mësues/ja u kërkon nxënësve/eve të krijojnë një repertor me këngë të ndryshme për festimin e festës së 7-8 marsit. Ata/ato përcaktojnë këngët më të bukura për këtë ditë, festë, e cila zhvillohet në çdo shkollë.			
Ndërtimi i njohurive të reja Për t'i shtuar repertorit të tyre edhe një këngë tjetër, ata mësojnë këngën e re, në grup, duke respektuar karakteristikat e këngës e cila është thjeshtë dhe e bukur. Kënga këndohet disa herë në intonacion dhe në ritëm, duke respektuar rregullat e këndimit, dhe duke kënduar në grup.			

Modele udhëzuese për zhvillimin e mësimit

- ▶ **Paraqitet** fotoja dhe u kërkohet nxënësve/eve të thonë se cilën festë u kujton ajo.
- ▶ **Vendosen** për dëgjim disa fragmente të shkurtra nga këngë të ndryshme për festën e mësuesit/es dhe të nënës.
- ▶ **Nxiten** nxënësit/et të flasin rreth repertorit që ata do të vendosnin në festën e 7-8 Marsit.
- ▶ **Vendoset** për dëgjim kënga “Urim mësueses” dhe **vazhdohet** puna me mësimin e saj sipas metodës:

- ☞ këndimi varg pas vargu;
- ☞ përsëritja e vargjeve herë pas here;
- ☞ këndimi i strofës;
- ☞ këndimi i strofës dhe refrenit;
- ☞ përsëritja e këngës nga fillimi në fund;
- ☞ interpretimi i këngës me ndjenjë dhe emocion;
- ☞ këndimi i këngës vetëm dhe në grup.

- ▶ **Gjatë mësimit të këngës** tregohet kujdes për respektimin e *ritmit*, të *intonacionit*, të *interpretimit* të këngës.

Ndahen nxënësit/et në grupe dhe shoqërojnë këngën me instrumente Orf.

3 etj.

3 etj.





3 etj.

Detyrë plotësuese për dosjen e nxënësit/es:

Krijimi i një poezie për *mësuesin/en* dhe *nënë*n. Prezantimi i saj në klasë.
CD me kolazh këngësh kushtuar nënës dhe mësuesit/es.

Planifikimi ditor

Data.....

Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: III	Klasa: 6-të
Tematika: Gjuha dhe komunikimi muzikor. Tema mësimore: Koha 3/4 dhe pika e vlerës.		Situata e të nxënimit: Valsi. Nxënësit/et dëgjojnë muzikë në kohën 3/4 dhe kuptojnë se ajo ngjason me valsën. Gjatë këndimit evidentojnë theksin e fortë.	
 Rezultatet e të nxënimit sipas kompetencave kyçe <i>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit: (2) Kupton drejt mesazhin artistik.</i> <i>Kompetenca e të menduarit: (1) Kërkon dhe gjen njohuritë muzikore në mënyrë të pavarur.</i> <i>Kompetenca për të nxënë: (2) Krijon në mënyrë të pavarur detyrën e dhënë.</i> <i>Kompetenca personale: (1) Zhvillon besimin tek vetja gjatë veprimtarive muzikore.</i>			
 Rezultatet e të nxënimit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore: <ul style="list-style-type: none"> - krijon në kohët 3/4; - krijon duke përdorur kombinime të ndryshme vlerash notash dhe pushimesh; - shpjegon ndryshueshmërinë e muzikës gjatë përdorimit të vlerave të ndryshme të notave dhe të pushimeve. 		<input checked="" type="checkbox"/> Fjalë kyçe: <ul style="list-style-type: none"> - koha 3/4, - theksi i fortë, i butë, - pushimi i kohës 3/4, - pika e vlerës, - krijim në kohën 3/4. 	
 Burimet: <ul style="list-style-type: none"> - teksti i nxënësit/es, - libra të ndryshëm muzikorë, - materiale të përgatitura nga mësuesi/ja, - CD me shembuj muzikorë. 		Lidhja me fushat e tjera: <ul style="list-style-type: none"> - Matematika. 	
 Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve Mësimi fillon me një veprimtari konkrete ku nxënësit/et dëgjojnë muzikë në kohën 3/4 dhe kuptojnë se ajo ngjason me valsën. Gjatë dëgjimit evidentojnë tri thekset: theksin e fortë, të butë, të butë.			
Ndërtimi i njohurive të reja <ul style="list-style-type: none"> • Mësuesi/ja vazhdon më tej veprimtarinë, duke u rikujtuar nxënësve/eve vlerën e notave muzikore. <ul style="list-style-type: none"> • Shpjegohet koha 3/4, ku bie theksi i fortë dhe i butë, i demonstruar edhe nëpërmjet rrokjeve të fjalëve në fillim, por edhe me shembuj të tjerë ritmikë. Nxënësit/et fillojnë vetë të krijojnë modele ritmike në kohën 3/4 për të kuptuar më mirë këtë ritëm. Ata/ato mësojnë që për të krijuar kohën 3/4 ndihmon edhe pika e vlerës. • Pastaj ata/ato fillojnë të krijojnë në fletoret e tyre ushtrime në kohën 3/4, me kombinime të ndryshme notash dhe pushimesh. • Prezantojnë krijimet e tyre, duke i shpjeguar ato. 			

Modele udhëzuese për zhvillimin e mësimit

► **Vendosen** për dëgjim disa fragmente muzikore të llojit *vals*, pra në kohën 3/4 ose këndohen këngë në kohën 3/4 dhe gjatë dëgjimit evidentohen tri thekset: theksi i fortë, i butë, i butë.

► Shpjegohet:

- ☞ koha 3/4;
- ☞ thekset muzikore, dhe rëndësia e theksimit të theksit të fortë, për të evidentuar karakterin *vals* ose të *vallëzuar*;
- ☞ ku bie theksi i fortë dhe i butë ku nëpërmjet rrokjeve të fjalëve në fillim;
- ☞ pika e vlerës dhe përdorimi i saj,
- ☞ pushimi në kohën 3/4,
- ☞ theksi i fortë dhe i butë në ritëm dhe muzikë,

► Vazhdohet me:

- ☞ me leximin dhe këndimin e ushtrimeve në libër në kohën 3/4 për të kuptuar më mirë këtë ritëm;
- ☞ me krijimin në fletore të ushtrimeve në kohën 3/4, me kombinime të ndryshme vlerash notash dhe pushimesh që formojnë këtë kohë.
- ☞ paraqitjen e krijimeve duke i shpjeguar ato.

► Ushtrime dhe lojëra argëtuese

► Plotëso fjalitë e mëposhtme:





- a. Koha ose rrahja 3/4 ka tri _____ që rrihen _____, djathtas dhe _____
- b. Koha ose rrahja 3/4 ka _____ theksa, i pari është i fortë, i dyti i _____ dhe i treti i _____ .

Detyrë plotësuese për dosjen e nxënësit/es:

- Krijime në kohën 3/4.





Planifikimi ditor

Data.....

Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: III	Klasa: 6-të
Tematika: Gjuha dhe komunikimi muzikor. Tema mësimore: “Koha dhe pushimi 4/4”.		Situata e të nxënët: Gjuha dhe muzika Fjalët e gjata zakonisht janë katër rrokëshe kanë katër thekse, d.m.th. 4 goditje. Nxënësit/et gjejnë fjalë me 2, 3 dhe katër rrokje dhe krijojnë një histori të vogël. Gjatë këndimit evidentojnë theksin e fortë.	
 Rezultatet e të nxënët sipas kompetencave kyçe <i>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit:</i> (2) Kupton drejt mesazhin artistik. <i>Kompetenca e të menduarit:</i> (1) Kërkon dhe gjen njohuritë muzikore në mënyrë të pavarur. <i>Kompetenca për të nxënë:</i> (2) Krijon në mënyrë të pavarur detyrën e dhënë. <i>Kompetenca personale:</i> (1) Zhvillon besimin tek vetja gjatë veprimtarive muzikore.			
 Rezultatet e të nxënët të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore: <ul style="list-style-type: none"> - krijon në kohën 4/4; - krijon duke përdorur kombinime të ndryshme vlera notash dhe pushimesh; - shpjegon ndryshueshmërinë e muzikës gjatë përdorimit të vlerave të ndryshme të notave dhe pushimeve. 		<input checked="" type="checkbox"/> Fjalë kyçe: <ul style="list-style-type: none"> - koha 4/4, - theksi i fortë, i butë, - pushimi i kohës 4/4. 	
 Burimet: <ul style="list-style-type: none"> - teksti i nxënësit/es, - libra të ndryshëm muzikorë, - materiale të përgatitura nga mësuesi/ja, - CD me shembuj muzikorë. 		Lidhja me fushat e tjera: <ul style="list-style-type: none"> - Matematika. 	
 Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve Mësimi fillon me një veprimtari konkrete ku nxënësit/et duhet të gjejnë fjalë me dy, tre dhe katër rrokje dhe të krijojnë një histori të vogël. Ata dëgjojnë muzikë në kohën 4/4 dhe gjatë dëgjimit evidentojnë katër thekset: theksin e fortë, të butë, gjysmë të fortë dhe të butë.			
Ndërtimi i njohurive të reja Mësues/ja vazhdon më tej veprimtarinë dhe u rikujton nxënësve/eve vlerën e notave muzikore. Shpjegohet koha 4/4 dhe 4 thekset: theksin e fortë, të butë, gjysmë të fortë dhe të butë. Mësuesi/ja demonstroi theksat edhe nëpërmjet rrokjeve të fjalëve në fillim dhe me shembuj të tjerë ritmikë. Nxënësit/et fillojnë vetë të krijojnë modele ritmike në kohën 4/4 për ta kuptuar më mirë këtë ritëm. Pastaj ata/ato fillojnë të krijojnë në fletoret e tyre ushtrime në kohën 4/4, me kombinime të ndryshme notash dhe pushimesh. Prezantojnë krijimet e tyre, duke i shpjeguar ato.			

Planifikimi ditor

Data.....

Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: III	Klasa: 6-të
Tematika: Teknika dhe procese. Tema mësimore: Kënga “Neve jemi luleborë”.		Situata e të nxënit: Kujdesi për lulet Nxënësit flasin për lulet dhe kujdesin ndaj tyre. Pse duhet të kujdesemi për to dhe sa të dobishme janë ato në jetën tonë?	
 Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe <i>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit: (2) Shfrytëzon mjetet artistike mundësitë e komunikimit dhe të të shprehurit në muzikë në mënyrë të pavarur.</i> <i>Kompetenca e të menduarit: (2) Zgjidh probleme të ndryshme muzikore/artistike</i> <i>Kompetenca për të nxënë (2) Përdor burime të ndryshme informacioni për të realizuar një krijim muzikor.</i> <i>Kompetenca personale: (1) Zhvillon besimin te vetja gjatë veprimtarive muzikore.</i> <i>Kompetenca qytetare: (1) Bashkëpunon me të tjerët për çështje të ndryshme kulturore.</i>			
 Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore: <ul style="list-style-type: none"> - këndon duke respektuar teknikën e këndimit përmes rregullave të përcaktuara; - interpreton këngën me ndjenjë dhe emocion; - respekton interpretimin dhe performimin e shokëve/shoqeve; - ndan përvojën e vet artistike me të tjerët; - respekton këngë të kulturave të tjera. 		<input checked="" type="checkbox"/> Fjalë kyçe: <ul style="list-style-type: none"> - melodi e këngës, - tekst i këngës, - rregulla të këndimit. 	
 Burimet: <ul style="list-style-type: none"> - teksti i nxënësit/es, - CD me vijën melodike të këngës. 		Lidhja me fushat e tjera: <ul style="list-style-type: none"> - Shkencat shoqërore dhe mjedisi: Njohuri për shoqërinë. 	
 Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve Mësuesi/ja u kërkon nxënësve/eve të thonë se cilat lule janë të dashura për ta. A kanë dhuruar lule? Kujt?			
Ndërtimi i njohurive të reja Për t'i shtuar repertorit të tyre edhe një këngë të re, ata mësojnë këngën mjaft të njohur “Neve jemi luleborë”, duke respektuar karakteristikat e këngës, e cila është thjeshtë dhe e bukur. Kënga këndohet disa herë në intonacion dhe në ritëm, duke respektuar rregullat e këndimit, dhe kënduar në grup.			

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Nxënësit/et:

- diskutojnë me njëri-tjetrin rreth këngëve të ndryshme që ata/ato këndojnë në festa të ndryshme familjare apo kur festojnë në shkollë dhe në komunitet;
- demonstrojnë se kanë mësuar këngën dhe tekstin e saj;
- këndojnë duke interpretuar këngën me ndjenjë dhe emocion, sipas rregullave të këndimit në ritëm dhe në intonacion.
- zhvillojnë detyrën me një tematikë të caktuar dhe e prezantojnë atë.


Punimet (ese, filmime, histori rreth temës) të nxënësve, ruhen në dosjen e tyre.

Vlerësimi

Vlerësimi i nxënësit/es do të kryhet për:

- diskutimet që ai/ajo bën duke lidhur njohuritë e tij/saj me temën e re;
- këndimin korrekt të këngës në ritëm dhe në intonacion, duke respektuar rregullat e këndimit;
- performimin/ interpretimin e këngës me emocion;
- për bashkëpunimin dhe për këndimin në grup;
- për realizimin e detyrës (këngës).

Shënime specifike:



Modele udhëzuese për zhvillimin e mësimit

► **Dëgjohen** në magnetofon fragmente këngësh të mësuar në klasat e kaluara: “Kur kthehem nga shëtitja”, “Shatërvani”, “Sa i dua lulet”.


Çfarë mesazhi përcjellin këto këngë?
A duhet të kujdesemi për lulet?

► **Vendoset** për dëgjim kënga “Neve jemi lulebore” dhe **vazhdohet** puna me mësimin e saj, sipas metodës:

- ☞ këndimi varg pas vargu;
- ☞ përsëritja e vargjeve herë pas here;
- ☞ këndimi i strofës;
- ☞ këndimi i strofës dhe refrenit;
- ☞ përsëritja e këngës nga fillimi në fund;
- ☞ interpretimi i këngës me ndjenjë dhe emocion;
- ☞ këndimi i këngës vetëm dhe në grup.

► **Gjatë mësimit të këngës** tregohet kujdes për respektimin e *ritmit, të intonacionit, të interpretimit të këngës.*

Ndahen nxënësit/et në grupe dhe shoqërojnë këngën me instrumente Orf.



2 $\frac{x}{1} \frac{x}{2} | \frac{x}{1} \frac{x}{2} | \frac{x}{1} \frac{x}{2} | \frac{x}{2} \frac{x}{1} | \frac{x}{1} \frac{x}{2} | \frac{x}{2}$ etj.

2 $\frac{x}{1} \frac{x}{2} | \frac{x}{1} \frac{x}{2} | \frac{x}{1} \frac{x}{2} | \frac{x}{1} \frac{x}{2} | \frac{x}{1} \frac{x}{2} | \frac{x}{1} \frac{x}{2}$ etj.





2 $\frac{x}{1} \frac{x}{1} | \frac{x}{1} \frac{x}{1} | \frac{x}{1} \frac{x}{1} | \frac{x}{1} \frac{x}{1} | \frac{x}{1} \frac{x}{1} | \frac{x}{1} \frac{x}{1} | \frac{x}{1} \frac{x}{1} | \frac{x}{1} \frac{x}{1}$ etj.

Detyrë plotësuese për dosjen e nxënësit/es:

- Ese për emocionet që na japin lulet. Prezantimi i saj në klasë.
- Gjetje nga interneti për lulet sipas stinëve, llojet e tyre, emërtimet, lulet që dhurohen për festa të veçanta. Prezantohet në klasë me *Power Point*.
- CD me kolazh këngësh që u kushtohen luleve.

Planifikimi ditor

Data.....

Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: III	Klasa: 6-të
Tematika: Teknika dhe procese. Tema mësimore: “Luajmë në fyell”.		Situata e të nxëniet: Folklori muzikor i popullit tim. Vazhdohet zgjerimi i situatës: tema 8.	
 Rezultatet e të nxëniet sipas kompetencave kyçe			
<p><i>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit:</i> (1) Krijon personalitetin e vet në veprimtaritë artistike.</p> <p><i>Kompetenca e të menduarit:</i> (3,4) Zhvillon aftësitë për të menduar në mënyrë krijuese dhe ndërvepruese.</p> <p>Ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim muzikor.</p> <p><i>Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin:</i> (1) Luan në mënyrë të pavarur detyrën e dhënë.</p> <p><i>Kompetenca për të nxënë:</i> (3) Interpreton vetëm dhe në grup.</p> <p><i>Kompetenca qytetare:</i> (1) Bashkëpunon me të tjerët për çështje të ndryshme kulturore.</p>			
 Rezultatet e të nxëniet të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> - luan apo këndon, duke respektuar simbolikat e mësuara; - luan në instrument duke respektuar rregullat e këtij instrumenti; - respekton interpretimin dhe performimin e shokëve/shoqeve; - ndan përvojën e vet artistike me të tjerët. 		<input checked="" type="checkbox"/> Fjalë kyçe: <ul style="list-style-type: none"> - fyell, - rregulla të luajtjes në instrument. 	
 Burimet: <ul style="list-style-type: none"> - teksti i nxënësit/es, - instrumenti i fyellit (blokflaut), - CD. 		Lidhja me temat ndërkurrikulare <ul style="list-style-type: none"> - Trashëgimia jonë kulturore. 	
 Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve Mësues/ja rikujton rregullat e luajtjes në instrumentin e fyellit.			
Ndërtimi i njohurive të reja Nxënësit/et luajnë melodi me kohë të thjeshta. Ata/ato ekzekutojnë vetëm ose të gjithë së bashku meloditë. Në fillim i punojnë ato me fraza pastaj bëjnë të gjithë ushtrimin.			

Modele udhëzuese për zhvillimin e mësimit

► Ushtrim me instrumentin e fyellit në kohën 3/4 dhe 4/4

► Rikujtohen:

- ⊕ rregullat e mbajtjes dhe të interpretimit me të;
- ⊕ ekzekutimi në kohën 3/4 dhe 4/4;
- ⊕ respektimi i vlerave të notës dhe të pushimit 1/4, 1/8, 2/4, 3/4,
- ⊕ ekzekutimi i saktë i repertorit.

Popullore korçare

1

Xhuzepe Verdi

2

3 *Moderato*




Tonin Harapi

Detyrë plotësuese në shtëpi:

- Përsëritje e ushtrimeve deri në përvetësimin e mirë të tyre.

Planifikimi ditor

Data.....


Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: III	Klasa: 6-të
Tematika: Gjuha dhe komunikimi. Tema mësimore: “Përforcimi i temave të mësuara”.		Situata e të nxënët: Përsëritje e njohurive të marra.	
 Rezultatet e të nxënët sipas kompetencave kyçe <i>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit: (2) Kupton drejt mesazhin artistik.</i> <i>Kompetenca e të menduarit: (1) Kërkon dhe gjen njohuritë muzikore në mënyrë të pavarur.</i> <i>Kompetenca për të nxënë: (2) Krijon në mënyrë të pavarur detyrën e dhënë.</i> <i>Kompetenca personale: (1) Zhvillon besimin te vetja gjatë veprimtarive muzikore.</i>			
Rezultatet e të nxënët të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore: <ul style="list-style-type: none"> - rikujton kohët e mësuara 2/4, 3/4, 4/4; - lexon, shkruan, krijon dhe ekzekuton duke respektuar rregullat në kohën 4/4; - lexon, shkruan, krijon dhe ekzekuton lidhjen vlerëse, notën 1/8. 		<input checked="" type="checkbox"/> Fjalë kyçe: <ul style="list-style-type: none"> - krijim, - ekzekutim i pjesëve për fyell, - koha 2/4, 3/4, 4/4. 	
 Burimet: <ul style="list-style-type: none"> - teksti i nxënësit/es, - libra të ndryshëm muzikorë, - materiale të përgatitura nga mësuesi/ja, - CD me shembuj muzikorë. 		Lidhja me fushat e tjera: <ul style="list-style-type: none"> - Matematika. 	
 Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve Mësimi fillon me një veprimtari konkrete ku krijon modele ritmike në kohët e thjeshta. Më pas ata performojnë këngë dhe pjesë për fyell në kohën 2/4, 3/4, 4/4.			
Ndërtimi i njohurive të reja Vazhdon performimi vetëm ose në grup, duke e përcaktuar vetë nxënësit/et grupin më të mirë.			
Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura Nxënësit: <ul style="list-style-type: none"> - demonstrojnë cilësisht performimin vokal në 4/4; - demonstrojnë cilësisht performimin instrumental në 4/4; - krijojnë modele ritmike në kohën 2/4; - krijojnë ushtrime me kombinime të ndryshme notash dhe pushimesh në 4/4 dhe i luajnë ato. Detyrat e krijuara të nxënësve/eve ruhen në dosjen e tyre.			

Vlerësimi

Vlerësimi i nxënësit/et do të kryhet për:

- diskutimet që ai/ajo bën, duke lidhur njohuritë e tij/saj me temën e re;
- krijimet personale muzikore në kohën 4/4;
- pjesëmarrjen aktive gjatë performimit vokal dhe instrumental dhe në çështje të tjera që lidhen me temën e re.

Shënime specifike:



Modele udhëzuese për zhvillimin e mësimit



VERIFIKO NJOHURITË

1 Plotëso vendet bosh, në fjalitë e mëposhtme.

- a. Fyelli është instrument _____, i cili bën pjesë në familjen e _____ dhe ka tetë _____.
- b. Melodia është _____ që këndohet ose ekzekutohet sipas _____.
- c. Ritmi është i formuar nga _____.
- d. Tempi është _____ me të cilën luhet melodia. Termat që përcaktojnë shpejtësinë janë: e ngadaltë, mesatare dhe e shpejtë, ndryshe shkruhen _____ dhe allegro.
- e. Nota 1/4 ose çerekëshe zgjat _____ kohë.

2 Instrumentet muzikore popullore ndahen në katër familje të cilat janë:

1. _____
2. _____
3. _____
4. _____

3 Plotëso kutitë bosh.

			¹ F									
					² L							
	³ T											
⁴ M												
		⁵ A										
	⁶ I											
			⁷ K									
		⁸ A										

1. Instrument që nxjerr tingullin nga shtytja e presionit të ajrit dhe ka tetë vrima.
2. Ritmi matet me...
3. Shpejtësia me të cilën luajmë një pjesë muzikore.
4. Instrumente që përbëhen nga lëkurë e tendosur.
5. Instrumente që nxjerrin tingullin përmes shtytjes së ajrit.
6. Instrumente që nxjerrin tingullin përmes goditjeve.
7. Instrumente që nxjerrin tingullin përmes pickimit.
8. Luhet ngadalë një pjesë që ka të shkruar termin.

4 Rretho përgjigjen e saktë.

- | | | |
|--|---|---|
| 1. Fyelli bën pjesë në instrumentet popullore. | V | G |
| 2. Këmbana është instrument idiofon. | V | G |
| 3. Mandolina është instrument me tela. | V | G |
| 4. Tamburi nuk ka lëkurë të tendosur. | V | G |
| 5. Trekëndëshi është instrument i përbërë nga druri. | V | G |
| 6. Këmbanat janë instrumente me madhësi të ndryshme. | | |



■ PLANIFIKIMI 3 MUJOR⁶: PERIUDHA: PRILL – QERSHOR



Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe

Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit

1. Krijon personalitetin e vet në veprimtaritë artistike.
2. Kupton drejt mesazhin artistik.
3. Demonstron një komunikim të qartë me anë të gjuhës muzikore, të simboleve, të shenjave dhe të formave muzikore.
4. Shfrytëzon mjetet artistike, mundësitë e komunikimit dhe të të shprehurit në muzikë në mënyrë të pavarur.

Kompetenca e të menduarit

1. Kërkon dhe gjen njohuritë muzikore në mënyrë të pavarur.
2. Zgjidh probleme të ndryshme muzikore/artistike.
3. Zhvillon aftësitë për të menduar në mënyrë krijuese dhe ndërvepruese.
4. Ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim muzikor.

Kompetenca e të mësuarit për të nxënë

1. Klasifikon mjetet për të realizuar një krijim muzikor.
2. Përdor burime të ndryshme informacioni për të realizuar një krijim muzikor.
3. Krijon në mënyrë të pavarur detyrën e dhënë.

Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin

1. Ndërmerr nisma për të zhvilluar aktivitete muzikore brenda dhe jashtë klasës duke kontribuar në mënyrë krijuese.

Kompetenca personale

1. Zhvillon besimin te vetja gjatë veprimtarive muzikore.
2. Përfshihet në mënyrë aktive në jetën artistike shkollë dhe në komunitet.
3. Rrit ndërgjegjësimin për veten, në zhvillimin e vetëbesimit dhe në krijimin e besimit te të tjerët.

Kompetenca qytetare

1. Bashkëpunon me të tjerët për çështje të ndryshme kulturore.
2. Respekton punën e të tjerëve.
3. Bashkëpunon me të tjerët pavarësisht kulturës, brenda dhe jashtë shkollës.

Kompetenca digjitale

1. Krijon informacion si dhe bashkëpunon në rrjetet informuese në internet.
2. Njeh mjetet të ndryshme në funksion të informacionit muzikor si: magnetofon, audio, video CD, DVD etj.

⁶ Bazuar në specifikën që ka kjo lëndë, domethënë në ndërthurjen e tematikave, përshkrimi i tyre dhe i kompetencave lëndore mund të bëhet më vete, por gjithmonë bazuar vetëm në tërësinë e njohurive që do t'u jepen nxënësve/eve për çdo tremujor.

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të lëndës		
<i>Krijimi muzikor:</i>	<i>Performimi/interpretimi muzikor:</i>	<i>Vlerësimi muzikor:</i>
<p>♪ krijon në kohët 2/4, 3/4, 4/4;</p> <p>♪ krijon duke përdorur kombinime të ndryshme vlerash notash dhe pushimesh;</p> <p>♪ demonstron kuptimin e tyre gjatë shpjegimit të krijimit të vet;</p> <p>♪ komunikon qartë njohuritë muzikore, duke i lidhur ato me emocionet e këngëve që këndon;</p> <p>♪ provon të këndojë fragmente të vogla muzikore për të kuptuar <i>ndryshueshmërinë e muzikës.</i></p>	<p>◆ demonstron gjatë interpretimit të këngëve simbolet muzikore;</p> <p>◆ luan në instrument apo këndon duke respektuar simbolikat e mësuara;</p> <p>◆ këndon duke respektuar teknikën e këndimit përmes rregullave të përcaktuara;</p> <p>◆ interpreton këngët me ndjenjë dhe emocion; performon/ interpreton këngët në eventet e klasës apo të shkollës;</p> <p>◆ përdor media (DVD, CD, magnetofon) për të reklamuar/ prezantuar punën e vet.</p> <p>◆ luajmë me fyell në kohën e thjeshtë 2/4;</p> <p>◆ luajmë me fyell në kohën e thjeshtë 3/4;</p> <p>◆ luajmë me fyell në kohën e thjeshtë 4/4;</p> <p>◆ minueti;</p> <p>◆ kënga.</p>	<p>☺ shpjegon ndryshueshmërinë e muzikës gjatë respektimit të simboleve;</p> <p>☺ shpreh emocionet e veta për këngët që këndon;</p> <p>☺ përdor një gjuhë të qartë dhe të thjeshtë, gjatë përjetimit emocional të pjesëve muzikore që dëgjon;</p> <p>☺ bën lidhje ndërmjet asaj që di mbi format muzikore, instrumentet apo vokalin dhe asaj që dëgjon në një veper muzikore;</p> <p>☺ bën gjykime kritike ndaj një muzike të caktuar, duke u mbështetur në gjuhën muzikore, në <i>ndryshueshmërinë e ritmeve muzikore, në shpejtësinë muzikore, në formën muzikore, në karakterin e pjesëve muzikore;</i></p> <p>☺ komunikon mendimin e vet rreth veprave muzikore të dëgjuara;</p> <p>☺ reflekton emocionet që i krijon një veper muzikore gjatë kohës që interpretohet/ luhet;</p> <p>☺ shpreh mendimin e vet rreth pjesës muzikore që dëgjon;</p> <p>☺ përdor një fjalor të thjeshtë muzikor;</p> <p>☺ respekton mendimin e shokëve;</p> <p>☺ merr pjesë në aktivitete të ndryshme brenda dhe jashtë shkollës.</p>

■ Tremujori i tretë: Prill - Qershor, planifikimi i temave mësimore





1.	<i>Gjuha dhe komunikimi muzikor.</i>	Nota dhe pushimi 1/8.	Situatë të nxëni: Fjalët e shkurtra zakonisht janë njërrrokëshe kanë një theks, pra, një goditje. Nxënësit/et bëjnë një rreth dhe e ndajnë atë në tetë pjesë.	<ul style="list-style-type: none"> - teksti i nxënësit/es, - materiale të përgatitura nga mësuesi/ja, - CD me shembuj muzikorë.
2.	<i>Teknika dhe procese.</i>	Lidhja vlerëse dhe shprehëse.	Situatë të nxëni: Ashtu si në gjuhë përdoren lidhëza për të lidhur dy ose më shumë fjali, në muzikë përdoret lidhja vlerëse dhe shprehëse. Nxënësi/ja gjen në libër pjesë me lidhjen vlerëse dhe shprehëse dhe bën komente rreth tyre.	<ul style="list-style-type: none"> - teksti i nxënësit/es, - materiale të përgatitura nga mësuesi/ja.
3.	<i>Teknika dhe procese.</i>	“Këngë djepi” Johan Brahms	Situatë të nxëni: Ninulla si pjesë e ciklit të rritjes së fëmijëve. Nxënësit/et dëgjojnë në magnetofon disa prej tyre dhe nxjerrin disa karakteristika që i përbëjnë këto këngë.	<ul style="list-style-type: none"> - teksti i nxënësit/es, - CD me vijën melodike të këngës.
4.	<i>Teknika dhe procese.</i>	Kënga: “The farmer in the dell”	Situatë të nxëni: Vendosen për dëgjim disa këngë lojë. Nxënësit/et ndahen në grupe dhe zgjedhin kryetarin e tyre, i cili drejton rolin e strofës që zgjedh.	<ul style="list-style-type: none"> - teksti i nxënësit/es, - materiale të përgatitura nga mësuesi/ja, - CD me shembuj muzikorë.

5.	<i>Historia, shoqëria, muzika.</i>	Forma e thjeshtë muzikore – Minueti.	Situatë të nxëni: Dëgjimi i një pjese muzikore (minuet - Bokerini) ku nxënësit/et duhet të dallojnë ritmin në të cilën luhet pjesa. Ata diskutojnë dhe për karakteristika të tjera.	<ul style="list-style-type: none"> - teksti i nxënësit/es, - CD me shembuj muzikorë.
6.	<i>Historia, shoqëria, muzika.</i>	Forma e thjeshtë muzikore - Kënga.	Situatë të nxëni: Kënga është forma më e thjeshtë muzikore. “The Farmer in the dell” është një këngë, e cila ka një karakteristikë të veçantë. Nxënësit/et e dëgjojnë dhe e thonë atë.	<ul style="list-style-type: none"> - teksti i nxënësit/es, - materiale të përgatitura nga mësuesi/ja, - CD me shembuj muzikorë.
7.	<i>Teknika dhe procese</i>	Repertor këngësh dhe ushtrimesh për fyell.	Situatë të nxëni: Përsëritje e këngëve dhe e pjesëve për fyell.	<ul style="list-style-type: none"> - teksti i nxënësit/es, - materiale të instrumenti i fyellit, - CD me këngë të ndryshme.
8.	<i>Teknika dhe procese</i>	Përforsim i temave të mësuara.	Situatë të nxëni: Përsëritje e këngëve dhe e pjesëve për fyell.	<ul style="list-style-type: none"> - teksti i nxënësit/es, - materiale të instrumenti i fyellit, - CD me këngë të ndryshme.
9.		Projekt kurrikular.	Përgatitja e një koncerti.	<ul style="list-style-type: none"> - teksti i nxënësit/es, - materiale të përgatitura nga mësuesi/ja, - CD me shembuj muzikorë.
<p>Metodologjia Metoda interaktive, bashkëvepruese, gjithëpërfshirëse. Puna në grup dhe puna individuale. Hetimi dhe zbulimi. Zbatime praktike brenda dhe jashtë klase. Metoda integruese. Bashkëbisedim. Teknika që zhvillojnë mendimin kritik dhe krijues. Prezantime në forma të ndryshme, përfshirë TIK Projekte kurrikulare.</p>				
<p>Vlerësimi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - vlerësimi përshkrues, - vlerësimi i tematikave përmbyllëse, - vlerësimi i dosjes. 				

■ PLANIFIKIMI DITOR PËR TREMUJORIN Ë TRETË PRILL - QERSHOR BAZUAR NË SITUATË TË NXËNI

Planifikimi ditor

Data.....

Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: III	Klasa: 6-të
Tematika: Gjuha dhe komunikimi muzikor Tema mësimore: “Nota dhe pushimi 1/8”		Situata e të nxënit: Gjuha dhe muzika Vazhdimi i situatës së temës 9, ku zgjerohet situata më tej, duke bërë lidhjen me temën e re.	
 Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe <i>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit:</i> (2) Kupton drejt mesazhin artistik. <i>Kompetenca e të menduarit:</i> (1) Kërkon dhe gjen njohuritë muzikore në mënyrë të pavarur. <i>Kompetenca për të nxënë:</i> (2) Krijon në mënyrë të pavarur detyrën e dhënë. <i>Kompetenca qytetare:</i> (1) Bashkëpunon me të tjerët për çështje të ndryshme.			
 Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore: <ul style="list-style-type: none"> - demonstroi kuptimin e notës 1/8 si njësi shumë e shkurtër numërimi; - provon të këndojë fragmente të vogla muzikore për të kuptuar <i>ndryshueshmërinë e muzikës</i> dhe karakterin që ato kanë; - ndan përvojën e vet artistike me të tjerët. 		<input checked="" type="checkbox"/> Fjalë kyçe: <ul style="list-style-type: none"> - nota 1/8, - pushimi 1/8. 	
 Burimet: <ul style="list-style-type: none"> - teksti i nxënësit/es, - materiale të përgatitura nga mësuesi/ja. 		Lidhja me fushat e tjera: <ul style="list-style-type: none"> - Matematika. 	
 Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve Nxënësit/et kujtojnë temën mësimore të vlerave të notës dhe të ndarjes së tyre në: nota të plota, gjysmë, 1/4 dhe 1/8. Pra 1/8 është vlera më e vogël e notës që ata kanë ndeshur deri tani.			
Ndërtimi i njohurive të reja Veprimtaria mësimore vazhdon më tej dhe mësuesi/ja sjell përmes dëgjimit në magnetofon shumëllojshmëri gjatësish notash dhe pushimesh, dhe nxënësit/et fillojnë t’i klasifikojnë ato sipas grupit të vlerave që ato kanë. Më pas shpjgohet nota e pushimi 1/8 dhe zhvillohen modele ritmike që të kuptohet më qartë.			

Modele udhëzuese për zhvillimin e mësimit

► **Prezantohet** ushtrimi më poshtë dhe kërkohet nga nxënësit/et të vendosin shigjetën në ato njohuri që ata dinë dhe të veçojnë njohurinë e re.

1 Lidh me shigjetë shenjat e notave dhe të pushimeve në të djathtë me fjalën që duhet në të majtë.


► Shpjegohet:

- ☞ nota 1/8;
- ☞ *pushimi 1/8*;
- ☞ kuptimi i gjatësisë së notës dhe i pushimit 1/8 në një krijim.

► Vazhdohet me:

- ☞ leximin dhe këndime të ushtrimeve në libër në kohën 2/4, 3/4, 4/4, për të kuptuar më mirë notën dhe pushimin 1/8;
- ☞ krijimin në fletoret të ushtrimeve në kohë të ndryshme, me përdorimin dhe kombinime të ndryshme vlerash notash dhe pushimesh, por edhe me notën dhe pushimin 1/8;
- ☞ me paraqitjen e krijimeve, duke i shpjeguar ato.

- a. Nota e plotë
- b. Pushimi 1/4 ose çerekësh
- c. Pushimi 1/8
- d. Nota gjysmë
- f. Pika e vlerës
- f. Nota 1/4 ose çerekëshe
- g. Pushimi i plotë
- h. Pushimi gjysmë
- i. Nota tetëshe



Ajo është nota dhe pushimi 1/8.

► Ushtrime për argëtim 1, 2

1. Plotëso tabelën e mëposhtme duke vendosur vlerat e notave dhe të pushimeve.

Nota	Si quhet	Pushimi	Si quhet	Koha	Rrahjet
	Notë e plotë		Pushim i plotë	4/4	Katër kohë

2. Rretho përgjigjen e saktë.





- | | | |
|--|---|---|
| 1. Nota e 1/8 ka dy kërraba. | V | G |
| 2. Nota e plotë është e barabartë me 8 nota 1/8. | V | G |
| 3. Pushimi 1/4 është i barabartë me 2 pushime 1/8. | V | G |
| 4. Koha 2/4 formohet nga 1 notë 1/4 dhe 2 tetëshe. | V | G |
| 5. Gjysmë notë është e barabartë me 3 nota tetëshe. | V | G |
| 6. Nota 1/8 ka një kërrabë. | V | G |
| 7. Nota 1/4 ose çerekëshe është e barabartë me 2 nota 1/8. | V | G |

Detyrë plotësuese për dosjen e nxënësit/es:

- Krijime në kohën 2/4, 3/4, 4/4 sipas dëshirës.


Planifikimi ditor

Data.....

Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: III	Klasa: 6-të
Tematika: Gjuha dhe komunikimi muzikor Tema mësimore: "Lidhja vlerëse dhe shprehëse".		Situata e të nxënimit: Gjuha dhe muzika.	
 Rezultatet e të nxënimit sipas kompetencave kyçe <i>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit:</i> (2) Kupton drejt mesazhin artistik. <i>Kompetenca e të menduarit:</i> (1) Kërkon dhe gjen njohuritë muzikore në mënyrë të pavarur. <i>Kompetenca për të nxënë:</i> (2) Krijon në mënyrë të pavarur detyrën e dhënë. <i>Kompetenca qytetare:</i> (1) Bashkëpunon me të tjerët për çështje të ndryshme.			
 Rezultatet e të nxënimit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore: <ul style="list-style-type: none"> - demonstroi kuptimin e lidhjes vlerëse dhe shprehëse si dhe funksionin e tyre në muzikë; - provon të këndojë fragmente të vogla muzikore për të kuptuar <i>ndryshueshmërinë e muzikës</i> kur përdorim këto simbole muzikore; - ndan përvojën e vet artistike me të tjerët. 		<input checked="" type="checkbox"/> Fjalë kyçe: <ul style="list-style-type: none"> - lidhja vlerëse, - lidhja shprehëse. 	
 Burimet: <ul style="list-style-type: none"> - teksti i nxënësit/es, - materiale të përgatitura nga mësuesi/ja. 		Lidhja me fushat e tjera: <ul style="list-style-type: none"> - Matematika. 	
 Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve Nxënësit/et kujtojnë temën mësimore të pikës së vlerës dhe funksionin që kryen ajo kur i vendoset notës. Edhe lidhja vlerëse kryen të njëjtin funksion por është një simbol tjetër.			
Ndërtimi i njohurive të reja Mësuesi/ja shpjegon konkretisht çfarë është lidhja shprehëse dhe lidhja vlerëse nëpërmjet shembujve muzikorë. Lidhja shprehëse është shumë domethënëse në interpretimin e këngëve dhe të pjesëve muzikore.			
Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura Nxënësit/et: <ul style="list-style-type: none"> - demonstrojnë kuptimin e lidhjes vlerëse dhe lidhjes shprehëse - lexojnë dhe shkruajnë në kohët 2/4, 3/4 dhe 4/4 duke përdorur lidhjen vlerëse. - krijojnë ushtrime në kohë të ndryshme duke përdorur këto simbole muzikore. Punimet (nëse nxënësit/et kanë bërë) ruhen në dosjen e tyre.			
Vlerësimi Vlerësimi i nxënësit/es do të kryhet për: <ul style="list-style-type: none"> - diskutimet që ai/ajo bën, duke lidhur njohuritë e tij/saj me temën e re. - përdorimin e simboleve muzikore në krijimet e tij/saj. - për pjesëmarrjen në gjetjen dhe në realizimin e informacionit. 			

Modele udhëzuese për zhvillimin e mësimimit

► **Paraqitet** figura dhe diskutohet rreth kuptimit dhe funksionit që ajo ka.



☹ Vendoset për dëgjim një pjesë ku kemi një notë mjaft të gjatë p.sh: Këngë djepi – Brahms. Gjetet fragmenti ku tingulli mbahet i zgjatur.

► **Shpjegohet:**

- ☞ lidhja vlerëse,
- ☞ lidhja shprehëse,
- ☞ funksioni i tyre në muzikë.

► **Vazhdohet me:**

- ☞ leximin dhe këndime të ushtrimeve në libër me simbolin e *lidhjes vlerëse* dhe *shprehëse*, për të kuptuar më mirë këto dy figura muzikore,
- ☞ krijime në fletore të ushtrimeve në kohë të ndryshme, duke përdorur kombinime të ndryshme vlerash notash dhe pushimesh, por edhe *lidhjen vlerëse dhe shprehëse*,
- ☞ paraqitjen krijimeve, duke i shpjeguar ato.

► Ushtrime për argëtim 1, 2

1. Plotëso vendet bosh në fjalitë e mëposhtme.

Lidhje vlerëse quhet vija e lakuar _____

Lidhje shprehëse quhet vija e lakuar që lidh _____

2. Lidh me shigjetë figurën me emërtimin e dhënë.



Lidhja shprehëse







Lidhja vlerëse

Detyrë plotësuese për dosjen e nxënësit/es:

- Krijime në kohën të ndryshme me përdorimin e lidhjes vlerëse dhe shprehëse.

Planifikimi ditor

Data.....

Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: III	Klasa: 6-të
Tematika: Teknika dhe procese. Tema mësimore: “Këngë djepi” Johan Brahms.		Situata e të nxënësve: Ninullat si pjesë e ciklit të rritjes së fëmijëve. Nxënësit/et dëgjojnë në magnetofon disa prej tyre dhe nxjerrin disa karakteristika që i përbëjnë këto këngë.	
 Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe <i>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit: (2) Shfrytëzon mjetet artistike mundësitë e komunikimit dhe të të shprehurit në muzikë në mënyrë të pavarur.</i> <i>Kompetenca e të menduarit: (2) Zgjidh probleme të ndryshme muzikore/artistike</i> <i>Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin: (1) Ndërmerr nisma për të zhvilluar aktivitete muzikore brenda dhe jashtë klasës duke kontribuar në mënyrë krijuese.</i> <i>Kompetenca personale: (1) Zhvillon besimin te vetja gjatë veprimtarive muzikore.</i> <i>Kompetenca qytetare: (1) Bashkëpunon me të tjerët për çështje të ndryshme kulturore.</i>			
 Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore: <ul style="list-style-type: none"> - këndon duke respektuar teknikën e këndimit përmes rregullave të përcaktuara; - interpreton këngën me ndjenjë dhe emocion; - respekton interpretimin dhe performimin e shokëve/shoqeve; - ndan përvojën e vet artistike me të tjerët; - respekton këngë të kulturave të tjera. 		<input checked="" type="checkbox"/> Fjalë kyçe: <ul style="list-style-type: none"> - melodi e këngës, - tekst i këngës, - rregulla të këndimit, - këngë djepi/ninullë. 	
 Burimet: <ul style="list-style-type: none"> - teksti i nxënësit/es, - CD me vijën melodike të këngës. 		Lidhja me fushat e tjera: <ul style="list-style-type: none"> - Shkencat shoqërore dhe mjedisi: Njohuri për shoqërinë. - Gjuhët dhe komunikimi: Letërsia. 	
 Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve Mësues/ja vendos disa ninulla dhe u kërkon nxënësve/eve të flasin rreth tyre dhe karakteristikave që ato kanë. Ninulla është pjesë e ciklit të rritjes së fëmijëve. Nxënësit/et dëgjojnë në magnetofon disa prej tyre dhe nxjerrin disa karakteristika që i përbëjnë këto këngë.			
Ndërtimi i njohurive të reja Për t’i shtuar repertorit të tyre edhe një këngë, ata mësojnë këngën e re, duke respektuar karakteristikat e këngës, e cila është thjeshtë, e bukur, dhe e qetë. Kënga këndohet disa herë në intonacion dhe në ritëm, duke respektuar rregullat e këndimit, dhe duke e kënduar në grup.			

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Nxënësit/et:

- diskutojnë me njëri-tjetrin rreth ninullave;
- demonstrojnë se kanë mësuar këngën dhe tekstin e saj;
- këndojnë duke interpretuar këngën me ndjenjë dhe emocion, sipas rregullave të këndimit në ritëm dhe në intonacion;
- zhvillojnë detyrën me një tematikë të caktuar dhe e prezantojnë atë.

Punimet (ese, filmime, histori rreth temës) të nxënësve, ruhen në dosjen e tyre.

Vlerësimi

Vlerësimi i nxënësit/es do të kryhet për:

- diskutimet që ai/ajo bën, duke lidhur njohuritë e tij/saj me temën e re;
- këndimin korrekt të këngës në ritëm dhe në intonacion, duke respektuar rregullat e këndimit;
- performimin/ interpretimin e këngës me emocion;
- për bashkëpunimin dhe për këndimin në grup;
- për realizimin e detyrës (këngës).

Shënime specifike:





Modele udhëzuese për zhvillimin e mësimit



► **Vazhdohet** puna me mësimin e këngës “Këngë djepi”, sipas metodës:



- ☞ këndimi varg pas vargu;
- ☞ përsëritja e vargjeve herë pas here;
- ☞ këndimi i strofës;
- ☞ këndimi i strofës dhe i refrenit;
- ☞ përsëritja e këngës nga fillimi në fund;
- ☞ interpretimi i këngës me ndjenjë dhe emocion;
- ☞ këndimi i këngës vetëm dhe në grup.

► **Gjatë mësimit të këngës** tregohet kujdes për respektimin e *ritmit*, të *intonacionit*, të *interpretimit* të këngës.

Ndahen nxënësit në grupe dhe e shoqërojnë këngën me instrumente Orf.



 etj.



 etj.






 etj.

Detyrë plotësuese për dosjen e nxënësit/es:

- Shprehin disa emocione për këngët e djepit.
- Mbledhin informacion në internet për këngët e djepit sipas stinëve, llojet e tyre, emërtimet, lulet që dhurohen për festa të veçanta dhe e prezantojnë në klasë me *Power Point*.
- CD me kolazh këngësh djepi.

Planifikimi ditor

Data.....

Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: III	Klasa: 6-të
Tematika: Teknika dhe procese. Tema mësimore: Kënga “The farmer in the dell”.		Situata e të nxënit: Vendosen për dëgjim këngë-lojë për fëmijë. Nxënësit/et luajnë sipas fjalëve të këngës duke u ndarë në grupe.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe <i>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit:</i> (2) Shfrytëzon mjetet artistike mundësitë e komunikimit dhe të të shprehurit në muzikë në mënyrë të pavarur. <i>Kompetenca e të menduarit:</i> (2) Zgjidh probleme të ndryshme muzikore/artistike <i>Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin:</i> (1) Ndërmerr nisma për të zhvilluar aktivitete muzikore brenda dhe jashtë klasës duke kontribuar në mënyrë krijuese. <i>Kompetenca personale:</i> (1) Zhvillon besimin te vetja gjatë veprimtarive muzikore. <i>Kompetenca qytetare:</i> (1) Bashkëpunon me të tjerët për çështje të ndryshme kulturore.			
 Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> - këndon duke respektuar teknikën e këndimit përmes rregullave të përcaktuara; - interpreton këngën me ndjenjë dhe emocion; - respekton interpretimin e shokëve/shoqeve; - ndan përvojën e vet artistike me të tjerët; - respekton këngë të kulturave të tjera. 		<input checked="" type="checkbox"/> Fjalë kyçe: <ul style="list-style-type: none"> - melodi e këngës, - tekst i këngës, - rregullat e këndimit. 	
 Burimet: <ul style="list-style-type: none"> - teksti i nxënësit, - CD me vijën melodike të këngës. 		Lidhja me fushat e tjera: <ul style="list-style-type: none"> - Shkencat shoqërore dhe mjedisi: Njohuri për shoqërinë. - Gjuhët dhe komunikimi: Letërsia. 	
 Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve Vendosen për dëgjim disa këngë-lojë, të cilat i gjen mësuesi/ja. Nxënësit/et luajnë duke kënduar me këngët të udhëhequr nga mësuesi/ja.			
Ndërtimi i njohurive të reja Mësohet kënga me strofa, bëhet përsëritje në ato fraza ku nxënësit/et do të interpretojnë edhe lojën. Këndohet e gjithë kënga nga grupet. Kënga këndohet disa herë në intonacion dhe në ritëm, duke respektuar rregullat e këndimit, dhe duke kënduar në grup.			

Modele udhëzuese për zhvillimin e mësimin


► **Vendoset** për dëgjim, kënga lojë dhe pyeten nxënësit/et të thonë disa karakteristika që ajo ka.

► **Vendoset** për dëgjim kënga “The farmer in the dell” dhe **vazhdohet** puna me mësimin saj sipas metodës:

- ☞ këndimi varg pas vargu;
- ☞ përsëritja e vargjeve herë pas here;
- ☞ këndimi i strofës;
- ☞ këndimi i strofës dhe refrenit;
- ☞ përsëritja e këngës nga fillimi në fund;
- ☞ interpretimi i këngës me ndjenjë dhe emocion;
- ☞ këndimi i këngës vetëm dhe në grup;
- ☞ bashkëpunimi në lojë sipas situatës që thuhet në tekst.

► **Gjatë mësimin të këngës** tregohet kujdes për respektimin e *ritmit, të intonacionit, të interpretimit* të këngës.

Ndahen nxënësit në grupe dhe e shoqërojnë këngën me instrumente Orf.



Three rhythmic patterns are shown, each starting with a '3' indicating a 3/4 time signature. The patterns are written on a single staff line with vertical lines representing notes and 'x' marks representing rests. The patterns are:

1. Tambourine: 3 | x | 2 | 3 | 1 | 2 | 3 | x | 2 | 3 | 1 | 2 | 3 | x | etj.

2. Triangle: 3 | x | 2 | 3 | 1 | 2 | 3 | x | 2 | 3 | 1 | 2 | 3 | x | etj.




3. Triangle with stick: 3 | x | 2 | 3 | 1 | 2 | 3 | x | 2 | 3 | 1 | 2 | 3 | x | etj.

Detyrë plotësuese për dosjen e nxënësit/es:

- CD me kolazh këngë-lojë shqiptare apo të huaja.

Planifikimi ditor

Data.....

Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: III	Klasa: 6-të
Tematika: Historia, muzika dhe shoqëria. Tema mësimore: “Forma e thjeshtë muzikore, Minueti”.		Situata e të nxënësve: Dëgjimi i një pjese muzikore (minuet - Bokerini) ku nxënësit/et duhet të dallojnë ritmin në të cilën luhet pjesa. Ata diskutojnë dhe për karakteristika të tjera	
 Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe <i>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit:</i> (3,4) Demonstron një komunikim të qartë me anë të gjuhës muzikore, të simboleve, të shenjave dhe të formave muzikore. Shfrytëzon mjetet artistike, mundësitë e komunikimit dhe të të shprehurit në muzikë në mënyrë të pavarur. <i>Kompetenca e të menduarit:</i> (1) Kërkon dhe gjen njohuritë muzikore në mënyrë të pavarur. <i>Kompetenca për të nxënë:</i> (2) Përdor burime të ndryshme informacioni për të realizuar një krijim muzikor. <i>Kompetenca qytetare:</i> (1) Bashkëpunon me të tjerët për çështje të ndryshme kulturore. <i>Kompetenca digjitale:</i> (1, 2) Krijon informacion dhe bashkëpunon në rrjetet informuese në internet. Njeh/përdor mjete të ndryshme në funksion të informacionit muzikor si: magnetofon, audio, video, CD, DVD etj.			
 Rezultatet e të nxënësve të lëndës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> - bën lidhje ndërmjet asaj që di mbi format muzikore, instrumentet apo vokalin dhe asaj që dëgjon në një vepër muzikore; - bën gjykim kritikë ndaj një muzike të caktuar, duke u mbështetur në gjuhën muzikore në <i>ndryshueshmërinë e ritmeve muzikore, në shpejtësinë muzikore, në formën muzikore, në karakterin e pjesëve muzikore;</i> - komunikon mendimin e vet rreth veprave muzikore të dëgjuara; - përdor një fjalor të thjeshtë muzikor. - përdor media (DVD, CD, magnetofon) për të reklamuar /prezantuar punën e vet. 		<input checked="" type="checkbox"/> Fjalë kyçe: - minuet.	
 Burimet: <ul style="list-style-type: none"> - teksti i nxënësve/es, - materiale të përgatitura nga mësuesi/ja, - CD, fragmente të ndryshme muzikore. 		Lidhja me fushat e tjera: <ul style="list-style-type: none"> - Shkencat shoqërore dhe mjedisi: Historia. 	

Modele udhëzuese për zhvillimin e mësimit

► **Vendoset** për dëgjim pjesa muzikore (minuet - Bokerini) dhe lihen nxënësit/et të shprehin rreth ritmit në të cilën luhet pjesa, si dhe të diskutojnë për karakteristika të tjera. Veprimtaria vazhdon duke vendosur dy minuite të tjera, nga Bah dhe Tonin Harapi, përmes të cilave ata kuptojnë ndryshueshmërinë dhe karakteristikat e minuetit si formë muzikore. Nxënësve/eve u drejtohet vëmendja te ndërtimi i minuetit dhe te ritmi i karakterit që ka kjo formë.

► Shpjegohet:

- ☞ ç'quajmë *minuet*;
- ☞ si është e ndërtuar kjo formë muzikore;
- ☞ cilat janë karakteristikat e saj.

► **Dëgjoen** përsëri *tri minuite*, që nxënësit/et të kuptojnë sa më mirë atë çka u shpjegua. Pjesët muzikore shoqërohen edhe me shpjegime biografike dhe historike të kohës dhe të autorëve.

► Ushtrime për argëtim 1, 2, 3


1. Duke dëgjuar pjesët muzikore, rretho kutinë së cilës i përket kjo pjesë.

A

A-B

A-B-C

2. Shpreh mendimin tënd për pjesët që dëgjon dhe vendose atë në dosjen tënde.



3. Rretho përgjigjen e saktë.





- | | |
|---|-----|
| • Minueti është gjinia më e vogël. | V G |
| • Xhanbatista Luli është kompozitor italian. | V G |
| • Tonin Harapi është poet. | V G |
| • Forma muzikore A - B është përsëritje. | V G |
| • Forma muzikore A - B - A është formë tripjesëshe. | V G |

Detyrë plotësuese për dosjen e nxënësit/es:

- Nxënësit/et gjejnë të dhëna në internet rreth jetës së Luixhi Bokerinit.

Planifikimi ditor

Data.....

Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: III	Klasa: 6-të
Tematika: Historia, muzika dhe shoqëria Tema mësimore: “Forma e thjeshtë muzikore, kënga”		Situata e të nxënët: Kënga është forma më e thjeshtë muzikore. “The Farmer in the dell” është një këngë e cila ka një karakteristikë të veçantë. Nxënësit/et e dëgjojnë dhe e thonë atë.	
 Rezultatet e të nxënët sipas kompetencave kyçe <i>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit: (3,4) Demonstron një komunikim të qartë me anë të gjuhës muzikore, simboleve, shenjave dhe formave muzikore.</i> Shfrytëzon mjetet artistike, mundësitë e komunikimit dhe të të shprehurit në muzikë në mënyrë të pavarur. <i>Kompetenca e të menduarit: (1) Kërkon dhe gjen njohuritë muzikore në mënyrë të pavarur.</i> <i>Kompetenca për të nxënë: (2) Përdor burime të ndryshme informacioni për të realizuar një krijim muzikor.</i> <i>Kompetenca qytetare: (1) Bashkëpunon me të tjerët për çështje të ndryshme kulturore.</i> <i>Kompetenca digjitale: (1, 2) Krijon informacion dhe bashkëpunon në rrjetet informuese në internet.</i> Njih/përdor mjete të ndryshme në funksion të informacionit muzikor si: magnetofon, audio, video, CD, DVD etj.			
 Rezultatet e të nxënët të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore: <ul style="list-style-type: none"> - bën lidhje ndërmjet asaj që di mbi format muzikore, instrumentet apo vokalin dhe asaj që dëgjon në një vepër muzikore; - bën gjykime kritike ndaj një muzike të caktuar, duke u mbështetur në gjuhën muzikore, në <i>ndryshueshmërinë e ritmeve muzikore, në shpejtësinë muzikore, në formën muzikore, në karakterin e pjesëve muzikore;</i> - komunikon mendimin e vet rreth veprave muzikore të dëgjuara; - përdor një fjalor të thjeshtë muzikor; - përdor media (DVD, CD, magnetofon) për të reklamuar/prezantuar punën e vet. 		<input checked="" type="checkbox"/> Fjalë kyçe: <ul style="list-style-type: none"> - kënga. 	
 Burimet: <ul style="list-style-type: none"> - teksti i nxënësit/es, - materiale të përgatitura nga mësuesi/ja, - CD, fragmente të ndryshme muzikore. 		Lidhja me fushat e tjera: <ul style="list-style-type: none"> - Shkencat shoqërore dhe mjedisi: Historia. 	
 Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve/eve Dëgjimi i këngës “The Farmer in the dell”. Kënga është forma më e thjeshtë muzikore. “Farmer the dell” është një këngë e cila ka një karakteristikë të veçantë. Nxënësit/et e dëgjojnë, diskutojnë dhe për karakteristika të tjera të këngës që ata dëgjojnë dhe të cilat i rendisin në dërrasë të zezë.			

Ndërtimi i njohurive të reja

Veprimtaria vazhdon duke vendosur 2 këngë të tjera, “Këngën e Solvegut” Eduard Grieg dhe “O fortuna” nga “Karmina Burana” e Karl Orfit, përmes të cilave ata kuptojnë ndryshueshmërinë dhe karakteristikat e formës së këngës si formë muzikore. Mësues/ja u kërkon nxënësve/eve që të gjejnë çfarë atyre u bën përshtypje, duke e drejtuar vëmendjen nga ndërtimi muzikor që ka kjo formë muzikore. Më pas shpjegon çfarë është kënga dhe si ndërtohet ajo. Mësues/ja vendos përsëri të dëgjojnë edhe një herë tre shembujt muzikorë që nxënësit/et të kuptojnë sa më mirë atë çka u shpjegua. Pjesët muzikore shoqërohen edhe me shpjegime biografike dhe historike të kohës dhe të autorëve. Nxënësit/et gjejnë të dhëna në internet rreth jetës së kompozitorëve të ndryshëm që kanë krijuar pjesët që dëgjuan.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Nxënësit/et:

- identifikojnë këngën dhe formën e saj gjatë dëgjimit muzikor;
- ekzekutojnë këngë të ndryshme;
- kërkojnë në internet për jetën dhe veprat e kompozitorëve.

Punimet (nëse nxënësit/et kanë bërë) ruhen në dosjen e tyre.

Vlerësimi

Vlerësimi i nxënësit/es do të kryhet për:

- diskutimet që ai/ajo bën, duke lidhur njohuritë e tij/saj me temën e re.
- për pjesëmarrjen aktive gjatë krijimit muzikor dhe në çështje të tjera që lidhen me temën e re.

Shënime specifike:



Modele udhëzuese për zhvillimin e mësimit

► **Vendosen** për dëgjim tri këngët në krah dhe diskutohet rreth tyre dhe rrethasaj që ata dallojnë.

Skema e këngës

- Këndo këngën “Atdheu im” → A - A - A
- Këndo këngën “Dua të kërcej” → A - Refren - A - Refren
- Këndo këngën “Fluturojmë të dy tok” → A - Refren - A

► Shpjegohet:


- ☞ ç’quajmë këngë,
- ☞ si është e ndërtuar kjo formë muzikore,
- ☞ cilat janë karakteristikat që dallojnë një këngë.

► **Dëgjoen** përsëri *tri këngë*, që nxënësit/et të kuptojnë sa më mirë atë çka u shpjegua. Pjesët muzikore shoqërohen edhe me shpjegime biografike dhe historike të kohës dhe autorëve.

- Dëgjo fragment nga Karl Orf - “Karmina Burana” (O fortuna) → A - A - A
- Dëgjo këngën “Con te partiro” nga Andrea Boçeli (Andrea Bocelli) - Sara Britman (Sarah Brightman) → A - B
- Dëgjo këngën nga Per Gynt Eduart Grig, “Kënga e Solvegut” → A - B - A






Detyrë plotësuese për dosjen e nxënësit/es:

- Nxënësit/et gjejnë të dhëna në internet rreth jetës këngëtarëve të preferuar dhe fotot e tyre.



Planifikimi ditor

Data.....

Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: III	Klasa: 6-të
Tematika: Teknika dhe procese. Tema mësimore: “Repertor me pjesë muzikore për fyell”.		Punohen ushtrime nga repertori në kohën 2/4, 3/3, 4/4.	
 Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe <i>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit:</i> (1) Krijon personalitetin e vet në veprimtaritë artistike. <i>Kompetenca e të menduarit:</i> (3,4) Zhvillon aftësitë për të menduar në mënyrë krijuese dhe ndërvepruese. Ndjek udhëzimet për të realizuar një pjesë muzikore. <i>Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin:</i> (1) Luan në mënyrë të pavarur detyrën e dhënë. <i>Kompetenca për të nxënë:</i> (3) Interpreton vetëm dhe në grup. <i>Kompetenca qytetare:</i> (1) Bashkëpunon me të tjerët për çështje të ndryshme kulturore.			
 Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> - luan apo këndon duke respektuar simbolikat e mësuara; - luan në instrument duke respektuar rregullat e këtij instrumenti; - respekton interpretimin dhe performimin e shokëve/shoqeve; - ndan përvojën e vet artistike me të tjerët. 		 Fjalë kyçe: <ul style="list-style-type: none"> - fyell, - rregullat e luajtjes në instrument. 	
 Burimet: <ul style="list-style-type: none"> - teksti i nxënësit/es, - instrumenti i fyellit (bllokflaut), - CD. 		Lidhja me fushat e tjera: <ul style="list-style-type: none"> - Shkencat shoqërore dhe mjedisi: Historia. - Gjuhët dhe komunikimi: Letërsia. Lidhja me temat ndërkurrikulare <ul style="list-style-type: none"> - Trashëgimia jonë kulturore. 	
 Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve Mësues/ja rikujton rregullat e luajtjes në instrumentin e fyellit.			
Ndërtimi i njohurive të reja Nxënësit/et luajnë në kohën 2/4, 3/3, 4/4 me fyellin. Ata ekzekutojnë vetëm ose të gjithë së bashku ushtrime të thjeshta.			

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Nxënësit:

- diskutojnë me njëri tjetrin rreth instrumenteve popullore.
- ekzekutojnë në fyell, ushtrime në kohën 2/4, 3/3, 4/4.
- respektojnë rregullat e luajtjes në fyell.

Vlerësimi



Vlerësimi i nxënësit/es do të kryhet për:

- diskutimet që ai/ajo bën, duke lidhur njohuritë e tij/saj me temën e re.
- ekzekutimin korrekt të notave muzikore dhe të kohës 2/4, 3/4, 4/4 në fyell, duke respektuar rregullat e luajtjes.

Shënime specifike:



Planifikimi ditor**Data.....**

Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: III	Klasa: 6-të
Tematika: Historia, muzika dhe shoqëria. Projekt kurrikular: “Muzika jonë popullore”.		Situata e të nxënit: Ne dhe muzika.	
 Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe			
<p><i>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit:</i> (3,4) Demonstron një komunikim të qartë me anë të gjuhës muzikore, simboleve, shenjave dhe formave muzikore. Shfrytëzon mjetet artistike mundësitë e komunikimit dhe të të shprehurit në muzikë në mënyrë të pavarur.</p> <p><i>Kompetenca e të menduarit:</i> (1) Kërkon dhe gjen njohuritë muzikore në mënyrë të pavarur.</p> <p><i>Kompetenca për të nxënë:</i> (2) Përdor burime të ndryshme informacioni për të realizuar një krijim muzikor.</p> <p><i>Kompetenca qytetare:</i> (2, 3) Respekton punën e të tjerëve. Bashkëpunon me të tjerët pavarësisht kulturës, brenda dhe jashtë shkollës.</p> <p><i>Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin:</i> (1) Ndërmerr nisma për të zhvilluar aktivitete muzikore brenda dhe jashtë klasës duke kontribuar në mënyrë krijuese</p> <p><i>Kompetenca personale:</i> (1,2) Zhvillon besimin tek vetja gjatë veprimtarive muzikore. Përfshihet në mënyrë aktive në jetën artistike shkollë dhe në komunitet.</p> <p><i>Kompetenca digjitale:</i> (1, 2) Krijon informacion si dhe bashkëpunon në rrjetet informuese në internet.</p> <p>Njih/përdor mjetet të ndryshme në funksion të informacionit muzikor si: magnetofon, audio, video CD, DVD etj.</p>			
 Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:		Fjalë kyçe:	
<ul style="list-style-type: none"> - komunikon qartë njohuritë muzikore, duke i lidhur ato me emocionet e këngëve që këndon; - performon/interpreton këngët në eventet e klasës apo të shkollës; - performon/interpreton këngë të ndryshme me emocion; - vlerëson interpretimin dhe performimin e të tjerëve; - respekton mendimin e shokëve/shoqeve; - merr pjesë në aktivitete të ndryshme brenda dhe jashtë shkollës. Përdor një fjalor të thjeshtë muzikor. - përdor media (DVD, CD, magnetofon) për të reklamuar/prezantuar punën e vet. 		<ul style="list-style-type: none"> - instrumentet popullore, - vallet popullore, - këngët popullore, - poezia. 	

**Burimet:**

- teksti i nxënësit/es,
- materiale nga interneti,
- materiale të përgatitura nga mësuesi/ja,
- CD, fragmente të ndryshme muzikore.

Lidhja me fushat e tjera:

- Shkencat shoqërore dhe mjedisi: Historia dhe gjeografia.
- Artet: kërcimi.
- Gjuha dhe komunikimi.

Lidhja me temat ndërkurrikulare

Të njohim kulturën e njëri-tjetrit.

**Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve/eve*****Ndarja e grupeve dhe ndarja e detyrave***

Mësues/ja bën prezantimin e temës që në fillim të orëve të para: Muzika jonë popullore. Më pas jep katër nëntema, të cilat do të zhvillohen nga nxënësit/et në grupe të veçanta, ku në secilin grup nxënësit/et zhvillojnë aftësitë e tyre më të mira:

Grupi TIK 1. Kërkon në internet muzikë popullore nga treva të ndryshme. 2. I zgjedh ato. 3. Krijon një CD dhe një DVD

Grupi i muzikantëve 2. Diskuton për këngët, vallet dhe kostumet popullore. 2. Diskuton karakteristikat e këngëve, valleve dhe të kostumeve popullore.

Grupi i letrarëve 3. Nxjerr fjalët e këngëve. 2. Bën komente letrare për tekstet e këngëve. 3. Bën ese për vallet dhe kostumet popullore.

Grupi i interpretuesve 4. Përzgjedh këngët dhe vallet. 2. I interpreton ato në klasë, në shkollë ose në komunitet.

Grupet punojnë secili në mënyrë të pavarur, duke zgjedhur vetë materialet dhe mjetet për të realizuar detyrën e ngarkuar.

Grupet e nxënësve/eve prezantojnë produktet e realizuara në fund të tremujorit.

Nxënësit/et vlerësojnë vetë punën e arritur nga secili grup.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Nxënësit/et:

- punojnë në grup;
- respektojnë mendimin e njëri-tjetrit gjatë punës;
- zhvillojnë detyrën sipas tematikës së caktuar dhe e prezantojnë atë;

Produktet e krijuara të nxënësve/eve ruhen në dosjen e tyre.

Vlerësimi



Vlerësimi i nxënësit/es do të kryhet për:



- pjesëmarrjen aktive gjatë krijimit muzikor dhe në çështje të tjera që lidhen me projektin.

Shënime specifike:



Planifikimi ditor**Data.....**

Fusha: Arte	Lënda: Muzikë	Shkalla: III	Klasa: 6-të
Tematika: Historia, muzika dhe shoqëria.		Situata e të nxënit:	
Projekt kurrikular: “Përgatitja e një koncerti”.		Ne dhe muzika.	
 Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe			
<p><i>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit:</i> (3, 4) Demonstron një komunikim të qartë me anë të gjuhës muzikore, simboleve, shenjave dhe formave muzikore. Shfrytëzon mjetet artistike mundësitë e komunikimit dhe të të shprehurit në muzikë në mënyrë të pavarur.</p> <p><i>Kompetenca e të menduarit:</i> (1) Kërkon dhe gjen njohuritë muzikore në mënyrë të pavarur.</p> <p><i>Kompetenca për të nxënë:</i> (2) Përdor burime të ndryshme informacioni për të realizuar një krijim muzikor.</p> <p><i>Kompetenca qytetare:</i> (2, 3) Respekton punën e të tjerëve. Bashkëpunon me të tjerët pavarësisht kulturës, brenda dhe jashtë shkollës.</p> <p><i>Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin:</i> (1) Ndërmerr nisma për të zhvilluar aktivitete muzikore brenda dhe jashtë klasës, duke kontribuar në mënyrë krijuese.</p> <p><i>Kompetenca personale:</i> (1,2) Zhvillon besimin te vetja gjatë veprimtarive muzikore. Përfshihet në mënyrë aktive në jetën artistike shkollore dhe në komunitet.</p> <p><i>Kompetenca digjitale:</i> (1, 2) Krijon informacion dhe bashkëpunon në rrjetet informuese në internet.</p> <p>Njeh/përdor mjete të ndryshme në funksion të informacionit muzikor si: magnetofon, audio, video CD, DVD etj.</p>			
 Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës sipas temës mësimore:		<input checked="" type="checkbox"/> Fjalë kyçe:	
<ul style="list-style-type: none"> - komunikon qartë njohuritë muzikore, duke i lidhur ato me emocionet e këngëve që këndon; - performon/interpretin këngët në eventet e klasës apo të shkollës; - performon/interpretin këngë të ndryshme me emocion; - vlerëson interpretimin dhe performimin e të tjerëve; - respekton mendimin e shokëve; - merr pjesë në aktivitete të ndryshme brenda dhe jashtë shkollës. - përdor një fjalor të thjeshtë muzikor; - përdor media (DVD, CD, magnetofon) për të reklamuar/prezantuar punën e vet. 		<ul style="list-style-type: none"> - koncert, - grupi i këngëtarëve, - grupi recituesve, - grupi i kërcimtarëve. 	

 <p>Burimet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - teksti i nxënësit/es, - materiale nga interneti, - materiale të përgatitura nga mësuesi/ja, - CD, fragmente të ndryshme muzikore. 	<p>Lidhja me fushat e tjera:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Shkencat shoqërore dhe mjedisi: Historia dhe gjeografia. - Artet: kërcimi. - Gjuha dhe komunikimi. <p>Lidhja me temat ndërkurrikulare</p> <p>Të njohim kulturën e njëri-tjetrit dhe të interpretojmë bukur.</p>
 <p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</p>	
<p><i>Ndarja e grupeve dhe ndarja e detyrave</i></p> <p>Mësues/ja bën prezantimin e temës që në fillim të orëve të para: Përgatitja e një koncerti. Më pas jep katër nëntema të cilat do të zhvillohen nga nxënësit/et në grupe të veçanta, ku në secilin grup nxënësit/et zhvillojnë aftësitë më të mira të tyre. Grupet punojnë secili në mënyrë të pavarur, duke zgjedhur vetë materialet dhe mjetet për të realizuar detyrën e ngarkuar. Grupet e nxënësve/eve prezantojnë produktet e realizuara në fund të tremujorit. Nxënësit/et vlerësojnë vetë punën e arritur nga secili grup.</p>	
<p><i>Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura</i></p> <p>Nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - punojnë në grup. - respektojnë mendimin e njërit –tjetrit gjatë punës. - zhvillojnë detyrën sipas tematikës së caktuar dhe prezantojnë atë. <p>Produktet e krijuara të nxënësve/eve ruhen në dosjen e tyre.</p>	
<p><i>Vlerësimi</i></p> <p>Vlerësimi i nxënësit/es do të kryhet për:</p> <ul style="list-style-type: none"> - për pjesëmarrjen aktive gjatë krijimit muzikor dhe në çështje të tjera që lidhen me projektin. 	
<p><i>Shënime specifike:</i></p> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/>	

Materiale dhe burime mësimore

Gjatë mësimit të muzikës për realizimin e kompetencave, Mësues/ja përdor mjete didaktike dhe burime, të cilat nxënësi/ja i prek, i shikon, i përdor, i dëgjon etj. Ai/ajo përdor mjete vizuale, teknologji të nevojshme, jep ndihma të veçanta, përshtat shembuj të ndryshëm, krijon mjedisin e përshtatshëm për aktivitete. Teknologjia ka një ndikim të madh në muzikë duke ndihmuar nxënësit/et të eksplorojnë këngë me tematikë të ndryshme, për të rinj, arie, mjuzikëll, vepra muzikore të ndryshme, duke zhvilluar aftësitë e tyre në njohjen më të plotë të muzikës.

Tekstet dhe materialet sigurojnë përmes përdorimit të tyre një qasje të përshtatshme me moshën dhe mundësinë e nivelit të të mësuarit. Me anë të medieve, detyrave dhe projekteve të ndryshme nxënësve/eve u krijohet mundësia të demonstrojnë apo të prezantojnë punët dhe krijimet e tyre.

Muzika studiohet përmes njohjes dhe përdorimit të mjeteve, materialeve, teknikave e procedurave specifike muzikore, p.sh: për dëgjim muzikor, shikim të shfaqjeve për ndjekjen e pjesëve muzikore, të këngëve përdoren magnetofoni, TV-ja, CD-ja dhe DVD-ja.

Përveç materialeve shfrytëzohen edhe burime mësimore si teksti shkollor, interneti etj.

Disa nga mjetet më të përdorshme didaktike janë:

- *Mjetet audiovizive si:* Tv, magnetofon, video, video-projektor, kompjuter, internet, CD, DVD.
- *Mjetet dëgjimore:* radio, magnetofon, etj.
- *Mjetet verbale, tekstet si:* tekstet mësimore (të detyruara), libri i mësues/it, fletoret e punës, katalogë, albume që mund të përdoren në shkollë për të mbështetur punën e nxënësve/eve dhe demonstruar vepra të ndryshme muzikore. Këto burime duhet të diskutohen dhe vlerësohen nga stafi si një pjesë e planit të tyre për muzikën. Ky plan është i rëndësishëm për të përzgjedhur burimet e dyta, të cilat ndihmojnë për të mbështetur nxënësit/et në punët e tyre krijuese dhe performuese, si dhe në krijime të ndryshme.
- *Mjedisi mësimor* (klasa, kabinetet e muzikës etj.).



V. VLERËSIMI

5.1. Llojet e vlerësimit: Vlerësimi i vazhdueshëm, periodik dhe përfundimtar.

Vlerësimi tremujor

Vlerësimi periodik tremujor përfshin:

- *Vlerësimin e vazhdueshëm* që del nga evidencat e vlerësimit të vazhduar të mbajtura për periudhën tremujore.
- *Vlerësimin me test ose detyrë* përmbledhëse në përfundim të periudhës tremujore.
- *Vlerësimin e dosjes (portofolit) së nxënësit/et* për periudhën tremujore.

Këto vlerësime shënohen në regjistër në kolonat përkatëse në përfundim të çdo tremujori.

Vlerësimi përfundimtar

Vlerësimi përfundimtar kryhet në përfundim të vitit shkollor. Nota vjetore përfundimtare përfshin:

- *Notën vjetore të vlerësimit të vazhdueshëm* të tri periudhave tremujore.
- *Notën vjetore të vlerësimit me test ose me detyrë përmbledhëse* të tri periudhave tremujore.
- *Notën vjetore të vlerësimit të dosjes së nxënësit/et* të tri periudhave tremujore.

Secili lloj i vlerësimit në notën vjetore përfundimtare ka peshën e vet në përqindje.

Tabela: Peshat në përqindje të llojeve të vlerësimit.

Lloji i vlerësimit	Pesha në përqindje
Vlerësimi i vazhdueshëm	40%
Vlerësimi me test ose detyrë përmbledhëse	40%
Vlerësimi i dosjes (portofolit) së nxënësit	20%

Hapat për njehsimin e notës vjetore përfundimtare janë:

- Përcaktohet nota vjetore e vlerësimit të vazhdueshëm (NVV).
- Përcaktohet nota vjetore e testit ose e detyrës përmbledhëse (NVT).
- Përcaktohet nota vjetore e portofolit të nxënësit/et (NVP).
- Shumëzohet secila prej notave me përqindjen përkatëse.
- Mblidhen këto prodhime dhe shuma rrumbullakoset me numër të plotë (p.sh., nota 6.4 rrumbullakoset 6; nota 6.5 rrumbullakoset 7).

$$(NVV \times 0.4) + (NVT \times 0.4) + (NVP \times 0.2) = \text{Nota vjetore përfundimtare}$$

Shembull:

Tremujori I			Tremujori II			Tremujori III			Nota vjetore			Nota vjetore përfundimtare
NVV	NVT	NVP	NVV	NVT	NVP	NVV	NVT	NVP	NVV	NVT	NVP	
8	9	10	9	10	10	8	10	10	8	10	10	9

$$(8 \times 0.4) + (10 \times 0.4) + (10 \times 0.2) = 9.2$$

Nota vjetore përfundimtare 9



Shtatë kompetencat kyçe të nxënësit/es

Pse i shërbejnë ato

1. Komunikon dhe shprehet përmes:

- krijimit të personalitetit të vet artistik;
- kuptimit drejt të mesazheve që përcjell muzika;
- demonstrimit të një komunikimi të qartë me anë të gjuhës muzikore, simboleve, shenjave muzikore;
- shfrytëzimit të mjeteve artistike për t'u shprehur në mënyrë të pavarur rreth një muzike të caktuar.

2. Mendon përmes:

- kërkimit dhe gjetjes së informacionit muzikor në mënyrë të pavarur;
- zgjidhjes së problemeve muzikore/artistike gjatë veprimtarive;
- zhvillimit të aftësive për të menduar në mënyrë krijuese dhe ndërvepruese;
- ndjekjes së udhëzimeve gjatë realizimit të një krijimi muzikor.

3. Mëson për të nxënë:

- duke klasifikuar mjetet shprehëse për realizimin e një krijimi muzikor;
- duke përdorur burime të ndryshme informacioni për të plotësuar krijimin apo mendimin muzikor;
- duke krijuar në mënyrë të pavarur një detyrë të dhënë.

4. Merr iniciativa për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin:

- duke ndërmarrë nisma për të zhvilluar aktivitete muzikore brenda dhe jashtë klasës dhe duke kontribuar në mënyrë krijuese;
- duke dhënë ide për projekte të ndryshme mbi muzikën në veçanti dhe artet në përgjithësi.

5. Zhvillon aspektin personal:

- duke zhvilluar besimin te vetja gjatë veprimtarive artistike;
- duke zhvilluar besimin te të tjerët me përfshirjen në mënyrë aktive në jetën shkollore dhe në komunitet.

6. Zhvillon qëndrimin e vet qytetar:

- duke bashkëpunuar me të tjerët brenda dhe jashtë shkollës pavarësisht kulturës së secilit;
- duke bashkëpunuar me të tjerët për çështje të ndryshme muzikore dhe kulturore;
- duke respektuar punën dhe kulturën e tjetrit.

7. Zhvillon aftësitë digjitale:

- duke krijuar informacione përmes burimeve dhe rrjeteve informuese të internetit;
- duke përdorur në funksion të muzikës mjete të ndryshme digjitale (magnetofon, video, iPad, kompjuter etj.) për të krijuar dhe për të dëgjuar.

Sa i ka përvetësuar kompetencat

	10%	20%	30%	40%	50%	60%	70%	80%	90%	100%
Kompetenca 1										
Kompetenca 2										
Kompetenca 3										
Kompetenca 4										
Kompetenca 5										
Kompetenca 6										
Kompetenca 7										

Plani vjetor mësimor

1. Himni kombëtar.
2. Komunikojmë përmes muzikës.
3. Pentagrami dhe çelësi i solit.
4. Kënga “Ëndërr”.
5. Notat muzikore.
6. Kënga “Delja rude”.
7. Notat poshtë dhe sipër pentagramit.
8. Fyelli-rregullat e luajtjes me të.
9. Kënga “Alfabeti shqip”.
10. Gjatësia e tingujve.
11. Ushtrime me fyell hap pas hapi.
12. Masa muzikore dhe shenjat e përsëritjes.
13. Format muzikore motivi - fraza - fjalia.
14. Përforsim i temave të mësuara.
15. Kënga “Prit sinjalin pastaj ik”.
16. Koha dhe pushimi $2/4$.
17. Format muzikore 1-2-3-pjesëshe.
18. Ushtrime teknike me fyell hap pas hapi
19. Kanon “ Fyelli i bariut”.
20. Muzika monodike, polifonike, kanoni.
21. Kënga “Urim mësueses”.
22. Koha $3/4$ dhe pika vlerëse.
23. Koha dhe pushimi $4/4$.
24. Kënga “Neve jemi lulebore”.
25. Luajmë në fyell në kohët e thjeshta.
26. Përforsim i temave të mësuara.
27. Nota dhe pushimi $1/8$.
28. Lidhja vlerëse dhe shprehëse.
29. Kënga “Këngë djepi”.
30. Kënga “The farmer in dhe dell”.
31. Format e thjeshta muzikore-Minueti.
32. Format e thjeshta muzikore-Kënga.
33. Repertor këngësh dhe ushtrimesh për fyell.
34. Projekt kurrikular.
35. Projekt kurrikular.